
Ai i cili dëshiron të mësojë texhvidin duhet ta mësojë mirë theksimin e shkronjave me të cilat formohet fjala.

Vaxhib e kemi që ta mësojmë secilën shkronjë veç e veç, ta mësojmë se prej ku formohet, si formohet, cilat janë cilësitë e posaçme të secilës shkronjë.

Alfabeti i gjuhës arabe ka 28 shkronja.

Alfabeti fillon me shkronjën **hemze** "ء " dhe përfundon me shkronjën **Jaun** "ي ".

Përpos kësaj janë edhe tri zanoret e gjata të përmbledhura në fjalën و ا ى , pra Elifi, Vavun dhe Jaun.

Renditjen e shkronjave e ka bërë gjuhëtari i njohur i quajtur Nas bin Asi mel-Lejthi.

Thuhet se renditja nuk është bërë në bazë të vendartikulimit apo cilësive, por në bazë të formës dhe shkrimit.

SHKRONJAT E GJUHËS SË KUR'ANIT

Shkronjat e gjuhës së kur'anit janë:

1	ا	اَلْأَلِفُ	El-Elif	15	ض	اَلضَّادُ	Ed-Dadu
2	ب	اَلْبَابُ	El-Bau	16	ط	اَلطَّاءُ	Et-Tau
3	ت	اَلتَّاءُ	Et-Tau	17	ظ	اَلظَّاءُ	Edh-Dhau
4	ث	اَلثَّاءُ	Eth-Thau	18	ع	اَلْعَيْنُ	El-Ajnu
5	ج	اَلْجيمُ	El-Xhijmu	19	غ	اَلْغَيْنُ	El-Gajnu
6	ح	اَلْحَاءُ	El-Hau	20	ف	اَلْفَاءُ	El-Fau
7	خ	اَلْخَاءُ	El-Hau	21	ق	اَلْقَافُ	El-Kafu
8	د	اَلدَّالُ	Ed-Dalu	22	ك	اَلْكَافُ	El-Kafu
9	ذ	اَلذَّالُ	Edh-Dhalu	23	ل	اَلَّامُ	El-Lamu
10	ر	اَلرَّاءُ	Er-Rau	24	م	اَلْمِيمُ	El-Mimu
11	ز	اَلزَّاءُ	Ez-Zau	25	ن	اَلنُّونُ	En-Nunu
12	س	اَلسِّينُ	Es-Sijnu	26	و	اَلْوَاوُ	El-Vavu
13	ش	اَلشِّينُ	Esh-Shijnu	27	ه	اَلْهَاءُ	El-Hau
14	ص	اَلصَّادُ	Es-Sadu	28	ي	اَلْيَاءُ	El-Jau

SHENJAT E SHKRONJAVE

Shkronjat e alfabetit prej **hemzes** e deri te **Ja**-un shoqërohen me njërën prej shenjave apo simboleve të cilat duhet të mësohen që së bashku me ta të theksohen mirë.

Nr.	Shenja	Emërtimi	Shembull
1.		El-Fet-hatu	**اَنَّ**
2.		El-Kesretu	**اِنَّ**
3.		Ed-Dametu	**نوحيها**
4.		Es-Sukunë	**أَنْعَمْتَ**
5.		Fet-hatani	**قَوْمًا**
6.		Kesretani	**قَوْمٍ**
7.		Dametani	**قَوْمٌ**
8.		Teshtidi me el-fet-hatu	**إِنَّ**
9.		Teshtidi me el-kesretu	**رَبِّ**
10.		Teshtidi me el-dametu	**حَقٌّ**
11.		Teshtidi me tenvin –fet-hatani	**رَبًّا**
12.		Teshtidi me tenvin kesretani	**رَبٍّ**
13.		Teshtidi me tenvin dametani	**رَبٌّ**

Sa i përket cilësive, vendartikulimit të shkronjave me ndihmën e Zotit dhe dëshirën e Tij do t'i shpjegojmë më vonë.

APARATI I ZËRIMIT

DHE QENDRA E GJUHËS ËSHTË NË MENDJE

Për dallim nga kafshët dhe gjallesat tjera, njeriu veçohet me logjikë – mendje të zhvilluar e cila i ka mjetet (organet) e saja të cilat kanë të bëjnë me gjuhën.

Qendrat e gjuhës janë:

1. Qendra e logjikës, e cila dirigjon dorën për të shkruar;
2. Qendra e logjikës së të folurit, e cila dirigjon fytin, gjuhën dhe gojën.
3. Qendra e të lexuarit (kënduarit – Kiraetu), e cila i sqaron dhe i përcjell shenjat e shkruara në përmjet syve në mendje;
4. Qendra e të dëgjuarit, e cila i pranon valët e zërit (të cilat i përcjellë veshi).

Zëri përcaktohet dhe definohet nëpërmjet dy çështjeve:

1. Vendosjes, pozicionimin e gjuhës në vende të ndryshme të gojës, dhe
2. Ndryshimin e formës, dhe pozicionin e buzëve.

Ai i cili dëshiron të theksojë shkronjën duhet të saktësojë vendartikulimin e secilës shkronjë në gojën e tij dhe duhet t'i dijë mirë pjesët e artikulimit të shkronjave, të cilat duhet të kombinohen me rastin e formimit të zërit të shkronjës.

Aparati i zërimit përbëhet prej:

1. Pjesëve të lëvizshme
   a. Gjuhës,
   b. Gurmazit (gabzherri)
   c. Tejzat e zërit (litarët)
2. Pjesëve të lëvizshme:
   a. Dhëmbëve dhe qiellzës së epërme,
   b. Dhëmbëve dhe qiellzës së poshtme (hablil veride),
   c. Hunda (zgavra e hundës).

3. Gryka dhe Zbrazëtia prej gojës deri në thellësi të fytit.

Kemi pesë vendartikulime kryesore, të cilat i kanë vendartikulimet dytësore të shkronjave:

1. gryka ku artikulohen tri zanoret e gjata: ا و ى

2. Fyti ku artikulohen shkronjat: ء ه ع ح خ غ
3. Gjuha ku artikulohen shkronjat, të cilat janë 18:
   ج ش ى ق ك ي ل ن ر ض ز س ط د ت ظ ذ ث

4. Buzët ku artikulohen shkronjat, të cilat janë 4: ف و ب م

5. Zgavra e hundës ku formohet tingulli i quajtur "gune" dhe "ن " me teshtid, po ashtu edhe "م " me teshtid.

KAPITULLI I TRETË

مخارج لحروف

VENDSHPËRTHIMET (VENDARTIKULIMET) E SHKRONJAVE

VENDSHPËRTHIMET (VENDARTIKULIMET) E SHKRONJAVE

Harf (**حَرْف**) gjuhësisht do të thotë ana e një çështje.
Harf (**حَرْف**) në terminologji do të thotë: zëri, fonema e përqëndruar në pikshpërthim (vend-dalje) i përcaktuar ose i papërcaktuar.

Mahrexh (**مَخْرَج**) gjuhësisht do të thotë vendshpërthim.
Mahrexh (**مَخْرَج**) në terminologji do të thotë: vendi (pika) e daljes (shpërthimit) të shkronjës prej ku dallohet zëri (i shkronjës) prej shkronjave tjera.

Vendartikulimi (Mahrexh) i përcaktuar preciz është fonemë zëri i përqëndruar në vend të posaçëm prej vendeve kryesore të artikulimit si p.sh. prej fytit, gjuhës ose buzëve.

Vendartikulimi jo i përcaktuar preciz (Mahrexh el-Mukader) është fonema, zëri i cili nuk është i përqëndruar në vend të posaçëm prej vendeve kryesore të artikulimit të fytit, gjuhës ose buzëve dhe as nuk përundon në ndonjë pikë të veçantë. Për këtë arsye këto shkronja e lejojnë në vete shkurtimin apo zgjatimin e tyre. Në këtë bëjnë pjesë tri zanoret e gjata ا , و dhe ى . Sh.:

إ ـ إِى * أ ـ أُو * أ ـ اَ

Alfabeti i gjuhës arabe ka 28 shkronja dhe pas tyre edhe tri zanoret e gjata ا , و dhe ى .
Pjesa dërmuese e dijetarëve janë të mendimit se janë 17 vendartikulime.

VENDET PREJ KU ARTIKULOHEN SHKRONJAT

Siç kemi përmendur edhe më herët në gjuhën arabe vendet prej ku artikulohen shkronjat janë 17, dhe kjo sipas mendimit të shumicës së dijetarëve të Texhvidit.

Vendet e shkronjave në përgjithësi klasifikohen në pesë vende, e ato janë:

1. Gërklani (Gurmazi),
2. Fyti,
3. Gjuha,
4. Buzët dhe
5. Hunda.

GRYKA (THELLËSIA PREJ BUZËVE DERI NË

FUND TË FYTIT)

Xhevf do të thotë zbrazëti, pra tërë zbrazëtia e gojës dhe fytit, apo tërë thellësia e fytit.
Gryka (xhevfi) është hapsira e gjatësisë prej fillimit të fytit deri në hapjen e buzëve.

Nga gryka burojnë tri zanoret e gjata, me fjalë tjera: Elifi i pavokalizuar (ا), vavi i pavokalizuar (و) dhe Ja-i i pavokalizuar (ى).

Shart është te këto shkronja që t'iu paraprijnë atyre zanoret e shkurtra, ndëra vetë të jenë të pavokalizuara:

(قَالَ * بَات * تَاب * ثَاب * جَارَ * دَارٌ * ذَاب * زَار)

(ا)

يَقُولُ * بُور * تُوب * ثُورَ * حُور * دُور * ذُوب * زُورَ

(و)

(قِيلَ * تِير * ثِير * حِينٌ * دِينٌ * سِيرَ * فِيلٌ)

(ى)

Shkronjat e grykës nuk kanë përkufizim, por ato kanë ajërim të brendisë së gojës dhe fytit, pra zëri duhet të kalojë tërë zbrazëtirën e gojës dhe të fytit pa hasur në ndonjë pengesë. Pra, lirimi nuk ndalet në ndonjë pikë të caktuar, por është zgjatim i zërimit.
Këto shkronja kanë specifikë atë se:

ا - Elifi ngritet, lartësohet,

ى - Jaun tërgiqet, ngrihet teposhtë,

و - Vavun paraqitet, as nuk ngritet, e as nuk tërhiqet. Duhet ditur se Vavi zgjatues del prej grykës, ndërsa vavi josgjatues del prej bashkimit të buzëve.

Këto shkronja quhen shkronja grykore, zërore apo ajrore.

GJUHA

Gjuha i ka 10 vendshpërthime prej ku artikulohen 18 shkronjat. Mirëpo ato 10 vendartikulime janë:

1. **Fillimi i shpinës së gjuhës**, me hapësirën e gurmazit ku edhe paralel është fundi i qiellzës. Nga ky vend artikulohet shkronja "**ق** ". Kjo shkronjë quhet *shkronja e gurmazit* (Harf Lehevije).

2. **Shpina e gjuhës,** me hapësirën e gurmazit ku edhe paralel është laringu. Nga ky vend artikulohet shkronja "**ك** ". Edhe kjo shkronjë quhet *shkronjë e gurmazit* (Harf Lehevije).

3. **Mesi i gjuhës,** paralel me kupolën e lartë qiellzore. Nga ky vend artikulohen shkronjat " **ش ، ج** dhe **ي** ". Këto shkronja quhet shkronja trupore apo trungore (Huruf Shexherije), sepse i tërë mesi i trupit të gjuhës merr pjesë në artikulimin e këtyre shkronjave.

4. **Anësoret gjuhës,** së bashku me dhëmballët e djathtë apo të majtë, të cilat formojnë shkronjën "**ض**". Pra, ose anësori i gjuhës me dhëmballët e djathtë, ose anësori i gjuhës me dhëmballët e majtë. Mirëpo më lehtë dhe më shumë përdoret anësori i gjuhës me dhëmballët e majtë.

5. **Maja e shpinës së gjuhës,** së bashku me dhëmbët shkyes ose më mirë të themi me pjesën e qiellëzes së dhëmbëve shkyes. Nga ky vend artikulohet shkronja "**ل**".

6. **Maja anësore e gjuhës,** por më poshtë se vendi ku artikulohet shkronja "ل". Është vendi ku artikulohet shkronja "ن".

7. **Maja e shpinës së gjuhës** me mbështjellësin e dhëmbëve të përparmë është vendi ku formohet apo artikulohet shkronja "ر".
8. **Shpina e gjuhës** me qiellzën e epërme, është vendi ku artikulohen shkronjat " ط ، د dhe ت". Ndryshe këto shkronja quhet *Huruf Nutije*, sepse artikulohen prej vendit ku përfundon hapësira e fytit.

9. **Maja e gjuhës** paralel me fillimin e qiellzës së poshtme dhe qiellzës së epërme. Është vendi ku artikulohen shkronjat " ص ، ز dhe س ". Ndryshe këto shkronja quhen Huruf Eslije, sepse artikulohen prej lëvozhgës së gjuhës apo më mirë të themi prekjen precize dhe të mprehtë të gjuhës.

10. **Shpina e gjuhës** së bashku me qiellzën e epërme. Është vendi ku artikulohen shkronjat " ظ ، ذ dhe ث ". Këto shkronja quhen Huruf Luthevije Shkronja mbështjellësoro-dhëmbore, sepse shpina e gjuhës mbështetet në mbështjellësin e dhëmbëve gjatë artikulimit të këtyre shkronjave.

FYTI

Fyti është organi i zërimit prej ku artikulohen gjashtë shkronja, që quhen shkronja fytore, e ato janë: ا ء ه ع ح غ dhe خ .

Fyti ndahet në tri pjesë:

1. Fundi i fytit;
2. Mesi i fytit dhe
3. Fillimi i fytit.

1. Fundi i fytit

Fundi i fytit është vendi ku artikulohen dy shkronja ا ء dhe ه .

Këto dy shkronja janë edhe shkronjat e para, të cilat fillojnë prej brendësisë së gjoksit.

2. Mesi i fytit

Në mes të fytit artikulohen shkronja ع dhe ح .

3. Fillimi i fytit

Pas shkronjave buzore dhe gjuhore ku fillon pjesa e parë e fytit, pra nga goja artikulohen shkronja غ dhe خ .

Këto shkronja quhen shkronjat e fytit (harful halkiji).

HUNDA – RRËNJA E HUNDËS

Nuk janë vetëm goja, fyti dhe gjuha aparate të zërimit të shkronjave, por aparat i zërimit është edhe rrënja e hundës (Hajshum).

Zëri, i cili formohet prej rrënjës së zgavrës së hundës ndryshe edhe quhet "Gune-tun". Nëse zgavrat e hundës shtrëngohen dhe mbyllen nuk formohet tingull, por patjetër duhet të jenë të lira.

Gune është e patjetërsueshme për shkronjën ن dhe م.

Gune nuk është shkronjë e cila ka formë të veten të tejdukshme, por është cilësi shkronjeje. Pra, zgavra e hundës është: vendartikulim i shkronjës dytësore, vendartikulim i Ihfasë (fshehjes) së ن, vendartikulim i Idgamit dhe Iklabit.

BUZËT

Buzët marrin pjesë në dy vendartikulime, e ato janë:

1. Shtrati i buzëve;
2. Vendbashkimi i buzëve.

1. Nga **shtrati i buzës** së poshtme me dhëmborët e epërm ku artikulohet shkronja ف (f).

2. Vendartikulimi **mes buzëve** ku bëjnë pjesë:
   shkronja ب
   shkronja م dhe
   shkronja و e me zanore të shkurtër.

Vërejtje:
Shkronja ب dhe م shqiptohen duke **i mbyllur buzët**, ndërsa shkronja و duke i mbajtur pak si të hapura.

LLOJET E VENDARTIKULIMIT TË SHKRONJAVE

Pjesa dërmuese e dijetarëve janë të mendimit se janë 17 vendartikulime të shkronjave.
Vendartikulimet ndahen në:

- Vendartikulime të përgjithshme dhe
- vendartikulime të veçanta.

Vendartikulimet e përgjithshme janë pesë:

1.	Gryka,	e cila ka	1 vendartikulim
2.	Thellësia e fytit,	e cila ka	3 vendartikulime
3.	Gjuha,	e cila ka	10 vendartikulime
4.	Buzët,	e cila ka	2 vendartikulime
5.	Zgavra e hundës,	e cila ka	1 vendartikulim
		Gjithsejtë	17 vendartikulime

Kështu biem në përfundim se vendartikulimet e përgjithshme janë 5, ndërsa të veçantat janë 17.
Vendartikulim i veçantë quhet vendartikulimi, i cili nuk ka më shumë se një vendartikulim prej të cilit në brendi artikulohen një e më shumë shkronja. P.sh.: Vendartikulim i përgjithshëm quhet thellësia e fytit, e cila degëzohet pastaj në 3 vendartikulime ku në secilin vendartikulim burojnë nga dy shkronja.

Pra, fillimi i fytit ku burojnë ا ه
mesi i ku burojnë ح خ
fundi i fytit ku burojnë ع غ

MEHARIXH EL-HURUF

المنطقة الصوتية و عدد حروفها	مجموعة الحروف المتصلة بكل مخرج	بيان المخرج	عدد مخارج
الجوف [٣]	الألف الساكنة بعد الفتح الواو الساكنة بعد الضم الياء الساكنة بعد كسر	تخرج ثلاثتها من الجوف و تسمى بالحروف المدّية حروف اللِّين الهوائية و يبتدىء خروجها من الصدر و ينتهى بانتهاء الصوت فى الفم	واحد
الحق [٢]	الهمزة و الهاء. العين و الحاء. الغين و الخاء.	من أقصى الحلق أى أبعده و آخره من جهة الصدر. من وسط الحلق. من أدنى الحلق أى أقربه مما يلى الفم	ثلاثة
اللسان	الجيم و الشين و الياء (غير لمدية) أى ((الساكنة بعد فتح أو المتحركة))	وسط اللسان بينه وبين وسط الحنك الأعلى	واحد
	القاف	أقصى اللسان قريبا من الحلق من فوق أى (أبعده مما يلى الحلق و ما يحاذيه من الحنك الأعلى).	واحد

اللسان	الكاف	اقصى اللسان من أسفل مما يلى الفم من أسفل مخرج القاف و ما يليه من الحنك الأعلى .	واحد
	الضاد	تخرج من إحدى حافتى اللسان مع ما يليها من الأضراس من الجهة اليسرى أو اليمنى ، و اليسرى أكثر شيوعا .	واحد
	الـلام	من أدنى حافتى اللسان إلى منتهى طرفه مع ما يليه من أصول الثنايا فى مقابلة الضاحك من الحنك الأعلى .	واحد
	النـون	من طرف اللسان مع ما فوقه من الحنك الأعلى مع أصول الثنايا العليا أسفل اللام قليلا .	واحد
	الـراء تسمى اللام و النون الراء حروفا ذلقية نسبة إلى ذلق اللسان أى طرفه.	من طرف اللسان مع أصول الثنايا العليا مائلا إلى الظهر أسفل اللام قليلا.	واحد
	الصاد – ازاى – السين [تسمى حروف الصفير]	من طرف اللسان فوق الثنايا العليا و السفلى .	واحد
	الطاء – الدال – التاء	من طرف اللسان مع أصول الثنايا العليا	واحد

اللسان	الظاء ـ الذال ـ الثاء [تسمى الحروف اللثوية]	من طرف اللسان و أطراف الثنايا العليا	واحد
[١٨ حرفًا]			[عشر مخارج]
الشفتان [٤]	الفاء الباء ـ الميم الواو	من بطن الشفة السفلى مع أطراف الثنايا العليا . ما بين الشفتين بانطباقهما ما بين الشفتين بانفتاحهما	واحد واحد واحد
الخيشوم	الغنة	من أقصى الأنف	واحد

SHKRONJAT

Kur'ani përbëhet prej sureve, suret prej ajeteve, ajetet prej fjalëve, fjalët prej shkronjave. Pra shkronja është njësia më e vogël e Kr'anit fisnik.

Shkronjat përbëhen prej zanoreve, me fjalë tjera i bashkëngjitet zanorja, ose sukuni (jozanori).

Muhamedi a.s. i ka thënë Musa El-Esharij:

"O Musa më është dhënë tingulli (fonema) prej tingujve (fonemave) të Davudit".

(Buhariu në Sahihun e tij)

Shkronjat janë dy llojesh:

1. Shkronja kryesore (parësore) dhe
2. Shkronja Sekondare (dytësore).

1. Shkronjat kryesore janë 29 shkronjat e njohura në alfabet.
2. Shkronjat dytësore janë shkronjat, të cilat burojnë prej mesit të dy vendartikulimeve ose prej dy cilësive (hollësimit-trashësimit).

Shkronjat sekondare (dytësore) janë:

a. Elifi i errësuar (Elif museheletun). Kjo fonemë as nuk është hemze e plotë, as elif i plotë, por mes i tyre. P.sh.:

أَ أَعْجَمِيٌّ
ءَآ اللهُ أَذِنَ لَكُمْ
ءَآ الذَّكَرَيْنِ
ءَآ الْآنَ

b. Elifi mumal. Ky është elifi - ا mes elifit - ا dhe ى , as nuk është elif i plotë, as ى e plotë. P.sh.:

مَجْرَاهَا

c. Shkronja ص e përzier në fonemën e shkronjës ز . P.sh.:

الصِّرَاطَ الْمُسْتَـقِيمَ
قَصْدُ السَّبِيلِ

Kiraeti i Hamzës

- Shkronja ى e përzier në shkronjën و . P.sh.

قِيلَ . غِيضَ

- Fonemohet në mes të kesres dhe dames, pra në mes të ى dhe و . Kjo te disa lexues, përpos Hafsës.

- Elifi i trashë. Elifi i cili vjen pas shkronjave të rënda:

خَالِدِينَ
طَآئِعِينَ

- Shkronja ل e trash:

قَالَ اللهُ
عَبْدُ اللهِ
اللّـهُمَّ

Lexohet trash edhe pse parësore është shkronja ل ajo lexohet LL .

- Shkronja ن e fshehur: كُنتُمْ

- Shkronja م e fshehur: أَنبِئْهُم بِأَسْمَآئِهِمْ

- Disa dijetarë shkronjën LL, ن - N të fshehur dhe م - M të fshehur, nuk i konsiderojnë shkronja dytësore.

SQARIM:

Shpina e gjuhës (pjesa e përparme ose e prapme) herë-herë i largohet qiellzës e herë-herë i afrohet. Nga këto lëvizje përcaktohet shkalla e hapjes së tingujve.

Në nyjëtimin e tingujve pjesë të ndryshme të gjuhës afrohen me pjesë të ndryshme të qiellzës, të dhëmbëve ose alveolave. Herë-herë ka mbyllje të çastit të ndjekura nga një shpërthim i organeve të të folurit e herë-herë ka afrim të organeve që formojnë një shteg. Gjithsesi në të gjitha rastet kemi të bëjmë me në pengesë që duhet kapërcyer.

Roli i majës së gjuhës është gjithashtu i rëndësishëm. Në qoftë se maja e gjuhës zbret drejt alveolave dhe dhëmbëve të poshtëm, nyjëtimi quhet dorsal ose shpinor, për arsye të rolit aktiv që luan në këtë rast shpina e

gjuhës, herë e ngritur e herë e ulur. Kur maja e gjuhës ngrihet drejtë alveolave të dhëmbëve të sipërm, kemi të bëjmë me nyjëtim apikal ose major. Kur maja e gjuhës ngrihet sipër dhe kthehet prapa kemi nyjëtim retrofleks ose kakuminal.

Kur buzët janë të rrumbullakuara dhe të zgjatura formojnë një rezonator plotësues midis dhëmbëve dhe buzëve të quajtur rezonatori buzor që shërben për të formuar tinguj të buzorëzuar ose buzorë.

Kur njerithi ulet dhe një pjesë e ajrit kalon nga hapësira e hundës formohet një rezonator tjetër i quajtur rezonatori hundor.

Zanoret dhe bashkëtingëlloret

Tingujt e shqipes standarde sipas tipareve të tyre nyjëtimore mund të klasifikohen në dy grupe kryesore, në zanore dhe bashkëtingëllore.

Mënyra e kalimit të rrymës së ajrit përmes glotës përbën bazën për ndarjen e tingujve në zanore e bashkëtingëllore.

Kur tejzat e zërit janë të puqura dhe glota është e mbyllur dhe rryma e ajrit kalon përmes saj dhe dridh tejzat e zërit në mënyrë ritmike, përftohet zë ose ton laringal.

Kur tejzat e zërit janë të larguara dhe glota është e hapur dhe rryma e ajrit kalon pa i dridhur tejzat e zërit përftohet zhurmë laringale.

Toni laringal ose zhurma laringale mund të kalojnë lirisht ose të ndeshin një pengesë në kanalin e zërit.

Zanore janë tingujt, për nyjëtimin e të cilëve toni laringal kalon lirshëm në kanalin e zërit, pa ndeshur në ndonjë pengesë, kurse bashkëtingëllore, janë tingujt për nyjëtimin e të cilëve toni ose zhurma laringale ndesh në një pengesë të plotë ose të pjesshme dhe kapërcimi i pengesës formon bashkëtingëlloret. Prania ose mungesa e një pengese gjatë kalimit të rrymës së ajrit është, pra, ajo që përcakton dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.

Veçoritë nyjëtimore të zanoreve

Veçoria nyjëtimore themelore e zanoreve është kalimi i lirë i rrymës së ajrit duke filluar që nga hapësirat e nënlaringut. Gjatë nyjëtimit të zanoreve, rryma e ajrit, e prodhuar nga lëkundjet periodike të tejzave të zërit, kalon nëpër faring dhe gojë pa hasur ndonjë pengesë. Modifikimi i vetëm që mund t'i bëhet rrymës së ajrit është rezonanca, do me thënë përforcimi i disa frekuencave të pjesshme nga rezonatorët.

Funksionet e organeve të të folurit

Gjatë frymëmarrjes normale dhe gjatë nyjëtimit të bashkëtingëlloreve të shurdhëta, si rezultat i lëvizjeve të aritenoideve, tejzat afrohen ose largohen dhe hapin glotën. Rryma e ajrit kalon pa prodhuar ndonjë tingull.

Kur flasim ato janë shumë të tendosura dhe rryma e ajrit i bën të dridhen. Këto dridhje të tejzave të zërit të tendosura formojnë tingullin të cilin e quajmë zë ose ton laringal.

Me tejzat e zërit të afruara dhe të tendosura formohen zanoret dhe bashkëtingëlloret e tingullta (sonore). Kur tejzat e zërit janë të afruara, por jo të tendosura, kemi të bëjmë me pështpëritje.

KAPITULLI I KATËRT

CILËSITË (TIPARET) E SHKRONJAVE

CILËSITË (TIPARET) E SHKRONJAVE

Shkronjat janë sikurse njerëzit, disa janë të fortë e të fuqishëm, disa janë të dobët e disa janë mesatarë.

Cilësitë janë ato, që e dallojnë njërin prej tjetrit. Kështu edhe shkronjat dallohen njëra prej tjetrës në bazë të cilësive.

Për shembull, të marrim fjalën **مَنْ** dhe **أَسْ** . Shohim se kur ta artikulojmë "**ن**" e artikulojmë sikurse me u ndalë në tokë të thatë, ndërsa kur ta artikulojmë "**س**"e artikulojmë sikurse të rrëshqitet në tokë me baltë.

Në përgjithësi janë 17 cilësi të shkronjave, të cilat ndahen në cilësi të kundërta dhe në cilësi të veçanta. Çdo shkronjë më së paku duhet t'i ketë 5 cilësi dhe të jetë e larguar nga pesë cilësi tjera. Përpos kësaj, disa kanë edhe një cilësi më tepër, pra 6 cilësi, e ndonjëri, edhe dy cilësi më tepër, pra 7 cilësi.

CILËSITË

Cilësitë e shkronjave janë 17, mirëpo Ibn Xhezeri thotë se janë 18 cilësi të shkronjave. Disa mendojnë se janë 15 cilësi dhe nuk e kanë konsideruar cilësi Ismatin (ngulmuesen), Idhlakin (rrëshqitësuesen), lejinin (butësuesen).

Disa kanë thënë janë mbi 40 cilësi, duke shtuar cilësi tjera.

Cilësitë janë dy llojesh:

1. Cilësi vetanake dhe të përgjithmonshme, të cilat asnjëherë nuk humbin prej shkronjës.
2. Cilësi jovetanake, që do të thotë paraqiten në disa raste dhe humbin në disa raste, si p.sh. trashëgimi i shkronjës "ر".

Cilësitë vetanake janë dy llojesh:

1. Cilësi kundërvënëse,
2. Cilësi të posaçme.

Cilësitë vetanake kundërvënëse (kontradiktore) të shkronjave janë 5, që do të thotë se secila cilësi e ka përballë cilësinë tjetër, e cila i kundërvihet, e ato janë:

1. El-Hemse, e kundërta e saj Xhehri
   fshehtazi haptazi
   fshehtëzuese haptëzuese.
2. Esh-Shidet, e kundërta e saj err-Rrehave
   Fortësim çlirim
   Fortësuese çliruese.
3. El-Istiëla, e kundërta e saj Istifal
   Ngritje zbritje
   Lartësim ultësim
   Zëlartësuese zëulëse
4. El-Itbak, e kundërta e saj Infitah
   Ngjitje shkëputje
   Ngjitëse shkëputëse.
5. El-Idhlak, e kundërta e saj Ismat
   Rrëshqitje ngulmim
   Rrëshqitëse ngulitëse.

Cilësitë vetanake jokundërvënëse (jokontradiktore) janë:

1. Safire - shushulluese, fishkëlluese, mprehtësuese;
2. Kalkale - dridhëtuese, tronditëse, vibratuese;
3. El-Lijn - zbutësuese, lehtësuese;
4. El-Inhiraf - lajkatuese;
5. Et-Tekrirë - përsëritëse;
6. Et-Tefeshij - zhurmuese, shkapërderdhëse;
7. El-Istitale - stërzgjatuese.

CILËSITË KONTRADIKTORE

1. a) HEMSE – SHURDHTË

Hemse do të thotë zë i heshtur, i mbyllur, i fshehur.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **فلا تسمع الا همسا**

"Nuk dëgjon zë, pos një pëshpëritje të thembrave të këmbëve".

Në Terminologji hemse do të thotë: të vazhduarit e frymës apo më mirë frymëmarrjes pas theksimit të shkronjës, për shkak të përkufizimit dhe për shkak të dobësimit të zërit nga vendartikulimi.

Shkronjat e hemses janë:

ف ح ث ه ش خ ص س ك ت

Disa nga shkronjat e hemses janë më të fuqishme e disa më të dobëta. Më e fuqishmja është shkronja **ص**, sepse kjo shkronjë përpos cilësisë së hemses ka edhe cilësi të tjera, të cilat janë të fuqishme si ISTIËLA (Zëlartësuese) SAFIRË (Fishkëlluese). Pas saj vjen shkronja **خ**, pastaj **ك** dhe **ت** e pastaj të tjerat me radhë, ndërsa e fundit është **ه**.

Këto shkronja quhen MEHMUSE, sepse janë të dobëta, pra bëhet përkufizimi i shkronjës në brendi të vendartikulimit, dhe nuk mund të fuqizohen, sepse pengohet zërimi dhe frymëmarrja me vetë shkronjën.

Dihet ka dallim në mes të zërimit dhe frymës.

FRYMA është ajri, i cili del prej laringut (mesit të arterjeve të zërit) pa i dridhur arteriet e zërit dhe pa formuar tingull.

ZËRI është ajri, i cili del prej arterieve të zërimit (mesit të arterjeve të zërit) me dëshirë dhe i dridh dy arteriet e zërit, ashtu që formohet zë siç është zëri i shkronjave të fytit dhe zanoreve të gjata.



Kur të bëhet shkronja **"hemse"** – e

shurdhët vazhdon frymëmarrja, ndërsa përkufizohet shkronja.



Kur të bëhet shkronja **“xhehr - جهر ”** – **e zëshme,** mbyllet dera e frymëmarrjes për shkak të fuqisë të cilën e ka zëri.

1. b) EL XHEHR – TË ZËSHME

Xhehr جهر do të thotë: çelje, hapje - pra zë i fuqishëm në të shprehur të shkronjës.

Në TERMINOLOGJI do të thotë: mbyllja e derës së frymëmarrjes në momentin e artikulimit të shkronjës për shkak të fuqisë që ka zëri.
Shkronja e Xhehrit (të zëshme) janë 19, pra çka mbesin prej shkronjave të hemses:

ع ظ م و ز ن ق ا ر غ ض ذ ى ط ل ب ج د

Shkaku: Këto shkronja quhen të zëshme, sepse kanë fuqi në vetvete, fuqi në organin e nyjëtimit; këto shkronja nyjëtohen së bashku me zërin e fuqishëm duke qenë glota e mbyllur dhe rryma e ajrit kalon përmes saj dhe i dridh tejzat e zërit.

Disa shkronja janë më të hapura (të zëshme) se tjerat, si p.sh. shkronja “**ط** ” është më e hapur (më e zëshme) se shkronja “**ذ** ”.
Vërejtje: Në gjuhën shqipe shkronjat e zëshme janë: [b, d, gj, g, x, xh, v, dh, m, n, nj, j, l, ll, r, rr].
Shkronjat shurdhuese janë: [p, t, q, k, c, ç, f, th, s, sh, h].

HEMSE EL XHEHR – FSHEHTËSIMI DHE HAPËSIMI

Mënyra e kalimit të rrymës së ajrit përmes glotës përbën bazën për ndarjen e tingujve në zanore e bashkëtingëllore.

Kur tejzat e zërit janë të puqura dhe glota është e mbyllur, dhe rryma e ajrit kalon përmes saj, dhe dridh tejzat e zërit në mënyrë ritmike, përfitohet zë ose ton laringal. Kjo cilësi quhet XHEHR - e Zëshme.

Kur tejzat e zërit janë të larguara dhe glota është e hapur, dhe rryma e ajrit kalon pa i dridhur tejzat e zërit përfitohet zhurmë, pështërimë laringale. Kjo cilësi quhet Hemse – Shurdhuese.

2. a) ESH-SHIDETUN - SHTRËNGUESE

Esh-Shidedu gjuhësisht do të thotë fortësi.

Në terminologji do të thotë: Rezervimi i zërit gjatë shqiptimit në shkronjë, me qëllim që të forcohet shkronja kur të shpërthen në vendnyjëtim.

Shkronjat ESH-SHIDETU – SHTRËNGUESE janë tetë. Ato janë:

ء ح د ق ط ب ك ت (اجد قط بكت)

Këto shkronja quhen të forta, sepse shkronja forcohet dhe mbështetet fortë në vendartikulimin e tij.

Shkronja më e forta është **ط** .

Shkaku: Këto shkronja janë të forta, për shkak të shtrëngimit të shkronjës në vendartikulim deri në momentin kur të shpërthen shkronja gjatë nyjëtimit.

2. b) ERREHAVETU - ÇLIRUESE

Err-Rrehave gjuhësisht do të thotë **e lehtë**, **e butë**, **e lirë**.

Në terminologji do të thotë: kalimi i zërit pa pengesë gjatë shqiptimit të shkronjës për shkak se mbështetja në vendnyjëtim nuk është e fortë, por e butë, e lehtë dhe e dobët, dhe zëri është i përkufizuar në shkronjë.

Shkronja Rehavetu janë 16. Ato janë:

(zanoret e gjata) **ف ح ت ه ش خ س د ز ض ظ غ + ا و ى**

Shkaku: Quhen këto shkronja çliruese për shkak të lehtësisë dhe dobësisë së mbështetjes së tyre në vendnyjëtim, dhe nuk forcohet, as nuk shtrëngohet

për të rezervuar zë që fonema të shqiptohet së bashku me shkronjën, por lirshëm del edhe fryma, edhe zëri i shkronjës, si p.sh. **اس * اش**

Vërejtje: Çdo shkronjë çliruese ka nevojë për një pjesë kohe në të cilën pjesë kohe duhet të kalojë fonema (zëri) i tingullit **ش** - sh:

اس * اش

Kjo sqarohet më mirë në praktikë.

3. a) ISTIËLA – NGRITËSE, ZËLARTËSUESE

ISTIËLA do të thotë ngritje, lartësim.

Në Terminologji Istiëla do të thotë: Ngritja e majës së gjuhës lart në qiellzë kur të theksohet shkronja.

Këto shkronja janë 7:

خ ص ض غ ط ق ظ

Gjatë artikulimit të këtyre shkronjave zëri ngritet lart.

Rënditja e shkronjave për nga lartësimi apo ngritja e zërit janë: **ط** , pastaj **ض** , pastaj **ص** , pastaj **ظ** , pastaj **ق** , pastaj **غ** , pastaj **خ** .

Gjuha mund të lëvizë drejtë pjesës së përparme të gojës duke formuar një hapësirë të madhe rezonance në pjesën e prapme. Mirëpo, me rastin e ISTIËLASË qëllimi është që maja e gjuhës të ngritet lart në qiellzë që të formohet një hapësirë më e madhe rezonance në pjesën e prapme, që të formohet ton laringal më i lartë.

Kur ngritet maja e gjuhës lart në qiellzë padyshim se edhe mesi i shpinës së gjuhës ngritet, mirëpo shkronjat **ج , ش , ى** dhe **ك** nuk janë shkronja të Istiëlait, edhe pse gjuha ngritet lart, por ngritet mesi i gjuhës, e jo maja e gjuhës.

Me rastin kur maja e gjuhës ngrihet drejt alveolave të dhëmbëve të sipërm kemi të bëjmë me ISTIËLAIN e që ky nyjëtim quhet apikal ose majorë.

3. b) ISTIFAL – ULËSE - ZBRITËSE

ISTIFAL do të thotë ulje, zbritje.

Në Terminologji Istifal do të thotë: Zbritja e gjuhës poshtë ku e ka vendin në gojë, gjithmonë kur të theksohet shkronja.

Shkronjat e Istifalit janë 21:

ء ب ت ث ج ح د ذ ر ز س ش ع ف ك ل م ن ه ا و ى

Me rastin kur maja e gjuhës zbret drejt alveolave dhe dhëmbëve të poshtëm kemi të bëjmë me ISTIFALIN e që ky nyjëtim quhet dorosal ose shpinor.

Kur të ngritet gjuha quhet shkronjë zëlarte - Mustealë, ndërsa kur të zbritet gjuha quhet shkronjë zëulëte - Istifale. Gjithsejtë janë:

7 shkronja zëlarte,

21 shkronja zëulëte.

4. a) ITBAK – PËRMBYLLËSE, NGJITËSE

ITBAK do të thotë ngjitje përmbyllje. Në Terminologji ngjitja e një pjese të gjuhës apo pjesës më të madhe të gjuhë me qiellzën e epërm, me rastin e artikulimit të shkronjës. Këto shkronja janë:

ص ض ط ظ

Gjatë theksimit të këtyre shkronjave përkufizohet zërimi në anësoret dhe në majën e gjuhës me qiellzën e epërme.

Renditja e shkronjave të Itbakit për nga fuqia e ngjitjes së gjuhës është:

Shkronja **ط** është më e forta dhe më përmbyllësja, pastaj me radhë vjen shkronja **ض** , pastaj **ص** , dhe fundit shkronja **ظ** .

ط me e forta pastaj **ض** , pastaj **ص** , pastaj **ظ** .

4. b) INFITAH – HAPËSUESE, SHKËPUTËSE

Infitah do të thotë: Ndarje, mospërputhje, hapje.

Në terminologji do të thotë: Mosbashkëngjitja e gjuhës me qiellzën e epërm, në mënyrë që të mos bllokohet zëri në mes tyre gjatë artikulimit të shkronjës.

Shkronjat e Infitahit janë 25, me zanoret e gjata:

ء ب ت ث ج ح خ د ذ ر ز س ش ع غ ف ق ك ل م ن

و ه (zanoret e gjata) ا و ى +

INFITAH gjuhësisht do të thotë hapje, ndarje, qelje.

Infitah në terminologji do të thotë: Ndarja apo të larguarit (formimi i hapësirës) e gjuhës sa më shumë prej kupolës qiellzore në momentin e shqiptimit (artikulimit) të shkronjës për t'u mos u bllokuar apo për t'u mos përkufizuar zëri mes tyre.

Shkronjat e Infitahit janë 25, së bashku me zanoret e gjata:

ء ب ت ث ج ح خ د ذ ر ز س ش ع غ ف ق ك ل م ن و ھ ا و ى

Dallimi mes ISTIFALIT (Zbritësueses) dhe INFITAHIT (Hapësueses)

Istifal është zbritja e majës së gjuhës sa më poshtë nofullës së poshtme që sa më shumë me iu larguar kupolës së qiellzës.

Ndërsa, te Infitah-i mjafton vetëm të larguarit (mosgjitja) e gjuhës prej kupolës së qiellzës, edhe pse gjuha ngritet lart prej nofullës së poshtme. Tipari i ifitahit është më e përgjithshme se tipari i istifalit. Andaj mund të thuhet se çdo shkronjë e istifalit është, në të njëjtën kohë, edhe e infitahit, ndërsa çdo shkronjë e infitahit nuk është edhe e istifalit. P.sh. shkronjat **ق ع خ** janë shkronja të ifitahit, por janë edhe të istiëlait.





Dallimi mes Istiëlait (Ngjitëses qiellzore) dhe Itbakit (ngjitëses përmbyllëse)

ISTIËLA do të thotë ngitja e majës së gjuhës lart në qiellzë, duke lënë një shteg, pra i afrohet qiellzës, mirëpo nuk ngjitet, por e lenë një shteg.

Ndërsa, ITBAK do të thotë ngritja e majës së gjuhës lart në qiellzë dhe duke e ngjitur plotësisht majën e gjuhës me kupolën e qiellzës. Pra, Itbaki është shkallë shumë më e fortë se Istëlai, sepse tek tipari i istiëlait nuk është e domosdoshme ngjitja e gjuhës me qiellzën, ndërsa tek tipari i Itbakit është e domosdoshme ngjitja e gjuhës me qiellzën.

Çdo shkronjë e Itbakit është edhe e Istiëlasë, ndërsa çdo shkronjë e Istëlasë nuk është e Tibakit, dhe sa më shumë që ngjitet gjuha lart në kupolën e qiellzës, aq më shumë forcohet dhe shtrëngohet hapësira e prapme e zërit, dhe forcohet shkronja e Itbakit.

Cilësia e Itbakit i përcjell këto shkronja is në të lidhur të tyre me shkronjat tjera, si në të ndalur, si me sukun, si me zanore, mirëpo kur të jen me sukun dhe me teshttid duhet të jetë më e theksuar.

5. a) IDHLAKI - RRËSHQITËSE

IDHLAK gjuhësisht do të thotë mprehtësi gjuhësore, ose maja e gjuhës.
Idhlak në terminologji do të thotë: shpejtësimi, rrëshqitësimi, dhe lehtësimi i shqiptimit (artikulimit) të shkronjës për shkak se del prej majës së gjuhës ose prej buzëve. Shkronjat e Idhlakit janë 6:

ف ر م ن ل ب

Quhen majore (kep-ore) për shkak se një pjesë e tyre artikulohen prej majës së gjuhës siç janë ر ن ل dhe pjesa tjetër prej majës së buzëve, siç janë

ف ب dhe **م** . Andaj duhet pasur kujdes që gjatë artikulimit të tyre të mos ngatërrohen apo të mos përzihen njëra me tjetrën.

5. b) ISMAT - NGULLMUESE

ISMAT gjuhësisht do të thotë mosshpejtim, ngecje, ndalje.
Ismat në terminologji do të thotë ngecja, vështirësimi i artikulimit të shkronjës për shkak të artikulimit të saj larg majës së gjuhës.

Shkronjat e Ismatit janë të vështira për gjuhën, ndërsa shkronjat e Idhlakit janë të lehta për gjuhën, për këtë arsye, në gjuhën arabe çdo fjalë e cila ka më shumë se tri bashkëtingëllore, ka edhe ndonjë shkronjë të Idhhlakit, sepse po t'i kishte fjala prej 4 shkronjave e më shumë, vetëm shkronjat e Ismatit do të theksoheshin me vështirësi të madhe.

Nëse fjalën prej 4 shkronjave ose e shkronjave e hasim në gjuhën arabe dhe nuk e ka ndonjë shkronjë prej shkronjave të Idhlakit, menjëherë e kuptojmë se ajo fjalë nuk është arabe, por fjalë e huaj, pra fjalë e huazuar, ose e arabizuar.

Shkronjat e Ismatit janë të gjitha shkronjat tjera, pos shkronjave të Idhlakit.

Kundërvëniet (dallimet me vlerë funksionale) në sistemin e bashkëtingëlloreve të shqipes standarde përcaktohen nga mënyra e nyjëtimit (formimit), ku përfshihen shkalla e ngushtimit të pengesës, pjesëmarrja e tejzave të zërit dhe rezonatori hundor, si edhe vendi i nyjëtimit (formimit).

Tiparet që shërbejnë për krijimin e këtyre kundërvënieve ose tiparet dalluese të sistemit të bashkëtingëlloreve të shqipes standarde janë këto:

p	Mbylltore E shurdhët Buzore	/p ~ f/ /p ~ b/ /p ~ t/, /p ~ c/, /p ~ ç/, /p ~ q/, /p ~ k/
b	Mbylltore E zëshme Buzore	/b ~ v/, /b ~ p/, /b ~ d/, /b ~ x/, /b ~ xh/, /b ~ gj/, /b ~ g/,

	Gojore	/b ~ m/,
m	Hundore Buzore	/m ~ b/, /m ~ n/, /m ~ nj/,
f	Fërkimore E shurdhët Buzore	/f ~ p/, /f ~ v/, /f ~ th/, /f ~ s/, /f ~ sh/, /f ~ h/,
v	Fërkimore E zëshme Buzore	/v ~ b/, / v ~ f/, / v ~ dh/, / v ~ z/, / v ~ zh/, / v ~ j/,
t	Mbylltore E shurdhët Dhëmbore	/t ~ th/, /t ~ d/, /t ~ p/, /t ~ c/, /t ~ ç/, /t ~ q/, /t ~ k/,
d	Mbylltore E zëshme Dhëmbore	/d ~ dh/, /d ~ t/, /d ~ b/, /d ~ x/, /d ~ xh/, /d ~ gj/, /d ~ g/,
th	Fërkimore e shurdhët dhëmbore	/th ~ t/, /th ~ dh/, /th ~ f/, /th ~ s/, /th ~ sh/, /th ~ h/,
dh	Fërkimore E zëshme Dhëmbore	/dh ~ d/, /dh ~ th/, /dh ~ v/, /dh ~ z/, /dh ~ zh/, /dh ~ j/,
c	Mbylltore E shurdhët Alveolare	/c ~ s/, /c ~ x/, /c ~ p/, /c ~ t/, /c ~ ç/, /c ~ q/, /c ~ k/,
x	Mbylltore E zëshme Alveolare	/x ~ z/, /x ~ c/, /x ~ b/, /x ~ d/, /x ~ xh/, /x ~ gj/, /x ~ g/,
n	Hundore Alveolare	/n ~ x/, /n ~ m/, /n ~ nj/,
s	Fërkimore E shurdhët Alveolare	/s ~ c/, /s ~ z/, /s ~ f/, /s ~ th/, /s ~ sh/, /s ~ h/,
z	Fërkimore E zëshme Alveolare	/z ~ x/, /z ~ s/, /z ~ v/, /z ~ dh/, /z ~ zh/, /z ~ j/,
ç	Mbylltore E shurdhët Paraqiellzore	/ç ~ sh/, /ç ~ zh/, /ç ~ p/, /ç ~ t/, /ç ~ c/, /ç ~ q/, /ç ~ k/,
xh	Mbylltore	/xh ~ zh/,

	E zëshme Paraqiellzore	/xh ~ ç/, /xh ~ b/, /xh ~ d/, /xh ~ x/, /xh ~ gj/, /xh ~ g/,
sh	Fërkimore E shurdhët Paraqiellzore	/sh ~ ç/, / sh ~ zh/, /sh ~ f/, /sh ~ th/, /sh ~ s/, /sh ~ h/,
zh	Fërkimore E zëshme Paraqiellzore	/zh ~ xh/, /zh ~ sh/, /zh ~ v/, /zh ~ dh/, /zh ~ z/, /zh ~ j/,
q	E shurdhët Qiellzore	/q ~ gj/, /q ~ p/, /q ~ t/, /q ~ c/, /q ~ ç/, /q ~ k/,
gj	Mbylltore E zëshme qiellzore gojore	/gj ~ j/, /gj ~ q/, /gj ~ b/, /gj ~ d/, /gj ~ x/, /gj ~ xh/, /gj ~ g/, /gj ~ nj/,
nj	Hundore Qiellzore	/nj ~ gj/, /nj ~ m/, /nj ~ n/,
j	Fërkimore Qiellzore	/j ~ gj/, /j ~ v/, /j ~ dh/, /j ~ z/, /j ~ zh/,
k	Mbylltore E shurdhët Prapaqiellzore	/k ~ h/, /k ~ g/, /k ~ p/, /k ~ t/, /k ~ c/, /k ~ ç/, /k ~ q/,
g	E zëshme Prapaqiellzore Mbylltore	/g ~ k/, /g ~ b/, /g ~ d/, /g ~ x/, /g ~ xh/, /g ~ gj/, /g ~ k/,
h	Fërkimore prapaqiellzore	/h ~ k/, /h ~ f/, /h ~ th/, /h ~ s/, /h ~ sh/,
ll	Anësore Dhëmbore	/ll ~ d/, /ll ~ dh/, /ll ~ l/,
l	Anësore alveolare	/l ~ x/, /l ~ z/, /l ~ n/, /l ~ r/, /l ~ rr/, /l ~ ll/,
r	Dridhëse Njëdridhëse	/r ~ x/, /r ~ z/, /r ~ n/, /r ~ l/, /r ~ rr/,
rr	Dridhëse shumëdridhëse	/rr ~ x/, /rr ~ z/, /rr ~ n/, /rr ~ l/, /rr ~ r/,

a	E hapur	/a ~ ë/,

y	E përparme buzore	/y ~ u/, /y ~ i/.
u	E përparme E mbyllur	/u ~ y/, /u ~ o/.
o	E mesme	/o ~ u/.
ë	E mesme qendrore	/ë ~ a/, /ë~ e/.

TIPARET JOKUNDËRVËNËSE TË SHKRONJAVE

Tiparet jokundërvënëse të shkronjave janë:

1. SAFIRE - SHUSHULLUESE, FISHKËLLUESE, MPREHTËSUESE;
2. KALKALE - DRIDHËTUESE, TRONDITËSE, VIBRATUESE;
3. EL-LIJN - ZBUTËSUESE, LEHTËSUESE;
4. EL-INHIRAF - LAJKATUESE;

5. ET-TEKRIRË - PËRSËRITËSE;
6. ET-TEFESHIJ - ZHURMUESE, SHKAPËRDERDHËSE;
7. EL-ISTITALE - STËRZGJATUESE.

1. ES-SAFIRË – MPRETËSIA E TINGULLIT FISHKËLLUESE (Shushulluese) - PIPËZUESE

Safirë do të thotë zë, tingull, i cili buron prej gojës së kafshëve kur të pinë ujë.
Në terminologji do të thotë tingulli apo zëri i buruar prej shkronjave të caktuara (safirë), i cili depërton fuqishëm në aparatin e të dëgjuarit (veshët).

Shkronjat e t Safirit janë tri:

1. ز - za-un,
2. س - sin-un,
3. ص - sad-un.

Quhen shkronja Safirije për arsye se së bashku me shkronjën del një zë shtesë, i cili i ngjason zërit të shpendëve.

1. P.sh. Shkronja ص - i ngjason zërit të patës عصفور .
2. Shkronja س - i ngjason zërit të karkalecit اوز .
3. Shkronja ز - i ngjason zërit të bletës نحل .

Kategoritë e shkronjave të Safirit, për nga aspekti i fuqisë së shkronjës, janë tri:

1. Kategoria e parë, më e fuqishmja është shkronja ص .
2. Kategoria e dytë, ku bën pjesë shkronja ز , sepse ka hapje më të madhe.
3. Kategoria e tretë, ku bën pjesë shkronja س .

Përpos këtij kategorizimi kemi edhe ndarje tjetër të shkronjave të Safirit, e ato janë:

E para: Kur shkronja e Safirit është dyfishuar, pra me teshtid, është më e forta. P.sh.: الصَّالِحِينَ

E dyta: Kur shkronja e Safirit është me sukun (e pavokalizuar) Safiri është më i vogël. P.sh.: ٱصْبِرُوا

E treta: Kur shkronja e Safirit është me vokale Safir është më i vogli. P.sh.: صَبْرٌ

Mënyra e artikulimit: Shkronjat e Safirit artikulohen prej majës së gjuhës dhe dhëmballëve të poshtëm. Patjetër duhet të përkufizohet dhe mprehet artikulimi duke shtrënguar vendartikulimin, dhe duke lënë vetëm një zgavër të vogël prej ku del zëri.

Gabimet e artikulimit të Safirit:

1. Mospërikufizimi i zërit në vendartikulim, por lejimi i shpërndarjes së zërit, e në atë rast bëhet tefesh.
2. Mosformimi i zgavrës së vogël, ashtu që zëri del tepër i fortë.

2. KALKALE
DRIDHËSIM, TRONDITJE, VIBRIM, TRINGËLLUESE

Kalkale do të thotë lëvizje, dridhje, tronditje.

Kalkale në terminologji do të thotë të dridhësh, të tronditësh fuqishëm zërin e shkronjës së pavokalizuar në vendartikulimin e tij sa, që të kuptohet shumë i qartë.

Ndryshe quhet zë shtesë, i cili formohet për shkak të shtrëngimit dhe lirimit të menjëhershëm.

Shkronjat, të cilat bëhen kalkale (dridhen) janë pesë:

1. **ق**
2. **ط**
3. **ب**

4. ج
5. د

Shembuj të kalkales

صَمَد * الْحق * اشدْ * فَلَق * أبواب ، الطارق ، النَّجْدَيْن ، ابْتِغَاء ، شددنا ، اجْتنبوا ، خلقْنا ، أَفَتَطْمَعُونَ ، لَمْ يتب ، لَمْ يخرج ، لَقَدْ ، من بشاقق ، و لا تشطط

فسق * الْقَدر * الهدى * عهد * بالعبد * رطب *

Gabimet gjatë formimit të Kalkales

- Disa e lexojnë Subihan – fjalën sub-hane
  Halekkana – fjalën halekna,

Mirëpo Kalkale nuk anon as në ketra, as në fet-ha.

- Gjatë ndaljes së Kalkales, në fjalën ku para shkronjës së fundit është zanore e gjatë, formohet edhe një shkronjë shtesë:

حَمِيد * حمييد *

محيد * مجييد *

Shkaku i kalkales: është bashkimi i dy tipareve të plota, shtrëngimi i plotë (shide) dhe çlirimi i plotë (rehave) me sukunin e shkronjës, gjë, që prodhon tronditje të plotë në aparatin e të folurit dhe nevojitet përpjekje e madhe për t'i sqaruar që të dy tiparet, pra tubimin e fort të zërit dhe të ajrit në të njëjtën kohë.

Si bëhet kalkaleja?

Esenciale te artikulimi i shkronjave është që të bëhet bashkimi i organeve lëvizëse të shkronjave me organet jo lëvizëse të aparatit të të folurit kur të jenë me sukun. Kalkale as nuk është cilësi e shkronjës me cilësi të plotë, as cilësi e shkronjës me vokale (zanore) të plotë, por është mes i tyre, sepse as nuk bëhet hapje e plotë e gojës dhe e buzëve, as bashkim i plotë i buzëve, as zbritje e plotë e gjuhës në drejtim të nofullës së poshtme, por bëhet vetëm dridhje dhe tronditje.

Renditja e veprimeve për të prodhuar cilësinë e kalkales

1. Para rezonancës së ajrit, i cili del jashtë formimit të zërit, formohet një pengesë, e cila mbështet në vendartikulim, e cila pengesë rezulton bllokimin e zërit të shkronjës dhe ajrit së bashku, pra në të njëjtën kohë.

2. Shtrëngimi sa më i fortë i kësaj pengese për ta bllokuar ajrin.
3. Hapja e pengesës në mënyrë automatike dhe të befasishme, e cila shpie te shkapërderdhja e menjëhershme e ajrit të bllokuar pas bllokimit, e cila prodhon zë të fortë dhe të thekshëm.

Te kalkale më përparësi është që të dridhet dhe të jet më afër fet'has. Disa kanë dhënë mendime se:

- nëse para kalkalesë është fet'ha bëhet kalkale më afër fet'has. P.sh.: **أَقْرَب**
- nëse para kalkalesë është dame, bëhet kalkale më afër dames. P.sh.: **أُدْع**
- nëse para kalkalesë është kesre, bëhet kalkale më afër kesres. P.sh.: **إِقْرَأْ**

Disa kanë thënë shikohet zanorja pas kalkalesë, e jo para saj, e pastaj përshtatet.

SHKALLËT E KALKALES (TRINGËLLIMIT)

Në bazë të shkronjave të cilat munden të jenë më të forta ose jo më të forta, kemi tri shkallë (kategori) të kalkalesë, e ato janë:

1. **Shkalla e parë**

Këtu bën pjesë shkronja " **ط** " , e cila e ka edhe theksin, por edhe kalkalen (dridhjen) më të fortën. P.sh.: **قِطْمِير ، قِسْطْ**

2. **Shkalla e dytë**

Në këtë shkallë bën pjesë shkronja " **ج** " , e cila kalkalen (dridhjen) e ka të mesme. P.sh.: **خَرَجْ**

3. **Shkalla e tretë**

Në këtë shkallë bëjnë pjesë tri shkronjat tjera " **ق د ب** " të cilat e kanë dridhjen (kalkalen) më të dobët. P.sh.:

خَلَقْنَاهُ * يَدْخُلُونَ * ربوة *

Përpos kësaj ndarje kemi edhe ndarjen tjetër të kalkales, e ato janë tri kategori:

1. **Kategoria e parë**

Në këtë kategori bën pjesë shkronja e dyfishuar në të cilën ndalemi gjatë të lexuarit. Kjo dridhje është më e fuqishmja. P.sh.:

الْحَقّ * الْحَجّ * تَبّ *

2. **Kategoria e dytë**

Në këtë kategori bën pjesë shkronja në të cilën ndalemi gjatë të lexuarit:

اتوعيد * مد * خَلَقْ * كَسَبْ * مَجِيدْ * قَرِيبْ *

3. **Kategoria e tretë**

Në këtë kategori bën pjesë shkronja me sukun në mes të fjalës ku nuk guxojmë të ndalemi. P.sh.: **أَفَتَطْمَعُونَ**

3. EL-LIJN-i – ZBUTËSUESE LEHTËSUESE

EL-LIJNË gjuhësisht do të thotë lehtësuese, zbutësuese.
EL-LIJNË në terminologji do të thotë: Artikulimi i shkronjës prej vendartikulimit të tij me lehtësi të madhe, pa e ngarkuar gjuhë fare.

Shkronjat e Lijnit janë shkronja **ى** dhe **و** me sukun, me kusht që para tyre të jetë zanorja e shkurtë fet-ha. P.sh.:

خَوْفٌ * بَيْتٌ *

Dallimi mes shkronjave të Lijnit dhe të zanoreve të gjata

Në rend të parë duhet të themi se shkronjat e Lijnit dhe zanoret (shkronjat) e gjata i kanë të gjitha cilësitë e njëjta.

Cilësitë e shkronjave të Lijnit janë: Xhehr, rehave, istifal, infitah, ismat, el-lijn.

Cilësitë e zanoreve të gjata janë: Xhehr, rehave, istifal, infitah, ismat, el-lijn.

Që të dy llojet e shkronjave i nënshtrohen rregullit të zgjatimit se janë të lehta.

Mirëpo ndryshojnë në disa çështje tjera:

1. Ndryshojnë në vendartikulim, sepse dy shkronjat e Lijnit e kanë vendartikulimin e përcaktuar, pra shkronja "**ى** " e ka vendartikulim

mesin e gjuhës, ndërsa shkronja "و " ka bashkimin e buzëve, kurse zanoret e gjata و ا dhe ى vendartikulim e kanë tërë hapësirën e fytit, pra janë të lira dhe të papërcaktuara.

2. Shkronjat e Lijnit janë të buta vetëm nëse vazhdon leximi, ndërsa kalojnë, transformohen në shkronja të gjata nëse ndalet leximi në fjalë dhe pas tyre është shkronja me sukun. P.sh: **خوف ، قريش** , ndërsa shkronjat e gjata و ا dhe ى janë të gjata, si në të ndalur ashtu edhe në të vazhduar të leximit.
3. Zgjatimi i shkronjave të Lijnit humbet gjatë të vazhduarit të leximit, ndërsa shkronjat e gjata zgjaten edhe në të vazhduar edhe në të ndalur të leximit. Për këtë arsye zgjatimi i Linit i takon kategorisë më të dobët në renditje.
4. Shkronjat e Lijnit janë me sukun, ndërsa para tyre janë zanoret, kurse zanoret e gjata janë me sukun, ndara para tyre qëndron zanorja e ngjashme me ta. P.sh.: **ب بَا ، فِ فِي ا ، قُوا ق**

4. EL-INHIRAF – LAJKATUESE

INHIRAF do të thotë anim, lakim, shtrembërim, shmangie etj.
INHIRAF në terminologji do të thotë: Të marrësh shkronjën prej vendartikulimit të tij, dhe të mënjanuarit e saj deri te vendartikulimi i shkronjës tjetër.

Shkronjat e Inhirafit janë dy: ر - (ra-un) dhe ل - (lam-un).

Shkronja ل - **lami** anon prej cilësisë së fortësisë në mes, e nuk shkon në cilësinë e çlirimit të plotë, pra cilësi në mes të dy cilësive.

Shkronja ر - **ra-un** është shkronjë, e cila artikulohet prej vendit të " ن ", e cila është shkronja më e afërta nga lart e deri te shkronja "ل " .

5. TEKRIRË – PËRSËRITËSE

TEKRIRË do të thotë përsëritje.
TEKRIRË në terminologji do të thotë: Të dridhurit e majës së gjuhës në momentin e artikulimit të shkronjës.

Shkronja e tekririt është shkronja "ر ", sepse është shkronjë e ndërmjetme: mes shkronjave shidde (të shtrënguara) dhe rehave (të çliruara).

Duhet pasur kujdes gjatë përsëritjes, posaçërisht kur është në pyetje shkronja "ر " me sukun, ose me teshtid.

Gjatë artikulimit të shkronjës "ر " tekrir, nevojitet të formohet një zgavër e vogël, ashtu që, as të mos shkojë zërimi në tërësi, e as të mbyllet zërimi në tërësi, kështu të formohet PËRSËRITJA e plotë. Pra, as e tepruar, as e mëngët. P.sh.:

الرَّسُولُ * الرَّعْدُ * و حرّ موسى *
الرَّحْمَان الرَّحِيم* مِنْ شَرِّ *

6. TEFESHI – SHPËRNDARJE, SHKAPËRDERDHËSE, ZHURMIMI

Tefeshi do të thotë shpërndarje, përhaje, gjërim.
Në terminologji Tefeshi do të thotë: Shpërndarja, përhapja, zgjërimi i zërit të shkronjës " **ش** " në brendi të gojës.
Tefeshi bëhet vetëm një shkronjë, e ajo është shkronja " **ش** " .

Shpërndarja apo zgjerimi i shkronjës " **ش** " në brendi të gojës bëhet deri në atë masë sa të i afrohet vendartikulimit të shkronjës " **ط** " .

Disa dijetar e konsiderojnë edhe shkronjën " **ص** " shkronjë të Tefeshisë, dhe thonë se zëri i kësaj shkronje përhapet apo zgjerohet deri te shkronja " **ل** " (Lamit).

Disa të tjerë i kanë konsideruar shkronja të tefeshisë edhe shkronjën **ف ز س ص** dhe **ث** .
Shkallët e Tefeshisë janë tri:

1. Kur është me teshtid **الشَّيْطَانُ الشَّاكِرِينَ**
2. Kur është me sukun **الرُّشْدُ**
3. Kur është e vokalizuar **تخشى**

7. ISTITALE - STËRZGJATUESE

Istitale do të thotë zgjatim, zgjerim, shtrirje.

Istitale në terminologji do të thotë: Zgjatja dhe zgjerimi i gjuhës gjatë artikulimit të shkronjës **ض** , prej njërës anë e deri në anën tjetër, deri sa t'i afrohet vendartikulimit të shkronjës **ل** .

Shkronja e Istitales është vetëm shkronja **ض** .

Cilësia e Istitales në shkronjën **ض** duhet të përshkruhet gjatë artikulimit sikur të jetë e vokalizuar, sikur të jetë me sukun, mirëpo kur të jetë me sukun duhet të jetë më e qartë. P.sh.:

ضَرَبَ * ضرب * ضَارِبٌ * إِضْرِبْ *

Pse ndodhë Istitale në shkronjën **ض** ?

Vendi i shkronjës **ض** përfshinë vijë të gjatë, ajo përfshinë edhe dhëmballët, duke filluar nga ana e majtë dhe e djathtë e gjuhës. Kur gjuha ngrihet gjatë artikulimit të shkronjës **ض** (Dad), të dyja anët e gjuhës bashkohen me dhëmballët dhe bëhet tubimi i ajrit, atëherë zëri zgjatet dhe zgjerohet si pasojë e ngushtimit të venddaljes në të gjitha anët.

RENDITJA E SHKRONJAVE SIPAS FORTËSISË

Shkronjat e alfabeti për nga aspekti i fortësisë apo dobësisë ndahen në 5 lloje.

Shkronja ose mundet t'i ketë të gjitha cilësitë e forta, ose jo. Nëse i ka të gjitha cilësitë e forta quhet shkronja më e forta, por nëse shkronja ka disa cilësi të dobëta disa të forta, atëherë shikohet; nëse pjesa më e madhe e cilësive janë të forta quhet shkronjë e fortë; nëse pjesa më e madhe e cilësive janë të dobëta, quhet shkronjë e dobët. Por, nëse shkronja i ka të barabarta cilësitë e forta me cilësitë e dobëta, quhet shkronjë mesatare; nëse i ka të gjitha cilësitë e dobëta, quhet shkronjë më e dobëta. Pra, nga kjo që thamë, shkronjat janë pesë llojesh:

1. Shkronja të forta;
2. Shkronja më të forta;
3. Shkronja të dobëta;
4. Shkronja më të dobëta;
5. Shkronja mesatare.

Lloji i parë: Shkronja, e cila i ka të gjitha cilësitë e forta, ajo shkronjë është **ط** - Taun dhe absolutisht është shkronja më e forta.

Lloji i dytë: Shkronjat, tek të cilat cilësitë e forta dominojnë mbi cilësitë e dobëta quhen të forta, e ato janë tetë:

الصاء , الراء , الدال , الجيم , الباء ، الضاء , الظاء , القاف .

Lloji i tretë: Shkronjat, të cilat cilësitë e dobëta dominojnë mbi cilësitë e forta quhen shkronja të dobëta, e ato janë dhjetë:

الشين , السين , الزاى , الذال , الخاء , التاء , الياء , الواو , الكاف , العين .

Lloji i katërt: Shkronjat, të cilat i kanë të barabarta cilësitë e forta me cilësitë e dobëta quhen shkronja mesatare, e ato janë pesë:

النون , الميم , اللام , الغين , الهمزة .

Lloji i pestë: Shkronjat, të cilat i kanë të gjitha cilësitë e dobëta quhen shkronja më të dobëta, e ato janë shtatë:

الهاء , الفاء , الحاء , الثاء , dhe tri zanoret e gjata:

الف - me fet-ha para saj; **الواو** - me dame para saj; dhe **ياء** - me kesre para saj.

Prej të gjitha cilësive të shkronjave shohim se disa janë të forta, disa të dobëta. Për këtë arsye disa shkronja janë të fuqishme, disa të dobëta. Pra, shkronja e merr fuqinë në bazë të cilësive të saj të forta apo të dobëta. Për këtë arsye shohim se shkronja **ط** - Taun është shkronja e cila i ka në vete të gjitha cilësitë e forta dhe është më e fuqishmja , ndërsa **ه** është shkronja, e cila në vete i ka të gjitha cilësitë e dobëta, dhe është shkronja më e dobëta. Ndërsa shkronjat tjera janë në mes të këtyre dy shkronjave:

ط.....ه

Çdo shkronjë, më së paku, i ka 5 cilësi.

Shkronja " **ر** " është shkronja e cila ka 7 cilësi dhe maksimumi i cilësive është 7. Pra, disa shkronja i kanë 5 cilësi, disa 6 dhe disa 7 cilësi. Tani angazhohu që secilës shkronjë veç e veç t'ia tubosh të gjitha cilësitë.

1. Shkronjat e forta janë: **ظ ض ص ر د ج ب** dhe **ق** .
2. Shkronjat më të forta, në këtë grup bën pjesë shkronja, e cila i ka të gjitha cilësitë e forta, e në këtë grup bën pjesë shkronja **ط** .
3. Shkronjat e dobëta janë shkronjat, të cilat në vete dominojnë cilësitë e dobëta, e ato janë: **ت , خ , ذ , ز , س , ش , ع , ك** , shkronja **و** dhe **ى** me zanore dhe të buta.
4. Shkronja më të dobëta quhen shkronjat të cilat në vetvete posedojnë të gjitha cilësitë e dobëta. Në këtë grup bëjnë pjesë shkronjat: **ث , ح , ف** dhe **ه** .

   Në këtë grup bëjnë pjesë edhe shkronjat të cilat përpos të cilësive të dobëta kanë vetëm një cilësi të fortë, p.sh. tri zanoret e gjata. Pra, mund të themi se në këtë grup bëjnë pjesë shtat shkronja.

   Më e dobëta e të gjitha shkronjave është shkronja **ه** .
Fjalët të cilat unanimisht janë të pajtimit që në disa raste t'i shkruajnë të bashkëngjitura, në disa raste tjera t'i shkruajnë të ndara, mirëpo në disa raste kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi i shkruarjes së atyre fjalëve ndaras.

Këto fjalë janë katër:

- Fjala " **ان** "me fjalën " **لا** "

(El-Earafë, 105) **حقيق عَلَى ان لا أَقُول عَلَى اللهِ إِلَّا الْحق**

(El-Earafë, 169) **ان لا يقول عَلَى اللهِ إِلَّا الْحَق**

(El-Earafë, 118) **و ظنُّوا ان لا ملجأ من اللهِ إِلَّا إِلَيْهِ**

و ان لا إِلَـهَ إِلَّا هُوَ
وَ ان لا نعبدوا إِلَّا الله
ان لا تشرك بى شيئًا
ان لا نعبد الشيطان
ان لا تعلوا عَلَى اللهِ
عَلَى ان لا يشركن بالله شَيْئًا
ان لا يدخلنهم الْيَوْم
ان لا إِلَـهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ

Përpos këtyre rasteve në rastet tjera shkruhen të ngjitura, si p.sh.:

أَلَّا تَعلوا عَلَى ...

LLOJI I SHTATË

Fjalët, të cilat shkruhen ndaras unanimisht në disa vende, të bashkëngjitura unanimisht në disa vende, ndërsa për rastet tjera kanë dhënë mendime të ndryshm, por anon mendimi të jenë të shkruara të bashkëngjitura.

a) Fjala " **إِنَّ** "me fjalën " **مَا** "

Në një vend shkruhen ndaras dhe për këtë janë pajtuar të gjithë:
(Err-Rrumë, ...) **إِنَّ مَا تُوعَدُونَ لَآت**

Kanë dhënë mendime të ndryshme për në një vend, por anon mendimi të jenë të bashkëngjitura:
(En-Nahl, ...) **إِنَّمَا عِندَ اللهِ خَيْر لَكُمْ**

Në të gjitha rastet tjera këto dy fjalë bashkëngjiten sipas mendimit unanim. P.sh.:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُون اخوة

b) Fjala " **أَنَّ** "me fjalën "**مَا** "
Për në dy vende janë pajtuar të gjithë shkruesit e Kur'anit që të shkruhen ndaras:
(El-Haxh, ...) **وَ أَنَّ مَا يَدْعُونَ مِن دُونِهِ هُوَ الْبَاطِل**
(Lukman, ...) **وَ أَنَّ مَا يَدْعُونَ مِن دُونِهِ هُوَ الْبَاطِل**

Për në një vend kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi që të jenë të bashkëngjitura:
(El-Enfal, ...) **وَ اعْلَمُوا أَنَّمَا غنمتم**

Ndërsa në të gjitha rastet tjera shkruhen të bashkëngjitura sipas mendimit unanim:

وَ اعْلَمُوا أَنَّمَا الْحَيَاة الدُّنْيَا

c) Fjala "**مِنْ** "gjinore me fjalën "**مَا** "mevsulije
Të gjithë shkruesit e Kur'anit janë pajtuar që në dy vende të shkruhen ndaras:
(En-Nisa, ...) **فَمِن مَّا ملكت ايمانكم**
Err-Rrum, ...) **هل لَّكُم مِن مَّا ملكت ايمانكم**

Në një vend ka dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi i shkruarjen ndaras:
(El-Munafikun, ...) **وَ انفقوا مِن مَّا رزقناكُمْ**

Në të gjitha rastet tjera shkruhen të bashkëngjitura, si p.sh.:

مِمَّا تُحِبُّون

d) Fjala "**فِى** "gjinore me fjalën "**مَا** "mevsulije dhe pyetëse
Të gjithë shkruesit e Kur'anit janë pajtuar që në një vend të shkruhen ndaras:
(Esh-Shuaraë, ...) **اتتركون فِى مَا هَا هُنَا امنين**

Në dhjetë vende kanë mendime të ndryshme, por anon mendimi i shkruarjes ndaras:

فِى مَا فعلن فِى انفسهن (El-Bekare, ...)
فِى مَا كنتم
فِى مَا آتَاكُم
فِى مَا أوحى الي
فِى مَا اسهت أَنفسهم
فِى مَا افضتم
فِى مَا رَزَقْنَاكُمْ
فِى مَا فِيهِ يَخْتلفُون
فِى مَاكَانُوا فِيهِ يَخْتلفُون
فِى مَا لا تَعْلَمُونَ (El-Vakiatu, ...)

Në të gjitha rastet tjera shkruhen të bashkëngjitura, si p.sh.:
(En-Nahl dhe El-Xhathije, ...) **فِى مَاكَانُوا فِيهِ يَخْتلفُون**
(En-Nisa, ...) **قَالُوا فِيمَا كنتم**

e) Fjala "**أَيْنَ** "me fjalën "**مَا** "
Në dy vende në Kur'an shkruhen të bashkëngjitura dhe kjo sipas mendimit unanim:
(El-Bekare, ...) **فَأَيْنَمَا تُوَلُّوا**
(En-Nahl, ...) **أَيْنَمَا يوجهه**

Për në tre vende në Kur'an shkruesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi që ato të jenë të shkruara ndaras:

أَيْنَ مَا تكونو يدرككم الْمَوْت
أَيْنَ مَا كنـتم تعيدون
أَيْنَ مَا ثقفوا (El-Ahzab, ...)

Në të gjitha rastet tjera shkruhen të ndara. P.sh.:

أَيْنَ مَا كَانُوا (El-Muxhadele, ...)

e) Fjala "**كُلٌّ**"me fjalën "**مَا**"

Të gjithë janë pajtuar që të shkruhen ndaras në një vend:

مِنْ كل مَا سَأَلْتُمُوهُ (Ibrahim, ...)

Për në katër vende kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi që të jenë të bashkëngjitura:

كلمَا رُدُّوا (En-Nisa, ...)

كُلَّمَا دَخَلَتْ أُمةٌ (El-Earafë, ...)

كلمَا جَاء امة رسولها (El-Muëminin, ...)

كلمَا القى فِيهَا فوج (El-Mulk, ...)

Përpos këtyre rasteve në të gjitha rastet tjera të gjithë janë pajtuar të shkruhen të bashkëngjitura:

كلمَا دخل عَلَيْهَا زَكَرِيا (Merjem, ...)

LLOJI I TETË

Fjalët për të cilat, për në disa vende, të gjithë janë pajtuar të shkruhen ndaras, për në disa vende të gjithë janë pajtuar të shkruhen të bashkëngjitura, për në disa vende kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi të shkruhen ndaras, për në disa vende tjera prapë kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi të jenë të bashkëngjitura.

- Fjala "**بِئْسَ**"me fjalën "**مَا**"

Të gjithë janë pajtuar që të jenë të bashkëngjitura, p.sh.:

بِئْسَ اشتروا (El-Bekare, ...)

بِئْسَ خَلَفْتُمُونِى (El-Earafë, ...)

Për në një vend kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi të jenë të ndara:

وَ لَبِئْسَمَا شروا به انفسهم (El-Bekare, ...)

Për në një vend tjetër kanë dhënë mendime të ndryshme, por anon mendimi të jenë të bashkëngjitura:

قُلْ بِئْسَمَا يَأْمُرُكُم (El-Bekare, ...)

Në të gjitha vendet tjera shkruhen ndaras:

فَبِئْسَمَا يَشْتَرُونَ

Këto janë 42 fjalët e ndara në tetë lloje, për të cilat janë pajtuar të gjithë dijetarët.

ITHBATI DHE HADHFI
(TË SHKRUARIT DHE ANULIMI)

Në gjuhën arabe kemi dy lloje të shkronjave: shkronjat e shëndosha dhe shkronjat e sëmura. Shkronjat e sëmura janë tri: ا ، و dhe ى , ndërsa të gjitha shkronjat tjera janë të shëndosha.

Çdo lexues i Kur'anit e ka vaxhib të dijë formën e leximit, sa i takon leximit të ndonjë shkronjeje kur të ndalet apo mosleximi i asaj shkronjeje nëse nuk ndalet në atë fjalë. Po ashtu duhet ditur çka është eliminuar në të shkruar, vetëm se duhet cekur këtu kemi të bëjmë me tri shkronjat: ا ، و dhe ى si pjesë të fjalës, se për shkronja tjera jo.

RASTET E TË SHKRUARIT DHE TË ANULUARIT TË ELIFIT

1. Në 8 raste është e domosdoshme që "Elifi - ا " të lexohet ashtu siç është e shkruar nëse ndalemi, ndërsa nëse nuk ndalem, por e vazhdojmë leximin, atëherë "Elifi - ا " nuk lexohet fare:

1. a) Çdo herë kur "Elifit - ا " i paraqitet fjala e cila është me sukun, atëherë dy sukunat kontaktojnë njëra me tjtrën, në të vazhduar të leximit nuk lexohet "Elifi - ا " si zanore e gjatë, por fjala lexohet me zanore të shkurtër.
P.sh.:

عن تلكما - عن تلكما الشَّجرة

كلتا ـ كلتا الْجَنَّتَيْنِ
وَ قَالا ـ وَ قَالا الْحَمْدُ للهِ

1. **b)** Në fjalën "**أَيُّهَا** " nëse ndalet leximi në këtë fjalë lexohet "Elifi - ا ", nëse vazhdohet leximi eliminohet "Elifi - ا ", me fjalë tjera nuk lexohet. P.sh.:

يَآ أَيُّهَا النَّاسُ . يَآ أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا

Mirëpo, në tre vende "Elifi - ا " është eliminuar në të shkruar, prandaj nëse ndalet leximi në atë fjalë atëherë nuk lexohet "Elifi - ا ".
Këto tre raste në Kur'an janë:

1. (En-Nur, ...) **ايه الْمُؤْمِنُونَ**
2. (Ez-Zuhruf, ...) **يَا أَيُّهَ السَّاحِرُ**
3. (Err-Rrahman, ...) **أَيُّهَ السَّاحِر**

1. **c)** Elifi lexohet në të ndalur të leximit, ndërsa nuk lexohet nëse vazhdohet leximi: P.sh.:

(El-Ahzab, 10) **الظنونا**
(El-Ahzab, 66) **الرسولا**
(El-Ahzab, 17) **السَّبِيلا**
(El- Insan, 15) **قَوَارِيرَا**

Elifi i fjalës së dytë (**قَوَارِيرَا**) në ajetin vijues të kësaj sureje nuk lexohet edhe në rast të ndaljes edhe në rast të vazhdimit.

1. d) Elifi lexohet në të ndalur të leximit, por nuk lexohet në të vazhduar të leximit, si zëvendësimi i " nunit - **ن** " përforcues:

(Jusuf, ...) **وَ لِيَكُونا مِنَ الصَّاغِرِينَ**
(El- Elalek, ...) **لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ**

1. e) Elifi lexohet në të ndalur, ndërsa nuk lexohet në të vazhduar të leximit kur të jetë zëvendësuesi (Bedel) i tenvinit. P.sh.:

شَيْئًا شَيْئًا
اهْبِطُوا مِصْرًا اهْبِطُوا مِصْرًا

1. f) Nuk lexohet në të vazhduar të leximit, lexohet në të ndalur te fjala " **اذًا** ":

اذًا لا بتغوا

1. g) Nuk lexohet në të vahduar të leximit, lexohet në të ndalur te përemri vetor " **أَنَاْ** ":

أَنَاْ أَكْثَر مِنكَ مَلًا

3. h) Nuk lexohet në të vazhduar të leximit, lexohet në të ndalur te fjala " **لكنا** ":

لكنا هُوَ الله رَبِّى

Mosleximi i Elifit në të ndalur edhe pse në të shkruar ekziston.

Nuk lexohet elifi në të ndalur edhe pse është i shkruar, pra kjo i ngjason sikurse të vazhduarit e leximit edhe pse ndalemi në fjalën: **ثَمُودًا**
(Hudë, ...) **الا ان ثَمُدا كَفَرُو رَبّهم**
(El-Furkan, ...) **وَ عَادًا وَ ثَمُودًا وَ أَصْحَاب الرّس**
(El-Ankebut, ...) **وَ عَادًا وَ ثَمُودًا وَ قد تبين لكم**
(En-Nexhm, ...) **وَ ثَمُودًا فَمَا ابقى**

Pra, tenvini shndërrohet në zanore të shkurtë, jo në zanore të gjatë si në raste tjera.

Lejohet edhe leximi i Elifit, por edhe mos leximi në të vazhduar të leximit te fjala **سلاسلا** në suretu Ed-Dehr.

2. RASTET E TË SHKRUARIT DHE TË ANULUARIT TË JA-UT

2. a) Rastet kur shkronja "**ى** " është eliminuar në të shkruar, prandaj edhe nuk lexohet pasi që nuk është e shkruar edhe pse në rregulla sintaksore konsiderohet "**ى** " i cili ekziston në mendje si rregull:

1. **وَ اللّيل اذًا يسر- يسرى**

2. b) Është eliminimi për të mos lejuar takimin e dy sukunave. P.sh.:

وَ سَوْفَ يؤت الله الْمُؤْمِنِين
فَلا تخشوهم وَ اخشون (وخشونى)

ننج الْمُؤْمِنِين
بِالْوَادِ الْمُقدس
وَ ان الله لهاد
على واد النمل
الواد الايمن
بهادى العمى
ان يردن الرَّحْمَـٰن
صَال الْجَحِيم
قُلْ يَا عِبَادا الَّذِينَ
ينادى لمناد
فمَا تغن النّذر
وَلَهُ الْجوار
الْوَاد المقدس . الْجَوَار الْكُنَّس

2. c) Lejohet leximi në fjalën " **اتان** " në të ndalur, por edhe lejohet moslexim:

فما اتان الله

LEXIMI I SHKRONJËS "ى " NË TË NDALUR, MOSLEXIMI NË TË VAZHDUAR

2. d) Shkronja "**ى** " lexohet ashtu siç është e shkruar nëse ndalem në atë shkronjë, ndërsa nëse e vazhdojmë leximin nuk e lexojmë fare. Kjo nga shkaku se nëse vazhdohet leximi bien ndesh dy sukuna, pra sukuni i shkronjës "**ى** " dhe i shkronjës pasuese. P.sh.:

حَاضِرى حَاضِرى الْمَسْجِدِ الْحَرَام
Hadiril mesxhidil Haram Hadirij

(Mehalij) **محلى - محلى الصيد** (Mehalis-sajdi)
(Gajre muëgjizij) **غير معجزى - غير معجزى الله** (Gajre muëgjizil-lah)
(Il-la eta) **الا اتى - الا اتى الرَّحْمَـٰن عبدا** (Il-la atirr-Rrahmani abda)
(vel mukimij) **وَ الْمقيمى - وَ الْمقيمى الصَّلاة** (vel mukimis-salate)
(Muhlikij) **مهلكى - مهلكى الْقرى** (Muhlikil kura)

او الى الأيدى او الى الأيدى و الأبصار

3. LEXIMI I SHKRONJËS "و - vavun" NË TË NDALUR, MOSLEXIMI NË TË VAZHDUAR TË LEXIMIT

Është vaxhib që shkronja "**و** " të lexohet nëse në atë shkronjë ndalemi, dhe është e shkrua, ndërsa nëse është e eliminuar në të shkruar atëherë nuk e lexojmë. P.sh.:

(jemhullah) **يمحوا الله - يمحوا** (jemhuu)

(Xhabus-sahrate) **جَابوا الصخرة - جَابوا** (Xhabuu)

Vetëm se në pesë raste në Kur'an "**و** " është eliminuar para se të shkruhet në mus'haf, andaj nëse ndalemi nuk e lexojmë, edhe pse në mendje, në sintaksë ekziston:

(Esh-Shura) **و يمحوا - و يمح الله**

(El-Isra) **وَ يدعوا - وَ يدع الْإِنسَان**

(El-Kamer) **وَ يدعوا - وَ يدع الداع**

(Et-Tahrim) **وَ صَالحوا - وَ صَالح الْمُؤْمِنين**

(El-Alek) **سَنَدْعُوا - سَنَدْعُ الزَّبَانِيَة**

KAPITULLI I GJASHTË

ZGJATIMI DHE JOZGJATIMI I ZANOREVE

ZANORET

Zanoret janë dy llojesh:

1. Zanoret e shkurtra dhe
2. Zanoret e gjata.

1. ZANORET E SHKURTA – KASR

Zanoret janë dy llojesh:

1. Zanoret e shkurta dhe
2. Zanoret e gjata.

Zanoret e shkurta, apo Kasr

- **Kasr** do të thotë pengim, ndalim, përkufizim,
- **Moslexim i shkronjës sa dy vokale e më shumë,**
- **Pra, nuk do të thotë shkurtim absolut, por shkurtim nën dy vokale. P.sh.** **قُلْ** **صُمْ**

  Kul Sum

Zanorja e shkurtë është esenciale dhe çdo zanore tjetër jo e shkurtë duhet ta ketë shkakun dhe arsyen e zgjatjes.

قُلْ صُمْ قَدْ صَلِّ

Sal-li Kad

إِنْ رَبِّ بَلْ أَنَّ كَأَنَّ

رَدَّ أَحَدٌ صَمَدٌ لَمْ يَلِدْ

Çdo shkronjë e cila në vetvete ka fet-hatun, damen ose kesren, dhe nuk ka diçka tjetër, ajo shkronjë lexohet me zanore të shkurtë.
Haram është që zanorja e shkurtë të lexohet gjatë. Nëse ndodhë që zanorja e shkurtë të këndohet e gjatë, në të shumtën e rasteve fjala e ndryshon rrënjësisht kuptimin dhe merr kuptim të fjalës tjetër, apo kuptim të kundërt të fjalës.

Plotësimi i Zanoreve

- Zanorja - u - nuk konsiderohet e plotë, por mbetet e mangët nëse nuk bëhet bashkimi i buzëve, kështu shkronja e cila e ka këtë zanore nuk mund të theksohet e plotë.
- Zanorja - i - (kesret-un) nuk këndohet e plotë, por jetë e mangët, nëse goja nuk hapet çlirshëm.

Zanorja e shkurtë është zanorja më e rëndësishme në të folurën e gjuhës arabe.

ZANORET E GJATA

ZGJATJET NATYRORE (MEDI TABIIJ)

Med – gjuhësisht do të thotë zgjatim, shtim.
Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe ju shton juve me pasuri e fëmijë"**

Në terminologji MED do të thotë: zgjatja e zërit në tri shkronjat zgjatuese (ا و dhe ى) kur të shoqërohen me hemze ose me sukun.

Kur në fjalë sëtë shkronja prej shkronjave të zgjatimit (ا و dhe ى) të paraprirë me fet'ha, dame ose kesre, dhe nuk e pason hemzeja ose sukuni quhet zgjatim natyror – MEDI TABIIJ.
Quhet natyror se njeriu natyrshëm e zgjatë; as nuk e zgjatë shumë dhe as nuk e shkurton. P.sh.:

قَالَ	قِيلَ	يَقُولُ
Kaale	Kiile	Jekuulu

Zgjatimi i zërit më shumë se sa nevojitet te shkronja dhe te zanorja e rëndomt.

Zanoret e gjata janë:
Elifi i pavokalizuar me kusht që para saj të jetë fet-ha. - ا

Vavi i pavokalizuar me kusht që para saj të jetë kesretun - و

Jaun i pavokalizuar me kusht që para saj të jetë kesretun - ى
Këto dijetarët i kanë përfshirë në një fjalë: **نو حيها**

نو	حي	ها

Këto tri shkronja janë shkronjat më specifike, shkronjat më të fshehta. Më e fshehta është **الألف** elifi, pastaj **الياء** Ja-un, pastaj **الواو** Vavi.

Zanoret e gjata (ا ى dhe و) kanë 5 cilësi:

El-Xhehr	Err-Rrehave	El-Istifal	El-Infitah	El-Ismat
Haptësuese	Zbutësuese	Zëultësuese	Shkëputëse	Ngulitëse

Zgjatja natyrore zgjatet dy vokale.
Quhet natyrore, sepse as nuk zgjatet shumë, por në të njëjtën kohë nuk shkurtohet apo nuk mangësohet nga zgjatimi i natyrshëm i zërimit:

قل قولوا صم صوموا
Kul Kuu luu Sum Suu muu

قَالَ قِيلَ يَقُولُ
Kaale Kiile Jekuulu

إِنْ إِنِّى رَبِّ رَبِّى لِ لِى
In Innii Rabi Rabii Li Lii

قَدْ قَالَ صَارَا
Kad Kaale Saa raa

قَالَ كِتَبٌ أَلِيمٌ قِيلَ غَفُورٌ يَقُولُ شَكُورٌ
Kaale Kitaab Eliim Kiile Gafuur Jekuulu Shekuur

Nga shembujt e përmendur kuptojmë se:

Shkronja e cila përpos zanores së shkurtë (__َ___ _____ ___ُ__) ka edhe ndonjërën prej tri zanoreve të gjata (ا و dhe ى) këndَohet gjatë sa dy vokale dhe quhet zgjatje natyrore që në gjuhën arabe quhet MEDI TABIIJ (Zgjatim Natyror).

Rregull:
Medi Tabiij – pra zgjatja natyrore është obliguese – vaxhib, sepse për të janë pajtuar të gjithë ekspertët e leximit të Kur'anit (Kurratë).

- Nëse këndohet shkurt zanorja e gjatë është haram.

Shart është të mos ketë pas zanoreve të gjata hemze apo sukun.

LLOJET E ZANOREVE TË GJATA

Medi Tabiij (zgjatja natyrore) ndahet në dy lloje:

1. Medi Tabiij i shkronjës,
2. Medi Tabiij i fjalës.

1. Medi Tabiij i shkronjës

Në këto shkronja bëjnë pjesë 5 shkronja të fillimit të sureve, e ato janë:

حی طهر

Quhet medi tabiij i shkronjës për arsye se pas shkronjës nuk ka hemze apo sukun, për dallim nga zgjatimi natyror i fjalës ky zgjatim bëhet pa marrë parasysh a vazhdojmë leximin apo jo.

ح – حا ، ط – طا ، ي – يا ، ه – ها ، ر – را

Po kështu ndodh edhe me fjalët:

وَ قَالا ، وَ قَالا ٱلْحَمْدُ لِلَّهِ
وَ قَالُوا ، وَ قَالُوا ٱلْحَمْدُ لِلَّهِ
وَ قَالُوا ، وَ قَالُوا ٱتخذ

Në Kur'an MEDI TABIIJ I SHKRONJËS vjenë në 21 raste:

- 7 herë shkronja ح ,
- 2 herë shkronja ي , Jasin, Merjem;
- 4 herë shkronja ط , Taha, Shura;
- 2 herë shkronja ه , Merjem, Taha;
- 6 herë shkronja ر , Junus, Hud, Jusuf, Raëd, Ibrahim, Hixhr.

Pra, gjithsejtë njëzet e një herë.

2. Medi Tabiij i fjalës

Medi Tabiij i fjalës vjen në tri forma:

1. **Forma e parë:** Kur zgjatimi bëhet si në vazhdimin e leximit ashtu edhe në rast të ndaljes së leximit

و لم يولد قالوا

2. **Forma e dytë:** Kur zgjatimi bëhet në rast të ndaljes së leximit, ndërsa shkurtohet në rast të vazhdimit të leximit, p.sh.:

هُدًى مُصَلًّى

وَكِيلًا
أَنَاْ نَذِيرٌ
وَ قَالُو ا سجدُ لِلَّهِ قُلْ ادْعُوا الله

3. **Forma e tretë:** Kur zgjatet Medi Tabiij nëse e vazhdojmë leximin, ndërsa zgjatet më shumë (zgjatje jonatyrore) nëse ndalemi, p.sh.:

الْعَالَمِينَ الْحِسَاب

Në këto raste, pra Medi Tabiij në esencë nuk humbet, por mund të zgjatet, që do të thotë prej zgjatimit natyror kalohet në zgjatim jonatyror:

- 2 vokale,
- 4 vokale,
- 6 vokale.

ZGJATJA JONATYRORE

Zgjatja jonatyrore bëhet ose për shkak të hemzes, ose për shkak të sukunit. Me zgjatje jonatyrore kemi për qëllim zgjatimin më shumë se dy vokale.

Hemzeja është shkaktar i tre zgjatimeve, e ato janë:

1. Zgjatimi i përngjitur- *mutasil* (në mes të fjalës),
2. Zgjatimi i përndarë - *munfasil* (në mes dy fjalëve – kufirin në mes dy fjalëve),
3. Zgjatimi i zëvendësimit - *bedel*.

Sukuni është shkaktar i dy zgjatimeve tjera, e ato janë:

1. Zgjatimi i domosdoshëm (Lazim),
2. Zgjatimi i paraqitjes së nevojës apo rastit (Arid).

1. MEDI MUTASIL – ZGJATJE NDËRFJALORE (PËRNGJITUR)

Atëherë kur pas njërës prej zanoreve të gjata (ا ، و dhe ى) pason hemzeja bëhet togimi i zanoreve të njëjta, zgjatim jonatyror dhe quhet MEDI MUTASIL – ZGJATIM I PËRNGJITUR. P.sh.:

جَآءَ	**سَآءَ**	**مَآءٌ**	**سَمَآءَ**	**شَآءِ**
Xhaaaae	Saaaae	Maaaaun	Semaaaae	Shaaaae
جِىءَ	**سِىءَ**	**جَآئَكُمْ**		
Xhiiiie	Siiiie	Xhaaaaekum		
سُوءٌ	**تَبُوءَ**			
Suuuue	Tebuuuue			

- Medi Mutasil zgjatet 4 dhe 5 vokale.
- Medi Mutasil zgjatet edhe 6 vokale kur të jetë Medi Mutasil arid lisukun, hemzeja dhe elifi.
- Është zgjatje e domosdoshme (VAXHIB) dhe nuk lejohet assesi të shkurtohet.
- Pra, gjithmonë kur njëra prej zanoreve të gjata dhe pas tyre hemzeja gjendet në një fjalë quhet Medi Mutasil:

... أَنْزَلَ مِنَ السَّمَآءِ مَآءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقاً لَكُمْ ...

فَمَن شَآءَ فَلْـيُؤْمِن ، دُعَآؤُكُمْ ، نِسَآؤُكُمْ ، آبَآؤُكُمْ
فَمَن شَآءَ فَلْـيَكْفُر

- Shkak i zgjatimit është **hemzeja**.
- Shart është që zanorja e gjatë dhe hemzeja të jetë në një fjalë.
- Zgjatimi ndërfjalorë (Medi Mutasil) është vaxhib.
- Është vaxhib për arsye se të gjithë ekspertët e leximit të Kur'anit janë pajtuar për të.
- Shkak është zgjatimi jonatyror se hemzeja është shkronja e fuqishme e fortë, ndërsa zanoret e gjata janë të lehta dhe bëhet zgjatimi për ta përforcuar të dobëtën për arsye se e forta e ka afër të dobëtën.

Lexuesi duhet t'i zgjatë të gjitha medi mutasilët njësoj. Për shembull, nëse në fillim të leximit e zgjatë medi mutasilin 4 vokale, atëherë deri në fund të leximit gjithnjë e zgjatë 4 vokale, ndërsa nëse në fillim të leximit medi mutasilin e zgjatë 5 vokale, atëherë deri në fund të leximit gjithnjë i zgjatë 5 vokale; Nuk lejohet që disa MEDIMUTASILË të zgjaten 4 vokale e disa tjerë 5 vokale, edhe pse kjo nuk është haram as mekruh, por është e papëlqyer te Kurratë (ekspertët e leximit të Kur'anit) dhe në dis-harmoni me përpikërinë e leximit:

... أَنْزَلَ مِنَ السَّمَآءِ مَآءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقاً لَكُمْ ...

Medi Mutasil bëhet zgjatja e saj 4 vokale dhe 5 vokale kur hemzeja është në mes të fjalës ose kur hemzeja është në fund të fjalës dhe leximi vazhdon në fjalën tjetër. Ndërsa nëse hemzeja është në fund të fjalës dhe leximi përfundon në hemze, atëherë bëhet zgjatja 6 vokale.

2. MEDI MUNFASIL
- ZGJATJE JASHTËFJALORE (E PËRNDARË)

Sikurse te zgjatja e përngjitur ashtu edhe te fjala e përndarë shkaktar i zgjatimit jonatyror është Elifi – ا, ky zgjatim është zgjatim në kufirin mes dy fjalëve.

Atëherë kur pas njërës prej zanoreve të gjata (ا ، و dhe ى) vjen elifi (ا) bëhet zgjatim jonatyror dhe quhet ZGJATIM I PËRNDARË - MEDI MUNFASIL. P.sh.:

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ ، إِنَّا أَنزَلْنَاهُ ، إِلَى أَمْرِ اللهِ ، يَآ أَيُّهَا , لا أَعْبُدُ , وَ لا أَنتُمْ , مَا اَغْنَى إِنِّى أَخَافُ ، إِنِّى إِذًا قُوا أَنفُسَكُمْ .

Pra, medi munfasil është kur zanorja e gjatë është në fund të fjalës së parë, ndërsa hemzeja në fillim të fjalës së dytë.

Nëse ndalemi në fund të fjalës së parë dhe nuk e vazhdojmë leximin kthehet në bazë dhe këndohet 2 vokale, pra zgjatje natyrore.

- Medi munfasil zgjatet 4 vokale **إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ ، قُوا أَنفُسَكُمْ .**
- Është zgjatje e lejuar, për arsye se Kurratë – ekspertët e leximit të Kur'anit e kanë zgjatur dy vokale, disa 4, disa 5, disa edhe 6 vokale.
- Pra, gjithmonë kur njëra prej zanoreve të gjata gjindet në fund të fjalës dhe pas asaj fjale fillon fjala vijuese me elif (ا) quhet MEDI MUNFASIL.

Nëse ndalemi në fund të fjalës së parë dhe nuk e vazhdojmë leximin, këndohet dy vokale, pra si zgjatje natyrore, sepse në këtë rast i humb shkaku (hemzeja).

Nëse ndalemi në shkronjën "**ه**" e cila e ka rolin e përemrit vetor (Damire) humb edhe gjatësia natyrore (medi tabiij) në tërësi, sepse ndërpritet lidhja e fjalëve, e në të njëjtën kohë edhe shkaku.

Shkaku se këndohet dy vokale është se hemzeja është në një fjalë tjetër, e në rast të ndaljes hemzeja nuk bashkëngjitet, por mbetet në fjalën tjetër dhe zanorja e gjatë mbetet e vetme, si zgjatje natyrore, që do të thotë se rikthehet në bazë, pra si zgjatje natyrore.

بِمَا أَنـزَلَ ، إِنَّآ أَنزَلْنَاهُ ، إِنِّى~ أَخَافُ ، تُوبُوا إِلَى اللهِ ،بَمَآ أَنزَلَ ، وَ فِى~ أَنفُسِكُمْ
فَلَمَّا أَضَآءَتْ

قُولُوا آمَنَّا بِا للهِ
قُوا أَنفُسَكُمْ
فِى أُمِّهَا
رَبِّ أَعْلَمُ
يَـأَيُّهَا
هَأَنتُمْ
وَ لَهُ أَسْلَمَ
وَ أَمْرُهُ إِلَى اللهِ
يوُده إِلَيْكْ
بِهِ إِلَّا أَنْ يحاط بِكُمْ

Nëse bëhet ndalja në fjalën e parë, atëherë zgjatja bëhet *zgjatje natyrore.* Vetëm se duhet pasur parasysh se te fjalët me përemër vetor nuk ka zgjatje po ashtu nuk lejohet ndalja te fjalët e ngjitura **يَـأَيُّهَا** , sepse në traditë këto dy fjalë janë bë si një fjalë dhe nuk ndahen.

Nuk lejohet që disa herë medi munfasilin të zgjatet dy vokale e herëve tjera 4 vokale, dhe herëve tjera 5 vokale.

Vaxhib është barazimi i Medi munfasilit me Medi Mutasilin, nëse medi munfasili zgjatet 4 vokale, atëherë edhe medi mutasili 4 vokale, nëse medi munfasili zgjatet 5 vokale, atëherë edhe medimunfasili zgjatet 5 vokale, e jo 4 vokale.

مَلَآئِكَةُ ، السرائر ، ليسوءو وجوهكم ، ال ..... ، هَنِيـئًا مَرِيـئًا ، يَشَآءُ
سُفَآءُ ، قُرُوء ، بِالسُّوءِ ، النَّسِـئُ ، تُضِـئُ ،



حكمه: وجوب المد	حكمه جواز مد وقصر	حكمه: اللزوم لزوم مده
	ست حركات	
[همز بعد مد فى كلمة]	[همز بعد مد كل منهما بكلمة]	[سكون أصلى بعد حرف المد]
و جآء ربك و جىء بالنبيين جاءوك	لا / أعبد ما / أغنى عنه ماله □ المد العارض حين يعرض السكون لأجل الوقف	الصآخَّة
[حر كتان و نصف أو ثلاث أو أربع أو خمس أو ست]	مثل تعلمونْ . حكمه الجواز و مثله إذا عرض السكون لأجل الإدغام . □ و كذلك مد البدل حكمه الجواز كآمنوا - إيمانًا	[ست حركات بلا زيادة و لا نـقص]

3. EL-LIJNË - E BUTË

El-lijnë do të thotë lehtësi, butësi.
El-lijnë do të thotë artikulimi i shkronjës në vendin e tij me lehtësi, me butësi, pa shtrëngim dhe pa preokupim të gjuhës.

Shkronjat e Lijnit (e lehta dhe të buta) janë و dhe ي të palokalizuara (me sukun) me kusht që para tyre të jetë **fet-ha**. P.sh.:

بَيْت ، خَوْفٌ ، قُرَيْشٌ ، عَيْن ، قَوْم ، الْقَوم ، الْمَوْت ، الْحُسْنَـيَـيْن ،
كَرَّتَـيْن ، نَجْدَيْن ، زَوْجَيْن ، نَوْم ، يَوْم ، شَيْءٌ ، فَوْز ، حَيْث ، ذَالِكَ الْفَوْز ، إِلَيْهِ رَأَوْه .

Dallimi në mes zanoreve të gjata dhe Lijnit:

1. Shkronjat e Linit burojnë prej mesit të gjuhës (ي) dhe buzëve (و), ndërsa zanoret (ي و ا) prej fillimit të gojës e deri në thellësi të fytit.
2. Shkronjat e Lini aktivizohen si Lijn dhe zgjatet vetëm nëse ndalemi në atë fjalë, ndërsa nëse vazhdohet leximi nuk zgjatet. Për sa i përket zanoreve të gjata (ي و ا) ato edhe në të ndalurit e fjalës, edhe në të vazhduarit nuk e humbin rregullin (gjatësinë dhe Lijnin).
3. Shkronjat e Lijnit janë me sukun, ndërsa para kanë zanoren fet-ha e cila nuk është e përafërt , ـَوْ ، ـَىْ , ndërsa zanoret e gjatë duhet t'i kenë zanoret e përafërta اَ ، ا ، عُوا .

Dallimi në mes të shkronjave të gjata dhe shkronjave të buta është se:

Zanoret e gjata ا و ى kanë këto cilësi:

الجهر	الرهاو	الإستفال	الإنفتاح	الإسمات
Haptësuese	Çlirues	Zëultësuese	Shkëputëse	Ngulitësuese

Shkronjat e buta و ى (të Linit) kanë një cilësi më shumë:

الجهر	الرهاو	الإستفال	الإنفتاح	الإسمات	اللين
Haptësuese	Çlirues	Zëultësuese	Shkëputëse	Ngulitësuese	Butësuese

Nga skema shihet se zanoret e gjata dhe shkronjat e buta (و dhe ى) kanë të njëjtat cilësi, përpos që shkronjat e buta kanë një cilësi më tepër, e ajo është cilësia e butësisë.

4. MEDI ARID LI SUKUN

ZGJATIMI (AKSIDENCIAL) I SHKAKTUAR PREJ SUKUNIT

Esenciale në këndim të Kur'anit është të fillohet me hapje të zërit me ndonjërën prej zanoreve të shkurta, e ato janë __ـَ__ ____ __ـُ__ (El fet-hatu, ed-dametu, el-kesretu) dhe esenciale është, që përfundimi të bëhet me mbyllje të fjalës shkronja posedon zanoret e shkurta.

Të ndalurit, pra, bëhet me sukun.

Kur pas ndonjërës prej zanoreve të gjata (ي و ا) vjen sukuni jo rrënjësor (sukuni për shkak të ndaljes) bëhet zgjatje jonatyrore dhe quhet MEDI ARID. P.sh.:

سَلَّمْ ، سَلَامٌ
رَحِمْ ، رَحِيمٌ
مُؤْمِنْ ، مُؤْمِنُونَ .

Medi aridi është tri llojesh:

- Gjatë 6 vokale,
- Mesëm 4 vokale,
- Shkurt 2 vokale.

MEDI ARIDI është i lejuar, pra edhe pse lejohet të këndohet 2 vokale, më mirë është të zgjatet 4 ose 6 vokale.

- Zgjatet dy vokale për arsye se kthehet në esencën e tij, në medi tabiij, po të vazhdonte leximi.
- Zgjatet 4 vokale, pra mes i medi tabiijut dhe medi lazimit.
- Zgjatet 6 vokale për shkak të bashkimit të dy sukunëve, pra sukunit të shkronjës së fundit dhe sukunit të zanores së gjatë.

Pra, Medi Aridi lexohet:

- shkurt 2 vokale si Medi Tabii;
- lexohet 4 vokale, sepse sukuni nuk është i përhershëm, si medi lazëm, pra i ngjason Medi Tabiijut në të vazhduar dhe i ngjason Medi Lazimit në të ndalur.

Quhet Medi Arid, sepse paraqitet (lexohet) sukuni kur të bëhet të ndalurit e leximit, ndërsa humbet (nuk lexohet) sukuni, nëse leximi vazhdohet.

LLOJET E MEDI ARIDIT

Medi aridi është 6 llojesh:

1. Medi arid lisukun تَعْلَمُون
2. Elijnul arid li sukun سَوْف
3. Mutasil arid li sukun جَآء
4. El bedel arid li sukun, p.sh.: مَآب
5. Medi arid li sukun me shkronjën ة të gjinisë femërore, p.sh.: الصَّلَاة
6. Medi arid li sukun e përemrit vetor damir " ه ", p.sh.: عَقَلُوه

1. LLOJET E MEDI ARIDIT TË SUKUNIT ASNJËNËS

Me Medi Arid të Sukunit Asnjënës kemi për qëllim zgjatimin për shkak të ndaljes me sukun i cili sukun është i zhveshur prej " ٥ " të gjinisë femërore, pre " ٥ " të përemrit vetor, prej Medi Linit, Medi Aridit dhe prej Medi Mutasilit.

Medi aridi zgjatohet për shkak të ndaljes me sukun por edhe pse ndalemi me sukun fjala në fund ose mundet të jetë në:

2 Në rasën gjinorë (mexhrurë) me kesre,
3 Në rasën emëror ose (merfuë) me dame,
1 Në rasën kallëzore (mensubë) me fet-ha.

1. Kur fjala është në rasën kallëzore (mensub) – me fet-ha MEDI ARID **مُسْتَقِيمَ** ka 3 forma të zgjatimit:

1. shkurt - **مُسْتَقِيم**
2. mesëm - **مُسْتَقِيم**
3. gjatë - **مُسْتَقِيم**

2. Kur fjala është në rasën gjinore (mexhrurë) – me kerre, MEDI ARIDI ka **الرَّحِيمِ** ka 4 forma të zgjatimit:

1. shkurt - **الرَّحِيم** ,
2. mesëm - **الرَّحِيم** ,
3. gjatë - **الرَّحِيم** ,
4. shkurt me revm, pra nëse e këndojmë shkurt, atëherë kesren e këndojmë të përgjysmuar - **الرَّحِيم** .

3. Kur fjala është në rasën emrore (merfuë) – me dame MEDI ARIDI ka 7 forma zgjatimit:

1. shkurt,
2. mesëm,
3. gjatë.

} me sukun të plotë

1. shkurt,
2. mesëm
3. gjatë

} me ishmam – bashkëngjitja e buzëve pas artikulimit të sukunit

1. shkurt me revm (gjysmë zanore), pra nëse e këndojmë shkurt, atëherë e këndojmë duke e mbajtur vokalin gjysmë të shqiptuar.

REVM - KËRKESË

Në aspektin terminologjik do të thotë theksimin e zanores me zë të ulët aq sa e dëgjon i afërti e jo i largëti.

Revmi, posaçërisht, është për **kesren** dhe **damen**.

Ishmam do të thotë bashkimi i buzëve pas sukunit.

Ishmami, posaçërisht, është për **damen**, pra kur dame nuk lexohet, por ndalemi në sukun, i cili më parë ka qenë dame.

Qëllimi është për të sinjalizuar zanoren e bashkëtingëllores, po të kishte vazhduar leximi. Pra, Revmi është për dëgjim, Ishmami për shikim. Revmi sinjalizon pjesërisht zanoren. Ishmami sinjalizon vokalin e zanores po të kishte vazhduar leximi.

TË NDALURIT ME ISHMAM

Ishmam quhet bashkimi i buzëve pas shqiptimit të sukunit, por pa lëshuar zë me qëllim që ai i cili e shikon e sheh se i ka bashkuar buzut, ndërsa ai i cili nuk dëgjon nuk vëren asgjë.

Të ndalurit me Ishmam nënkupton bashkimin e buzëve pas sukunit, por pa u vonuar duke lënë një vrimë të vogël mes tyre dhe duke mos lëshuar zë, sa që e sheh shikuesi dhe nuk e dëgjon dëgjuesi.

Ishmami është 4 llojesh:

1. Ishmami siç ishte definicioni;
2. Bashkimi i buzëve paralel me bashkimin e shkronjave, si p.sh. **تَأْمَنَّا** .
   Pra bëhet bashkimi i buzëve paralel me sukunin e nunit të parë dhe para bashkëngjitjes së nunit të dytë. Ky lloj Ishmami është sikur Ishmami në fund të shkronjës, vetëm se në këtë rast bëhet në mes të fjalës.
3. Ishmami i shkronjës me shkronjë. Kjo do të thotë përzierja e fonemës me një fonemë tjetër, sikurse përzierja e fonemës së shkronjës **ص** me fonemën shkronjës **ز** (sipas kiraetit të Hamzës (**الصراط**)).
4. Ishmami i zanores me zanore, kjo do të thotë përzierja e fonemës së zanores së kesre me dame, si në rastin **قيل** (sipas kiraetit të Kesaiut dhe Hishamit).

PENGESAT E REVMIT DHE ISHMAMIT

Ekzistojnë raste kur nuk lejohet Ishmami dhe Revmi, që do të thotë se ndalja bëet vetëm me sukun të plotë, e ato janë:

1. Kur shkronja e fundit është me sukun rrënjësor, që do të thotë se edhe në të vazhduar të leximit lexohet sukuni, si p.sh.:
   فَلا تنـهرْ ، وَ رَبكَ فكبرْ ، وَ ثِيَابَكَ فَطَهِّرْ
2. Kur të jetë aridi formal. P.sh.:
   قل الدعوا ، الَّذِينَ قَالَ لهم النَّاس ، عَلَيْكُمُ الْكِتَال
   Në këto raste nuk lejohet Ishmami dhe revmi për arsye se:

- fjala **قُلْ** ka qenë me sukun të plotë,
- fjala **لَهُمْ** ka qenë me sukun të plotë,
- fjala **عَلَيْكُمْ** ka qenë me sukun të plotë,

kur është bërë takimi i dy sukunave është bërë lidhja e fjalëve dhe fjala **قُلْ** me sukun në të vazhduar e ka marrë formën **قُلِ** , fjala **لَهُمْ** me sukun, në të vazhduar e ka marrë formën **لَهُمُ** , ndërsa nëse ndalemi, kthehet në esencën e saj me sukun. Pra, edhe pse ndalemi me sukun arid (formal), sukuni është sukun i plotë rrënjësor i shkronjës.

3. Kur të jetë shkronja e fundit me fet'ha, si p.sh.:

الْمُسْتَقِيمَ ، الَّذِينَ

4. Kur të jetë shkronja e fundit e rrumbullakët e gjinisë femërore, sh:

الْمَلَئِكَة ، الْقبلة ، لَعِبْرَة ، لمرة

Kur lejohet ndalja edhe me sukun të plotë edhe me revm?

Lejohet ndalja me sukun të plotë dhe me revm kur shkronja e fundit e fjalës është me kesretu: **الرَّحِيمِ**

Lejohet ndalja me sukun të plotë, me Ishmam dhe me revm kur shkronja e fundit e fjalës është me dame:

نَسْتَعِينُ ، يَا نُوحُ ، يَا صَالِحُ

2. MEDI LIJN ARID LI SUKUN
ZGJATJA E BUTË

Nëse gjatë leximit bëhet ndalja, ndërsa para shkronjës së fundit ndodhet shkronja e lehtë (ي) dhe (و) , atëherë bëhet zgjatje e butë dhe quhet MEDI LIJN.

Pra, atëherë kur takohen dy sukuna, sukuni i shkronjës (ي) ose (و) dhe sukuni për shkak të ndaljes:

بَيْت ، الْيَوْم ، خَوْف

Nëse vazhdohet leximi dhe nuk bëhet ndalja, atëherë nuk bëhet zgjatje, por lexohet vetëm si sukun.

Ky zgjatim i butë mund të bëhet në tri mënyra:

- Gjatë, pra 6 vokale,
- Mesëm, 4 vokale,
- Shkurt, 2 vokale.

Zgjatimi dy vokale është më i preferuari.

Te medi lijni zgjatja bëhet në vetë shkronjën.

Quhet Lijn për arsye se nëse i paraqitet zanores së gjatë sukuni në vazhdim zgjatet, ndërsa nëse i humbet sukuni në vazhdim shkurtohet.

- Nëse para sukunit arid fjala ka qenë me **fet-ha**, atëherë medi lijni këndohet shkurt, mesëm dhe gjatë:

الْيَوْمَ

- Nëse para sukunit arid fjala ka qenë me **kesre**, atëherë medi lijni këndohet shkurt, mesëm, gjatë dhe revm:

زَوْجَيْن ، شَيْءٍ

- Revmi bëhet vetëm nëse këndohet shkurt.

- Nëse para sukunit arid fjala ka qenë me **dame**, atëherë medi lijni këndohet shkurt, mesëm dhe gjatë:

shkurt, mesëm, gjatë me **ishmam**,

shkurt me **revm**

حَيْثُ ، ذَالِكَ الْفَوْزُ

Zgjatimet kanë emërtime të ndryshme, mirëpo që të gjithë janë degëzime të gjatimit natyror (ESLIJ) dhe jonatyror (FERIJ):

MEDI AVED (I KOMPENSIMIT)

Ky zgjatim bëhet vetëm në të ndalur, ndërsa nëse vazhdohet leximi nuk bëhet zgjatim fare, por këndohet shkurt (Kasr). Ky zgjatim ndodh për shkak të tendinit, sepse kur të ndalet leximi nuk lexohet tendini fare, e për ta kompensuar ia bashkëngjisim sukuni zanores së gjatë dhe e këndojmë dy vokale:

عَلِيمًا ،
حَكِيمًا
رحيما

FORMA TJERA TË ZGJATIMIVE
MEDI SILE (ZGJATIMI PËR SHKAK TË NGJITJES SË FJALËS – PËREMRIT VETOR)

Është zgjatim i cili vetëm paramendohet se është aty zanorja e gjatë "**و**" ose zanore e gjatë "**ى**" kur të jetë përemri vetor i vetës së tretë njëjës.

- Zgjatet dy vokale. P.sh.:

إِنَّهُ بِعِبَادِهِ خَبِيرٌ بَصِيرٌ .
قَالَ لَهُ صَاحِبُهُ وَ هُوَ يُحَاوِرُهُ .
بِيَدِه - بِيَدِهِ مَلَكُوت
وَمَنْ يَأْتِه - وَمَنْ يَأْتِهِ مُؤْمِنًا

نُؤْتِه - نُؤْتِهِ مِنْهَا
لِقَوْمِه - لِقَوْمِهِ يَا قَوْمِه
هذِه - هذِهِ نَاقَتُ اللهِ
لَه - لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَ الْأَرْضِ
وَ إِنَّه - وَ إِنَّهُ هُوَ
قَالَ لَه - قَالَ لَهُ صَاحِبُهُ

MEDI SILE ndahet në:

- Medi sile sugra
- Medi sile kubra.

SILE SUGRA

- Sile Sugra është atëherë kur pas përemrit vetor " **ه** – h " nuk ka hemze. P.sh.:

وَ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ
فَتَهَجَّدْ بِهِ نَافِلَةً

- Nëse para përemrit vetor "**ه**" është zanorja e gjatë apo sukuni, nuk zgjatet dy vokale, por këndohet shkurt. P.sh.:

خَلَقْنَهُ ، جَعَلْنَاهُ ، فِيهِ

- Përjashtimi në këtë rregull bëhet në suretul Frkan: **فِيهِۦ مُهَانًا**

- Nëse bëhet lidhja e fjalëve, atëherë "**ه**" nuk zgjatet, por këndohet shkurt. P.sh.:

إِنَّهُ الْحَقُّ ، وَ لَهُ الدِّينُ

- Është me sukun **فَا لْقِه ، ارجه**

Nëse nuk është përemër vetor "**ه**" nuk zgjatet:

يرضه

Nuk zgjatet edhe te fjalët: **ارجه** dhe **أَلْقِه** .

SILE KUBRA – ZGJATIMI I MADH

Nëse shkronja " **ه** – h " në rolin e përemrit vetor ka zanore para saj dhe pas saj vjen hemzeja, atëherë kalon prej zgjatimit të dy vokaleve në

zgjatim katër vokalesh dhe pesë vokalesh, por lejohet të këndohet edhe dy vokale, pra këndohet si medi munfasil. P.sh.:

مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا ، غَيْرُهُ إِنْ

Medi sile, pra zgjatimi bëhet vetëm me rastin e vazhdimit të leximit, ndërsa me rastin e ndaljes nuk këndohet gjatë dy vokale, por bëhet ndalja me sukun. P.sh.:

مِنْ عِلْمِهْ ، غَيْرُهْ ، إِنَّهْ ، لَا مبدل لكلماتِهِ وَ لن تجد مِن دُونِهِ مُلْتَحَدًا .

إِنَّهُ, بِعِبَادِهِ خَبِيرٌ بَصِيرٌ . قَالَ لَهُ, صَاحِبُهُ, .

Vërejtje:

Në disa mus'hafa çdo "**ه**" përemri vetor me dame i vendoset "**و** " i vogël, me kesre i vendoset "**ى** " e vogël: **لَهُ, بِهِ**

- **MEDI FERK** (zgjatimi i dallimit)

Ferk do të thotë dallim, për të dalluar formën lajmërues me formën pyetëse, atëherë e zgjasim aq shumë (6 vokale) edhe pse është hemzetul vesli (i cili hemze bën lidhjen, e gjatë lidhjes kërkon shkurtimin, pra jo zgjatimin në këto raste, obligohet që sa më shumë të zgjatet:

ءَآ الذَّكَرَيْن ، ءَآ الله ، ءَا لْآنَ

- **MEDI TEMKINË – ZGJATIMI I SHKOQITJES**

Kur dy "**و** " (va, va) ose dy "**ى** " (jaun, jaun) pranë njëra-tjetrës për të mos i bashkëngjitur, atëherë e zgjasim për t'i dalluar.

- **MEDI TEADHIME – ZGJATIMI I MADHËRIMIT**

Ndryshe quhet zgjatim i hiperbolizimit, pra kur të jetë fjala **اللهُ** , pra shkronja "**ل** " edhe pse ka zanore të shkurt "fet-hatun", e këndojmë gjatë të zgjaturit e tepërt mund ta bëjnë vetëm profesionalistët.

Në esencë fet-hatun këndohet shkurt, mirëpo të fjala e Allahut, edhe pse është fet-hatu nuk e këndojmë shkurt, por e këndojmë gjatë për të demonstruar zëshëm madhështinë e Zotit.

MEDI ARID I LIJNIT

Kur para shkronjës së fundit në të cilën ndalemi me sukun ndodh shkronja "و " dhe "ى " (shkronjat të Lijnit) bëhet zgjatimi jo natyror i Lijnit që quhet MEDI ARIDI I LIJNIT:

الْيَوْم ، نَوْم ، شَيْئٍ ، فَوْز

Zgjatet: 2 vokale,
4 vokale,
6 vokale.

Revmi si vazhdimi

Nëse te shkronjat e Lijnit këndohet dy vokale, atëherë te zgjatimet tjera (Medi MUNFASIL) zgjatet 2 vokale, 4 vokale, 6 vokale.
Medi MUTASIL zgjatet 4 vokale, 6 vokale.

Nëse Medi Lijni zgjatet 6 vokale, atëherë Medi Munfasili, Medi Mutasili, Medi Aridi zgjaten 6 vokale, e nuk lejohet të zgjaten më pak, sepse zgjatimet janë më të forta se Medi Lijni, prandaj zgjatimi më i dobët nuk zgjatet më shumë se zgjatimi më i fortë.

Nëse ndodh që lexuesi te Medi Munfasili zgjatet 2 vokale, nuk lejohet që Medi Lijni të zgjatet më shumë se dy vokale. Nëse te Medi Munfasili dhe Medi Mutasili e zgjatë 4 vokale, atëherë Medi Lijni nuk mund të zgjatet më shumë se 4 vokale.

Nëse te Medi Munfasili, Medi Mutasili dhe Medi lazmi e zgjatë 6 vokale, atëherë te Medi Lijni mund të ndalet dhe ta zgjatë 6 vokale; 4 vokale dhe 2 vokale.

NDALJA KUR SHKRONJA E FUNDIT E KA SUKUNIN RRËNJËSOR

Sukuni rrënjësore ose sukuni në shkronjës zbutësuese është sukuni i cili vjen në shkronjën e cila është në fund të fjalës, por pa shkronjë zgjatësuese para saj, lexohet sukuni si në të ndalur të leximit si në të vazhduar:

إِقْرَأْ ، خَلَوْ ، كَمْ ، أَلَمْ ، عَلَيْكُمْ

Në të gjitha këto raste lexohet vetëm me sukun të plotë dhe nuk lejohet as Ishmami as Revmi.

ARIDI ASNJANËS (MUTLAK)

Aridi Mutlak (sukuni akcidencial asnjanës) quhet atëherë kur paraqitet sukuni arid (pazanoshmëria e akcidencialit) pa zanore të gjatë, pa shkronjë zbutëse, pa " **ة** " të gjinisë femërore, dhe pa " **ه** " të përemrit vetor.

ذَالِكَ ، كَوْثَرْ ، أَحَدٌ ، تَوَكَّلْتُ

- Aridi asnjanës kur para sukunit fjala ka qenë me fet'ha si p.sh.: **ذَالِكَ كَوْثَرَ .** – Lexohet vetëm me sukun të plotë, pasi që shkronja e fundit është fet'ha dhe nuk lejohet Revmi dhe Ishmami.
- Aridi asnjanës kur para sukunit fjala ka qenë me kesrse si p.sh.: **وَ الْفَجْرِ ، أَنَّى لَكِ** lexohet me sukun të plotë dhe Revm.
- Aridi asnjanës kur para sukunit fjala ka qenë me dame si p.sh.: **أَحَدٌ ، تَوَكَّلْتُ** lexohet me sukun të plotë, me Ishmam dhe me Revm.

5. SUKUNI ARID ME “ ة - T” TË GJINISË FEMËRORE PA PASUR PARA SAJ ZANORE TË GJATË

Në Kur’an ndodhë që të ndalemi me sukun në fjalën kur ajo fjalë përfundon me **“ ة - T”** e gjinisë femërore, por para saj nuk ka zanore të gjatë, si p.sh.: فِتْنَةَ ، رَحْمَةٍ ، وِجْهَةٌ në të gjitha këto raste ndalja bëhet vetëm me sukun të plotë. Pasi që **“ ة - T”** e gjinisë femërore shndërrohet në **“ ه - H”.**

- Nëse është **“ ت - T”** e shtrirë e gjinisë femërore, atëherë përpos me sukun të plotë lejohet të lexohet me Ishmam dhe me Revm. P.sh.: وَ رَحْمَتُ lexohet me sukun të plotë me Ishmam dhe me Revm. Ndërsa kur të jetë me kesre, si p.sh. ذِكْرُ رِحْمَتِ lexohet me sukun të plotë dhe me Revm.

“ ه - H” E PËREMRIT VETOR

Dallimi në mes të përemrit vetor **“ ه - H”** dhe **“ ه - H”** të gjinisë femërore është:

1. E para **“ ه - H”** e përemrit vetor lexohet si në të vazhduar si në të ndalur, ndërsa **“ ة ”** e gjinisë femërore lexohet **“ ة ”** në të vazhduar, kurse **“ ه ”** në të ndalur të leximit.

2. E para **“ ه - H”** e përemrit vetor është emër, e dyta **“ ة ”** e gjinisë femërore është pjesëz shtesë.

3. E para **“ ه - H”** e përemrit vetor është e palakuar, e dyta **“ ة ”** e gjinisë femërore është e lakuar.

4. E para **“ ه - H”** e përemrit vetor tregon vetëm gjininë mashkullore, e dyta **“ ة ”** tregon vetëm gjininë femërore.

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme rreth asaj se si të bëhet ndalja te përemri vetor **“ ه - H”:**

Mendimi i parë: këndohet shkurt, mesëm dhe gjatë, por vetëm me sukun të plotë dhe nuk bëhet Ishmami dhe remi.

Mendimi i dytë: Nëse damiri **“ ه - H”** është me kesra këndohet shkurt, mesëm, gjatë me sukun të plotë dhe revm nëse këndohet shkurt.

Nëse damiri **“ ه - H”** është me dame, atëherë këndohet në 7 forma: shkurt, mesëm, gjatë me sukun të plotë; shkurt mesëm gjatë me Ishmam; dhe shkurt me revm. Pra, damir e pranon remin dhe Ishmamin.

Mendimi i tretë: Nëse para damirit është shkronja **“ ي - J”** e gjatë ose dame, atëherë këndohet shkurt, mesëm dhe gjatë me sukun të plotë dhe nuk e pranon Ishmamin dhe Revmin, si p.sh.:

فيه

إِلَيْه

راوه

Nëse para damirit është elifi zgjatues, atëherë lejohet në 7 mënyra:

1. Shkurt me sukun të plotë;
2. Mesëm **اجتباهُ** ;
3. Gjatë;
4. Shkurt me Ishmam;
5. Mesëm me Ishmam;
6. Gjatë me Ishmam;
7. Shkurt me Revm.

رَآهُ

Mendimi i tretë është më i pëlqyeshmi.

3. MEDI MUTASILI ARID I SUKUNIT (ZGJATIMI NDËRFJALOR I SUKUNIT AKSIDENCIAL)

Gjithmonë gjatë leximit në fund të fjalës ndalemi me sukun.

Të ndalurit me sukun shkakton medi aridin, pasi që para shkronjës me sukun ndodhen njëra prej zanoreve të gjata ا و ose ي .

Kur kemi sqaruar se medi mutasilin e shkakton " ء ", atëherë në të njëjtën kohë na paraqiten dy rregulla të cilat i formulojmë në një rregull, e ajo është MEDI MUTASILI ARID I SUKUNIT.

DEFINICIONI:

Kur sukuni arid është në shkronjën hemze " ء " dhe shkronja e para fundit është ndonjëra prej zanoreve të gjata (ا و ose ي), atëherë bëhet MEDI MUTASIL ARID I SUKUNIT.

- Zgjatet 4, 5 dhe 6 vokale

سَمَآء
يَشَآء
جَآء
قُرُوءْ
تَبُوء
سَوَآءٌ
سُوؤُ

Kur medi mutasilit i ndërhyn Medi Arid li sukuni, atëherë në zgjatimin e saj paraqiten këto mënyra të leximit:

1. Kur të jetë me fet'ha, si p.sh.: **وَ السَّمَآءَ بنيناها**

zgjatet në tri mënyra:

- me sukun të plotë 4 vokale;
- me sukun të plotë 5 vokale;
- me sukun të plotë 6 vokale;

Këtu kemi tri mënyrat e zgjatimit, por pa Revm dhe Ishmam.

2. Kur të jetë me kesre, si p.sh.: **وَ السَّمَآءِ وَ مَا بَنَاهَا**

zgjatet në 5 mënyra:

- me sukun të plotë 4 vokale;
- me sukun të plotë 5 vokale;
- me sukun të plotë 6 vokale;
- me revm 4 vokale;
- me revm 5 vokale;

Këtu kemi tri mënyrat e zgjatimit dhe plus dy tjerat me revm.

3. Kur të jetë me dame, si p.sh.: يَشَآءُ

zgjatet në 8 mënyra:

- me sukun të plotë 4 vokale;
- me sukun të plotë 5 vokale;
- me sukun të plotë 6 vokale;
- me Ishmam 4 vokale;
- me Ishmam 5 vokale;
- me Ishmam 6 vokale;
- me Revm 4 vokale;
- me Revm 5 vokale.

Këtu kemi tri mënyrat e zgjatimit dhe plus 5 mënyrat tjera me revm dhe Ishmam për shkak të takimit të dy shkaqeve, pra edhe shkakut sukun, por edhe shkakut hemze.

KUR LEJOHET SUKUNI I PLOTË DHE ISHMAMI

Kur shkronja e fundit është me el-kesretu (ـِـ), atëherë lejohet me sukun të plotë dhe revm, ndërsa nuk lejohet me ishmام P.sh.:

الرَّحِيم ، هَؤُلَآءِ

KUR LEJOHET SUKUNI I PLOTË REVM DHE ISHMAMI

Kur shkronja e fundit është me ed-dametu (__ُـ__) , atëherë lejohet me sukun të plotë, me revm dhe me ishmam. P.sh.:

نَسْتَعِين ، يَا نُوحُ
يَا صَالِحُ

TË NDALURIT ME ISHMAM

ISHMAM dot të thotë të bashkuarit e buzëve pas shqiptimit të sukunit, por pa u vonuar, dhe në të njëjtën kohë me lënë një vrimë të vogël mes tyre.

ISHMAMI bëhet kur shkronja e fundit është me kerre ose me dame, ndërsa nuk bëhet kur shkronja e fundit është me fet-ha.

Ishmami është 4 llojesh:

1. Bashkimi i buzëve siç u lartpërmend.
2. Bashkimi i buzëve në mes të fjalës me rastin e ajetit Kur'anor: **تَأْمَنَّا**,

pra bëhet bashkimi i buzëve në sukunin e nunit të parë dhe para bashkëngjitjes me nunin tjetër.

3. Ishmami i shkronjës me shkronjën tjetër.
4. Ishmami i zanores me zanore tjetër.

QËLLIMI I ISHMAMIT DHE REVMIT - GJYSMËZANORE

Qëllimi i remvit është për t'i sinjalizuar dëgjuesit zanoret të cilat i ka fjala nëse ndalet leximi, sepse nëse vazhdohet leximi dëgjuesi e kupton zanoren.
Ndërsa, me rastin e ishmamit, qëllimi është për t'i treguar shikuesit se, cila zanore është po të kishte vazhduar leximi.

KUR NUK LEJOHET ISHMAMI DHE REVMI

Ekzistojnë rastet kur nuk lejohet ishmami dhe remi, e ato janë:

1. Kur shkronja e fundit e ka sukunin rrënjësor. P.sh.:

فَلَا تَنْـهَرْ
وَ رَبَّكَ فَكَبِّر
وَثِيَابَكَ فَطَهِّر

Për arsye se ishmami dhe remi janë për të treguar zanoret, e jo për sukunin.

2. Pasi që zanorja fet-hatun (_َ_) është zanore që nëse pak shqiptohet, shqiptohet e tëra, pra nuk mundet që të dal vetëm një e treta e shqiptimit, atëherë nuk lejohet që të bëhet ishmami dhe remi kur fjala e fundit ka pas fet-hatun ose ka qenë në rasën kallëzore. Pra, në ato raste këndohet me sukn të plotë. P.sh.:

الْمُسْتَقِيم ، الَّذِينَ

- Kusht është që rasa kallëzore të mos jetë me tenvin.

3. Kur fjala e fundit është me shkronjën "ة" të gjinisë femërore, e në rast të ndaljes shndërrohet në "ه – H". P.sh.:

الْمَلَآئِكَة ، الْقِبْلَة ، لَعِبْرَة ، مَرَّةَ
هُمَزَةٍ لُمَزَةٍ

Pra, pasi që "ة" ka humbur dhe është zëvendësuar me "ه – H", nuk ka çka të sinjalizohet apo të tregohet me ishmam ose me revm.
Ndryshe nga shkronja "ة – T" e gjinisë femërore kur shkronja e fundit është shkronja "ت" jo e gjinisë femërore, atëherë bëhet ishmami dhe revmi. P.sh.:

كَلِمَتُ ، سُنَّتُ ، تَابُوتُ

4. Aridu Shekli – formal:

انذِرِ النَّاسِ يَوْمَئِذٍ

MEDI MUTASIL ARID I SUKUNIT NË RASËN KALLËZORE

1. Zgjatet 4 vokale, sepse është MEDI MUTASIL dhe ARID.
2. Zgjatet 5 vokale, sepse është MEDI MUTASIL dhe
3. Zgjatet 6 vokale, sepse kalon në rolin e sukunit rrënjësor (LAZIM), pra hemzeja përforcohet me sukunin dhe bëhen shkaktarë të dyfishtë.

MEDI MUTASIL ARID I SUKUNIT NË RASËN GJINORE

1. Zgjatet 4. 5 dhe 6 vokale me sukun të plotë;
2. Zgjatet 4 dhe 5 vokale me revm:

نِسَآءِ ، أولآءِ

MEDI MUTASIL ARID I SUKUNIT NË RASËN EMËRORE

يَشَآء ، سَمَآء

1. Zgjatet 4, 5 dhe 6 vokale me sukun të plotë;
2. Zgjatet 4, 5 dhe 6 vokale me ishmam;
3. Zgjatet 4 dhe 5 vokale me reum.

4. EL-BEDEL ARID I SUKUNIT – (ZËVENDËSUESI AKSIDENCIAL I SUKUNIT)

Kur para sukunit arid ndodhohet njëra prej zanoreve të gjata dhe këtu janë zgjatime të hemzes, atëherë bëhet zgjatimi jo natyror që quhet EL BEDEL ARID I SUKUNIT. Shembull:

مُسْتَهْزِءُون
خَاطِئِين ، مُسْتَهْزِءِين
مَنَآب

Zgjatet 2, 4 dhe 6 vokale.

5. MEDI ARIDI I SUKUNIT TE " ھ – h " e gjinisë femërore

Shkronja "**ۃ** " e rrumbullakët nuk lexohet nëse në të bëhet ndalja apo pushimi i leximit. Si p.sh.:

التَّوْرَاة ـ التَّوْرَاه ، التَّوْرَاة ـ التَّوْرَاه ، كَمِشْكَاة ـ كَمِشْكَاه

Zgjatet shkurt mesëm dhe gjatë me sukun të plotë dhe nuk lejohet reumi apo ishmami për arsye se po të kishte vazhduar leximi nuk do të ishte lexuar " ھ ", por " ۃ ". Ky është shkaku pse nuk lexohet me revm ose me ishmam.

6. MEDI ARIDI I SUKUNIT TË " ہ – H " SË PËREMRIT

Kur pas ndonjërës prej zanoreve të gjata është përemri “ هُ – hu ”, mirëpo për shkak të ndaljes bëhet “ هْ – h ” me sukun (e pavokaliuar). P.sh.:

حَرِّقُوهُ ، رَاَوْهُ ، عَقَلُوهُ ، رَآهُ
فِيه ، عَلَيْه ،
عَلَّمْنَاه ، إِجْتَبَاه ، هَدَاه

Kurr nuk bëhet revm dhe ishmam nëse ndalemi në shkronjën “هـ – h” të përemrit.

Dallimi mes “هـ ” përemrit vetor dhe “ هـ ”gjinisë femërore:

E para: “هـ ” lexohet edhe në të vazhduar, edhe në të ndalur, ndërsa “ هـ ”e gjinisë femërore nuk lexohet nëse vazhdohet leximi.

E dyta: “ هـ ” damire vjen gjithmonë për gjininë mashkullore, ndërsa “ هـ ” e gjinisë femërore vjen gjithmonë për gjininë femërore.

1. FORMA TJERA TË ZGJATIMIVE MEDI SILE

Është zgjatim i cili vetëm paramendohet se është aty zanorja e gjatë “و” ose zanore e gjatë “ى” kur të jetë përemri vetor i vetës së tretë njëjës.

- Zgjatet dy vokale.

MEDI ARIDI është tri llojesh:

Gjatë - 6 vokale sikurse Medi Lazim, sepse bashkohen dy sukuna: sukuni i zanoreve të gjata dhe sukuni për shkak të ndalimit dhe për shkak se sukuni i ndalimit i gjason sukunit rrënjësor që zgjatet 6 vokale.

Mesëm - 4 vokale, sepse bashkohen dy sukuna: sukuni i zanoreve të gjata dhe sukuni për shkak të ndalimit, për shkak se ky sukun është degëzor, i rastit, pra jo rrënjësor, mund të zgjatet më pak se 6 vokale, pra 4 vokale.

Shkurt - 2 vokale, për arsye se kthehet në esencën (bazën) e tij – zgjatje natyrore po të vazhdonte leximi. Pra, nuk shikohet në sukun të ndalimit, por në ndalje pa shikuar a ka sukun apo jo.
SHEMBUJ TË MEDI ARIDIT:

الْعَالَمِينَ ،
الرَّحِيمِ ،
نَسْتَعِينُ ،

5. ZGJATIMI I DEGËZUAR (DYTËSOR)
MEDI LAZIM – ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM

Kur pas ndonjërës prej zanoreve të gjata vjen sukuni rrënjësor (ـْـ) bëhet zgjatje (togimi i zanoreve të njëjta) jonatyrore e domosdoshme, pa marrë parasysh se a ndalemi në lexim apo jo, dhe quhet MEDI LAZIM. P.sh.:

ص ، ق ، ن كاف ، ميم ، عين ، سين ، لام ، نون ، قاف ،
صاد طسم حم ن ص حا يا طا ها را
الم

- Zgjatet 6 vokale gjithmonë përpos në suretu Merjem zgjatja e shkronjës (عـ - ajn) dhe suretu Shura ku mund të zgjatet 6 vokale, por mund të shkurtohet në dy vokale.
- MEDI LAZËM është zgjatje e domosdoshme (VAXHIB) dhe haram është nëse shkurtohet.

- Quhet LAZËM për arsye se, u ndalëm apo e vazhduam leximin, patjetër duhet të zgjatet 6 vokale.

Shkaku:
Takimi i dy sukunave, pra zanorja e gjatë e pa vokalizuar në esencë quhet zanore me sukun dhe shkronja tjetër me sukun poashtu e pavokalizuar kështu që vendin e dy sukunave e zen gjatimi i zërit.

Medi Lazëm është dy llojesh:
- i fjalëve dhe
- i shkronjave.

Pastaj Medi Lazëm i fjalëve ndahet në:
- Medi Lazëm i fjalëve të lehta dhe
- Medi Lazëm i fjalëve të rënda.

Medi Lazëm i shkronjave ndahet në:
- Medi Lazëm i shkronjave të lehta dhe
- Medi Lazëm i shkronjave të rënda.

MEDI LAZËM (ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM) I FJALËVE

Nëse pas zanoreve të gjata (ا و dhe ى) pason skuni rrënjësor brenda fjalës quhet Medi Lazëm i fjalës. P.sh.: **الْحَآقَّة**

Medi Lazëm i fjalës është dy llojesh:
1. MEDI LAZËM I FJALËVE TË RËNDA dhe
2. MEDI LAZËM I FJALËVE TË LEHTA.

1. MEDI LAZËM (ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM) I FJALËVE TË RËNDA

Quhet Medi Lazëm i fjalëve të rënda sepse pas zanoreve të gjata (ا ، و dhe ى) pason teshtidi. P.sh.:

فَمَنْ حَآجُّكَ ، تُحَآجُّونِى ،
تَأْمُرونِّى ، دَآبَّةٌ

الطَّآمَّةُ ،	الْحَآقَّةُ
وَ الصَّآفَّآتِ ،	صَوَآفُّ
وَ حَآجَّهُ ،	الصَّآخَّه
وَ لَا الضَّآلِّينَ ،	ءَآ الذَّكَرَيْنِ

Zgjatet 6 vokale – për këtë janë pajtuar të gjithë.

Fjala **صوآفّ :**

- Nëse ndalemi në këtë fjalë dhe nuk e vazhdojmë leximin, atëherë shndërrohet si me sukun **صوآفْ**
- Sukun i plotë dhe revm: **مضآرّ**
- Sukun i plotë, revm dhe ishmam: **جآنٌّ**

2. MEDI LAZËM (ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM) I FJALËVE TË LEHTA

Nëse pas zanoreve të gjata (ا و dhe ى) pason sukuni rrënjësor jo me teshtid bëhet medi lazëm i fjalëve të lehta. Kjo ndodh vetëm dy herë në Kur'an: në suretu Junus ajeti 51 dhe 91 - **ءَآلْآنَ**

Quhet Medi Lazëm i fjalëve të lehta për arsye se në fjalë nuk ka teshtid dhe as bashkëngjitje - idgam.

ءَآ الْآنَ فَقَدْ كُنْتُ
ءَآ الْآنَ فَقَدْ عَصَيْتَ

MEDI LAZIM HARFIJ
ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM I SHKRONJAVE

Bëhet atëherë kur pas shkronjës alfabetike ndodhet harfimed zanorja e gjatë e cila bashkëngjitet me shkronjën e njëjtë. P.sh.:

الم
طسم

Medi Lazëm i shkronjave është dy llojesh:

1. Medi Lazim i shkronjave të lehta;
2. Medi Lazim i shkronjave të rënda.

MEDI LAZIM HARFIJ MUHAFEF – ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM SHKRONJORE E LEHTË

ياس ، ق

Quhet i shkronjës së lehtë, sepse kur të shqiptohet shkronja në të shqiptuar paraqitet zanorja e gjatë e cila kur të përfundon shqiptimi ndodhet sukuni rrënjësor e jo teshtidi apo idgami. P.sh.:

طسم حم ن ص

Medi Lazim i shkronjave gjithmonë vjen në fillim të sureve, asnjëherë në mes apo në fund të sureve dhe janë të përmbledhura në fjalën

كم عسل نقص :

كاف ، ميم ، عين ، سين ، لام ، نون ، قاف ، صاد .

كم عسل نقص

Këto 8 shkronja në Kur'an vijnë në 44 raste:

- Shkronja " **ك** " vjen vetëm 1 herë, në suretu Merjem.
- Shkronja " **م** " vjen vetëm 17 herë: në fillim të suretul-Bekare, Ali Imran, El-Earafë, Junus, Hud, Jusuf, Err-Rraëd, Ibrahimë, El-Hixhr, El-Ankebutë, Err-Rrumë, Lukman dhe Es-Sexhde.
- Shkronja " **ع** " vjen vetëm 2 herë: Në fillim të suretu Merjem dhe Esh-Shura.
- Shkronja " **س** " vjen vetëm 5 herë: Në fillim të sures Esh-Shuaraë,

El-Kasas, En-Neml, Jasinë dhe Esh-Shura.

- Shkronja “ **ل** ” vjen vetëm 13 herë: Në fillim të suretul Bekare, Ali Imran, Earafë, Junus, Hud, Jusuf, Err-Rraëd, Ibrahimë, El-Hixhr, El-Ankebutë, Err-Rrumë, Lukman dhe Es-Sexhde.
- Shkronja “ **ن** ” vjen vetëm 1 herë, në suretu Nunë.
- Shkronja “ **ق** ” vjen vetëm 2 herë: në suretu Esh-Shura dhe suretu Kaf.
- Shkronja “ **ص** ” vjen vetëm 3 herë: në fillim të suretul-Earafë, Merjem dhe Sadë.

Gjithsejtë **44** herë.

Medi Lazim Harfij Muthekal vjen në 10 raste;
Medi Lazim Harfij Shebhe Muthekal vjen në 4 raste.

Të gjitha këto shkronja zgjaten 6 vokale, përpos **عين** në dy raste mund të zgjatet mesëm, pra 4 vokale.

Shkronjat tjera zgjaten dy vokale përpos ا – elifit, i cili përbëhet prej tri bashkëtingëlloreve ا، ل dhe **ف** , mirëpo shkronja e mesme nuk është prej zanoreve të gjata.

Në fillim të sureve janë 5 shkronja të alfabetit të cilat zgjaten me zgjatje natyroer (Medi Tabiij) e ato janë:

حا يا طا ها را .

Pra mund të përfundojmë se shkronjat e alfabetit arab në fillim të sureve munden të jenë:

- Shkronjat të cilat nuk zgjaten fare **الف** – “ ا ”
- Shkronja të cilat zgjaten 2 vokale **حي طاهر**
- Skronja të cilat zgjaten ose 4, ose 6 vokale **عين** – “ع”
- Shkronja të cilat zgjaten 6 vokale **كم عسل نقص**

2. MEDI LAZËM HARFIJ MUTHEKAL - ZGJATIMI I DOMOSDOSHËM SHKRONJORE E RËNDË

Quhet zgajtim i shkronjës së rëndë, sepse kur të shqiptohet shkronja nëtë shiptuar paraqitet zanorja e gjatë e cila kur të përfundojë përfundon shqiptimi ndodhet teshtidi apo idgami, e jo sukuni rrënjësor. P.sh. Lami në **الم الر** zgjatet 6 tone.

MEDI LAZIM
SHEBHE BILMUTHEKAL

I ngjashëm me të rëndën vjen vetëm në 4 vende në Kur'an:

- Shkronja " **ع** " në suretu Merjem dhe Esh-Shura: **كهيعص**
- Shkronja "**س**" në suretun-Neml **طس** dhe Esh-Shura: **طسم ﴿ تِلْكَ**

Është i ngjashëm me të rëndat, sepse paraqitet një lloj vështirësie në shqiptim të shkronjës dhe në zgjatim të saj, pra duhet të bëhet "Ihfaja" e nunit pas një zgjatimi të gjatë.

Në shumicën e librave të texhvidit këtë e konsiderojnë prej "Medi Lazim Harfij Muhafef", sepse Medi Harfij Muthekal e konsiderojnë vetëm atëherë kur pas zgjatimit të shkronjës bëhet Idgami (bashkëngjitja) me shkronjën tjetër, mirëpo këtu nuk ka bashkëngjitje, por ne e konsiderojmë të arsyeshme për të treguar në këtë rast se "Ihfaja" i gjason Idgamit.

الم ﴿ الله
ن ﴿ وَ الْقَلَمِ

يس ﴿ وَ الْقُرْآنِ الْحَكِيم ﴾

Në surete Ali Imran është mirë që të përfundohet leximi në ajetin **الم** , e pastaj të fillohet **الله** , me qëllim që të mos formohet zanore e gjatë e Elifit te fjala Allah.

Në suretu **يس** – Ja sin dhe **ن** – Nun, nëse ndërlidhen ajetet më e vlefshme është që të lexohet "Nuni" në fund të ajetit, por mundet edhe të bëhet bashkëngjitja e tyre me vavin e ajetit tjetër.

SHKAQET E ZGJATIMIT DYTËSOR

Janë dy shkaqe të zgjatimit dytësor:

1. Shkaku fjalor;
2. Shkaku kuptimor.

1. SHKAKU FJALOR është atëherë kur pas zanores së gjatë vjen hemzeja ose sukuni, sepse këto dy shkaqe janë shkaqe të zgjatimit jonatyror prej atij natyror.

2. SHKAKU KUPTIMOR është atëherë kur lexuesi ka për qëllim hiperbolizimin e mohimit ose vërtetësisë. P.sh.:

لا إِلَـٰهَ إلا الله
لا إِلَـٰهَ إلا أَنتَ سُبْحَـٰنَكَ إِنِّى كُنتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

Nuk lejohet zgjatimi i hiperbolizimit për çdo lexues, por këtë e bëjnë vetëm ata të cilët kanë njohuri të thellë në mënyrat e kiraeteve, sepse mund të ndodhë përzierja e mënyrave (turuk), e kjo është haram, ose mekruh.

Zgjatimi dytësor ka tri rregulla:
Vaxhib është posaçërisht për Medi Mutasilin;
I lejuar është për Medi munfasilin, bedelin, sukunin arid;
Lazim është posaçërisht për Medi lazimin.

SUKUNI ARID – SUKUNI AKSIDENCIAL PA ZGJATIM

Sukuni arid min gajri medi mutlak quhet sukuni arid pa vokale të gjata, pa " هـ – H", e gjinisë femërore, pa " هـ – H", e përemrit vetor dhe pa shkronjë të Lijnit (ا , ى).

- Rregulli: Nëse para të lexuarit me sukun ka qenë me fetha, këndohet vetëm me sukun të plotë:

الْكثرَ – الْكثرْ
ذَالِكَ – ذَالِكْ

- Nëse para të lexuarit me sukun ka qnë me ketra, këndohet me sukun të plotë,por edhe me revm:

وَ الْفَجْرِ – وَ الْفَجْرْ – وَ الْفَجْرْ ِ
أَنَا لَكِ - أَنَا لَكْ - أَنَا لَكْ ِ

- Nëse para të lexuarit me sukun ka qenë me dametu, këndohet me sukun të plotë, me revm, me ishmam:

1. Me sukun të plotë **أَحَدْ** – أَحَدٌ eha**d** – vetëm sukun i plotë.
2. Me revm - **إِحْدْ** – إِحْدٌ eha**d u** – gjysmëzanorja u quhet revm
3. Me ishmam - **أَحَدْ** – أَحَدٌ eha**d** sukuni i plotë + mbyllja e buzëve e menjëhershme quhet ishmam.

SHKRONJA “ ة ” ME SHTRATIN E RRUMBULLAKËT LEXOHET “ ه – H ”, E CILA TREGON GJININË FEMËRORE DHE RREGULLAT E SAJ

Fjalët e Kur’anit të cilat përfundojnë me “ ة ” e gjinisë femërore janë tri llojesh:

Lloji i parë: “ ة ” e gjinisë femërore për të cilën të gjithë dijetarët janë pajtuar për njëjësin e saj.

Lloji i dytë: “ ة ” e gjinisë femërore për të cilën të gjithë dijetarët janë pajtuar për shumësin e saj.

Lloji i tretë: “ ة ” e gjinisë femërore për të cilën dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme.

LLOJI I PARË:

Rregulli i ndaljes në fjalën kur shkronja e fundit është “ ة ” e gjinisë femërore për të cilën janë pajtuar të gjithë dijetarët se është njëjësi.

Esenciale është që “ ة ” e gjinisë femërore në fund të fjalës shndërrohet në “ ه – H ” nëse bëhet ndalja, pa marrë parasysh çka ka para saj. P.sh.:

وَ مَا هذِهِ الْحَيَاة الدُّنْيَا – الْحَيَاهْ ...
سُنَّةَ اللهِ – سُنَّهْ ...
إِنَّ الصَّلَاة كَانَ – الصَّلَاهْ ...
وَ مَنَاة الثَّالثة الأخرى – الثَّالثهْ ...
رَحْمَة رَبِّك – رَحْمَهْ ...

Ndërsa, nëse pas “ ة ” së gjinisë femërore vjen përemri vetor, atëherë ndalja bëhet te përemri vetor. P.sh.:

إِنَّ صَلاتِى وَ نُسُكِى
وَ رَحْمَتِى وَسعت كُلّ شَيْء

Përjashtim nga ky rregull bëhet në 41 vende në Kur’an të përsëritura 13 fjalë në të cilat fjalë nuk bëhet ndalja me “ ه - H ” , por me (ت).

LLOJI I DYTË:

“ ة ” e gjinisë femërore për të cilën të gjithë dijetarët janë pajtuar për shumësin, dhe nuk ka të bëjë me gjininë femërore dhe atë gjithmonë vjen kur është në pyetje shumësi i çrregullt.

Në të gjitha këto raste ndalja bëhet me “ ه ” , pra “ ة ” (T-ja) shndërrohet në “ ه ” (H). P.sh.:

لحَزَنَةِ جَهَنَّم - لحَزَنَهْ ...
أُلَآئِكَ هُمُ الْكَفَرَةُ اَلْفَجَرَةُ - الْفَجَرَهْ

Nëse është në pyetje si në rastin “ **افتدتهم** ” nuk bëhet ndalja as me “ ة ”, as me “ ه ”, por ndalja bëhet me përemrin vetor “ **هم** ” , e jo në fjalën “ **افتدت** ”.

LLOJI I TRETË:

Janë fjalët të cilat përfundojnë me “ ة ” ose me “ ت ”, por për të cilat dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme se a ka për qëllim njëjësin apo shumësin. Ato janë 7 fjalë që me përsëritje në Kur’an janë të shkruara në 12 vende:

1. Fjala “ **كَلِمَتٌ** ”. Për në 4 vende dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme se a ka për qëllim njëjësin apo shumësin:

   EN’AM, 115 **و تمت**
   JUNUS, 33
   JUNUS, 69
   MUËMINUN, 6

   Përpos këtyre 4 vendeve për të gjitha rastet tjera të kësaj fjale janë pajtuar se është njëjës si p.sh.:

انها كلمة
فَتَلَقَّى آدَمُ مِن رَبِهِ كَلِمَاتٍ

2. Fjala “ **غيابت** ”.

Për në dy vende dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme se a ka për qëllim njëjësin apo shumësin:

Jusuf **و القوه فى غيابت الجب**
Jusuf **ان يجعلوه فى غيابت الجب**

3. Fjala “ **بَيِّنَتٍ** ”.

Fatir **فَهُمْ عَلَى بَينت منه**

Përpos këtij rasti në të gjitha rastet tjera të gjithë dijetarët janë të pajtimit se ka për qëllim shumësi:

حتى تا تيهم التينة
بينات فى صدور الذين اوتوا العلم

4. Fjala “ **جمالت** ”.

5. Fjala “ **ايات** ”.

SUKUNI ARID ME (**ه** - H) e gjinisë femërore pa zanore të gjatë:

و التقوا فِتْنَةً
فبما رحمَة
وِجْهَة

Por, nëse është e shtrirë, atëherë bëhet:
Sukun i plotë **رحمت ربك - رحمتْ**
Revm
Ishmam

Sukun i plotë **ذِكْرُ رَحْمَتِ رَبِّك**
Revm

SUKUNI ARID NË SHKRONJËN “ ٥ ” TË PËREMRIT VETOR

Për ndaljen me lukunin arid të shkronjës “ ٥ ” te përemri vetor dijetarët kanë dhënë tre mendime:

Mendimi i parë: ndalja bëhet vetëm me sukun të plotë, p.sh.:
لَهُ ، مِنهُ ، تؤاخذُهُ

Mendimi i dytë: nëse është me kesre, si p.sh. **بِهِ** , lejohet ndalja me sukun të plotë dhe me Ishmam. Nëse është me dame lejohet me sukun të plotë, me Ishmam dhe me revm.

Mendimi i tretë: Nëse është me kesre dhe para saj me kesre, si p.sh. **بِهِ** , dhe nëse është me dame dhe para saj me dame, si p.sh. **يكفلُهُ** , atëherë lejohet ndalja vetëm me sukun të plotë dhe nuk lejohet Ishmami dhe Revmi. Ndërsa nëse është me dame dhe para saj me fet'ha, si p.sh. **لَهُ** , ose me sukun para saj, si p.sh. **عَنْهُ** , atëherë lejohet ndalja me sukun të plotë, me Ishmam dhe Revm.

MEDI BEDELI – ZGJATIMI ZËVENDËSUES

Zanoret e gjata janë **ا ، و** dhe **ى** , mirëpo motërzimi i (**ا**) është (**ء**) hemzeja, pra kur pas hemzes (**ء**) pason njëra prej këtyre zanoreve të gjata (**ا ، و** dhe **ى**), atëherë bëhet togimi i zanoreve të njëjta. Togimin i zanoreve të njëjta e bëjmë zgjatim natyror, dhe quhet MEDI BEDEL (Zëvendësues i zgjatimit).

Pra, Bedel është atëherë kur takohen dy hemze me zanore: e para e vokalizuar, ndërsa e dyta me sukun: atëherë e dyta shndërrohet në shkronjë zgjatuese, pra bëhet togimi i dy zanoreve.

- Nëse para hemzes është fet'ha, shndërrohet në zanore të gjatë:

اَا (aa) أَاْ اَا

- Nëse para hemzes është kesre shndërrohet në zanore të gjatë:

اِى إِاْ اِى

- Nëse para hemzes është dame shndërrohet në zanore të gjatë:

اُو أُاْ اُو

Ky lloj zgjatimi është vaxhib të zgjatet vetëm dy vokale.

- Mirëpo, nëse pas shkronjës shndërruese vjen hemzeja në trup të fjalës bëhet Medi Muttasil. P.sh.: **بَرَآء**

- Nëse pas shkronjës shndërruese vjen hemzeja në kufirin mes dy fjalëve bëhet medi munfasil, p.sh.: **وَجَاءوا أَبَاهُمْ**

- Nëse pas shkronjës shndërruese vjen sukuni arid, atëherë këndohet shkurt, mesëm, gjatë.

2 vokale - **مَآبْ**

4 vokale - **مَآبْ**

6 vokale - **مَآبْ**

Rrënja e fjalës **آمَنَ** është **أَأْمَنَ** , pra dy hemze, Hemzeja e parë me fet-ha, ndërsa hemzeja e dytë me sukun, atëherë sukunin e zëvendëson Elifi dhe bëhen dy shkronja të njëjta, të cilat zëvendësohen në një shkronjë të gjatë **آمَنَ** .

Rrënja e fjalës **اوتى** është **أُوْتى** , pra dy hemze: hemzeja e parë me dame, ndërsa hemzeja e dytë me sukun, atëherë sukunin e zëvendëson elifi dhe bëhen dy shkronja të njëjta të cilat zëvendësohen në një shkronjë të gjatë **اوتى** .

Rrënja e fjalës **إِيمَانًا** është **إِئْمَانًا** , pra dy hemze: hemzjeja e parë me kesre, ndërsa hemzeja e dytë me sukun, atëherë sukunin e zëvendëson elifi dhe bëhen dy shkronja të njëjta të cilat zëvendësohen në një shkronjë të gjatë **إِيمَانًا** .

Zgjatimi i MEDI BEDELIT është zgjatim i lejuar.
Zgjatet sa dy vokale, por edhe mund të shkurtohet. P.sh.:

ءَادَمَ ، ءَامَنَ الرَّسُولُ ن ءَات ذا قربى

وَ ءَاتى الزَّكَاة
أُوتُوا
إِمَانَا

* Shart është që hemzeja të jetë në ballë të fjalës dhe para ndonjërës prej tri zanoreve të gjata.

* Nëse hemzeja është në trup (mes) të fjalës dhe pas saj është njëra prej zanoreve të gjata, këndohet gjatë, pra zgjatje natyrore dhe quhet "Bedel" (zëvendësues) vetëm formalisht apo mund të quhet ngjasim i medi bedelit, si p.sh. fjalët:

إِسْرَآءِيلَ ، مَسْؤُولًا ، وَ ءَابَآءَهُمْ
قُرْءَان

Medi bedeli bëhet në 7 mënyra:

1. Sukun i plotë 2 vokale
2. Sukun i plotë 4 vokale
3. Sukun i plotë 6 vokale
4. Ishmam 2 vokale
5. Ishmam 4 vokale } rruga **tedeli**
6. Ishmam 6 vokale
7. Revm 2 vokale

KATEGORITË E ZGJATIMEVE

Janë dy shkaqe të zgjatimeve jonatyrore, e ato janë:

- hemzeja (ء) dhe
- sukuni (◌ْ).

Varësisht nga shkaku zgjatimet munden të jenë:

- Zgjatime më të fuqishme dhe
- Zgjatime më të dobëta.

Çdo herë kur shkaku është më i fuqishëm, ashtu edhe zgjatimi është më i fuqishëm.

Çdo herë kur shkaku është më i dobët, ashtu edhe zgjatimi është më i dobët.

Sukuni rrënjësor si shkak i zgjatjes është më i fuqishëm se hemzeja shkaktare.

Renditja e zgjatjeve është kështu:

1. MEDI LAZËM më e fuqishmja,
2. MEDI MUTASIL ,
3. MEDI ARID,
4. MEDI MUNFASIL dhe
5. MEDI BEDELI.

1. MEDI LAZËM është zgjatimi më i fuqishmi për arsye se shkaktar është sukuni si në të ndalurit e leximit ashtu edhe në të vazhduarit, dhe se shkaqet janë në të njëjtën fjalë, ose në të njëjtën shkronjë.
Është e domosdoshme zgjatja 6 vokale tek të gjithë dijetarët e leximit të Kur'anit.

2. MEDI MUTASIL është zgjatim i rangut të dytë, për arsye se hemzeja si shkaktar dhe zanoret e gjata janë në një fjalë. Dijetarët janë të pajtimit që të zgjatet më shumë se zgjatja natyrore, pra nuk lejohet shkurtimi në dy vokale edhe pse disa e parashohin 4 vokale, e disa të tjerë 5 vokale.

3. MEDI ARID I SUKUNIT është zgjatim i rangut të tretë, sepse shkaktari Sukuni Arid është në të njëjtën fjalë me zanoret e gjata, pra sukuni nuk është rrënjësor, që do të thotë nëse vazhdohet leximi kthehet rregulli në bazë, pra në zgjatje natyrore (dy vokale). Ky zgjatim për këtë arsye është i lejuar të jetë i shkurtë (dy vokale), i mesëm (4 vokale) dhe i gjatë (6 vokale).

4. MEDI MUNFASILI është zgjatim i rangut të katërt, sepse shkaku – hemzeja (elifi) nuk është në të njëjtën fjalë, por në fjalën tjetër. Medi Munfasili lejohet të shkurtohet 2 vokale.

5. MEDI BEDELI është zgjatim i rangut të pestë.

Nuk lejohet zgjatimi i barabartë kur të jenë në të njëjtin ajet zgjatimi i fuqishëm me të dobëtin. P.sh. nuk lejohet që medi munfasil të zgjatet pesë vokale, ndërsa medi mutasil katër vokale, sepse në atë rast rangu më i dobët është zgjatur më shumë se rangu më i fuqishëm.

Nga ky rregull rezultojnë çështjet si vijojnë:

1. Nëse shkurtohet medi aridi në 2 vokale, lejohet medi mutasili 4 dhe 5 vokale, kjo nga shkaku se minimumi i medi mutasilit është 4 vokale, dhe po ashtu minimumi i medi aridit është 2 vokale, ndërsa lejohet 5 vokale sepse është më i fuqishëm se medi aridi dhe nuk ka kurrfarë pengese.

2. Nëse medi aridi këndohet 4 vokale, lejohet, që medi mutasili të zgjatet 4 vokale dhe 5 vokale.

- Zgjatet medi mutasili 4 vokale se barazohet me medi aridin.
- Zgjatet medi mutasili 5. 6 vokale se është më i fuqishëm se medi aridi.

3. Nëse zgjatet medi aridi 5 ose 6 vokale, atëherë nuk lejohet që medi aridi të zgajtet më pak se 5 ose 6 vokale sepse kjo është gjatësia më madhe e mundshme.

4. Nëse këndohet medi mnfasili 2 vokale lejohet që medi aridi të këndohet 2 dhe 4 vokale, po ashtu e dhe medi smutasili.
5. Nëse medi munfasili këndohet 4 vokale, lejohet medi aridi 4 vokale edhe medi mutasili 4 vokale, që të barazohen të gjitha zgjatimet, por lejohet që medi mutasili të zgjatet 5 vokale, pra më shumë se medi munfasili dhe medi aridi, për arsye se medi mutasili është aridi më i fuqishëm se ata të dy, por lejohet që edhe medi aridi të nivelizohet se është më i fuqishëm se medi munfasili dhe më i dobët se medi mutasili, pra medi aridit i lejohet deri në nivelizim të medi mutasilit, e më shumë jo.
6. Nëse medi munfasili zgjatet 5 vokale, atëherë medi mutasili dhe medi lazmi nuk lejohet të zgjaten më pak se 5 vokale, sepse atëherë do të ndodhte që më e dobëta të zgjatet më shumë se më e fuqishmja.

Në fund të kuptojmë se:

- nëse janë në ajet vetëm medi munfasilat, zgjaten njësoj,
- nëse janë medi mutasilët, zgjaten njësoj, pra e para duhet të nivelizohet me të dytën.
- nëse janë vetëm medi lazim-at, zgjaten njësoj.

وَ جَآءُوا أَبَاهُمْ ،
وَ لا آمين ،

TAKIMI I DY ZGJATIMEVE NË TË NJËJTIN VEND

Nëse në një fjalë, apo në dy fjalë, në të njëjtën kohë ndodhen dy shkaqe, njëri më i fortë, tjetri më i dobët, atëherë veprohet sipas rregullit të të fortit; nëse janë dy shkaqe dhe janë të forta, por njëri është më i fortë se tjetri, veprohet sipas rregullit të më të fortit. P.sh.:

Fjala **آمين** në suretu El-Maide **وَ لا آمين الْبيت الحرام**

Në këtë fjalë ndodhen dy shkaqe:

Shkaku i parë: është elifi i harfi medit, pra zgjatimi i Medi bedelit zëvendësuesit (◌َا).

Shkaku i dytë: është sukuni rrënjësor pas harfimedit, i cili zgjatet si në të vazhduar si në të ndalur të leximit).

Shkaku i parë është më i dobët se shkaku i dytë, bile më fortë, atëherë medi bedeli bie nga rregulli dhe mbetet vetëm Medi Lazimi.

Fjala **جَآنٌّ** në suretu Rrahman **وَ لا جَآنّ**

Nëse ndalemi në këtë fjalë ndodhen dy shkaqe:

Shkaku i parë: është sukuni rrënjësor pas zanores së gjatë (si në të ndalur, ashtu edhe në të vazhduar të leximit). Kjo do të thotë Medi Lazim.

Shkaku i dytë: është sukuni i ndalimit.

Shkaku i parë është më i fuqishëm se shkaku i dytë. Për këtë arsye nëse ndalemi, nuk ndalemi me sukunin arid, por me zgjatjen e domosdoshme Medi Lazim.

Njësoj është edhe me fjalën **غير مضآرّ** në suretu En-Nisa.

Në fjalën **رئَآء الناس** janë dy shkaqe:
Shkaku i parë: Hemzeja e cila është zëvendësuar, pra Medi Bedeli.
Shkaku i dytë: Pas zanores së gjatë është prapë hemzeja e cila e bën vaxhib Medi Mutasil.

Shkaku i parë (Medi Bedeli) është i dobët, ndërsa i dyti i fortë, kështu që veprohet me të fortin, pra me Medi Mutasilin dhe zhvleftësohet shkaku i parë (Medi Bedeli).

Njësoj sikur në këtë fjalë në suretu El-Mumtehine fjala **يرآء** .

Fjala **رءا أيديهم**
Shkaku i parë: është hemzeja e cila shkakton Medi Bedelin.
Shkaku i dytë: është elifi i cili shkakton Medi Munfasilin.

Shkaku i parë është i dobët, ndërsa i dyti i fortë, kështu që veprohet me të fortin, pra nuk zgjatet Medi Bedeli, por zgjatet Medi Munfasili.

Fjala **يشآء**

Në të ndalur në këtë fjalë paraqiten dy shkaqe:
Shkaku i parë: Pas zanores së gjatë është hemzeja, e cila shkakton Medi Mutasilin.

Shkaku i dytë: Pasi bëhet ndalja me hemze, bëhet ndalja me sukun, që do të thotë bëhet zgjatja Medi Arid Lisukun.

Shkaku i parë (hemzeja) është më i fuqishëm. Për këtë arsye nuk lejohet ndalja dy vokale siç bëhet në rastet tjera në zgjatimin e Medi Aridit, por vetëm Medi Mutasil.

Fjala **مَآب**

Në të ndalur në këtë fjalë paraqiten dy shkaqe:
Shkaku i parë: është hemzeja, e cila shkakton Medi Bedelin.

Shkaku i dytë: është sukuni Arid i cili shkakton Medi Aridin, pasi që bëhet ndalja. Atëherë nuk vlen rregulli i Medi Bedelit, por vetëm i Medi Aridit, pasi që Medi Aridi është më i fortë se Medi Bedeli.

TË NDALURIT NË FUND TË FJALËS

Të ndalurit në fund të fjalës mund të jetë:

1. me sukukun të plotë,
2. me ishmam,
3. me revm,
4. me hadhf dhe
5. me ibdal.

1) ME SUKUKUN TË PLOTË

Parësore (rrënjësore) është, që gjithmonë leximi të përfundon me sukunin e plotë të shkronjës së fundit, për arsye se fillimi bëhet me zanore.

2) TË NDALURIT ME REVM,

Revm do të thotë dobësimi i zërit të vokales deri në atë masë sa që i afërti e dëgjon, ndërsa i largëti nuk mund ta dëgjon.

Disa dijetarë kanë thënë se remi është të shqiptuarit e një të tretës së zanores me zë të ulët deri në atë masë sa, që e dëgjon i afërti, e jo i largëti.

Duhet ditur se remi është posaçërisht për te zgjatimi jonatyror i shkurtë, pra zgjatimi dy vokale i Medi Aridit, sepse në këtë rast i ngjason vazhdimit të leximit e jo të ndalurit.
Revmi bëhet:

- në rasën emërore, p.sh. نَسْتَعِينُ
- në rasën gjinore, p.sh. الرَّحِيمِ

Revmi nuk bëhet në rasën kallëzore (me fet-ha).
Revmi bëhet vetëm me rastin e të ndalurit të leximit, e jo me rastin e vazhdimit të leximit.

Revmi bëhet vetëm në fund të fjalës, përjashtim bën vetëm fjala në suretu jusuf ku remi bëhet në mes të fjalës: لا تَأْمَنَّا

Në esencë kjo fjalë ka qenë تَأْمَنُنَا , por është bërë dyfishimi i nunit dhe nevojitet me rastin e sukunit të parë të nunit të këndohet revm.

Fjala në të cilën ndalemi gjatë leximit është dhjetë llojesh:

LLOJI I PARË është përfundimi i fjalës, i cili ka sukunin rrënjësor, si p.sh.:
لَمْ يَلِدْ وَ لَمْ يُولَدْ ،
فَلا تنهر ،
فَإِذَا فَرَغْتَ فَا نْصَبْ

Rregulli: Ndalja bëhet e njëjtë sikurse edhe vazhdimi i leximit bëhet i njëjtë:

LLOJI I DYTË - Kur përfundimi i fjalës është me tenvin.

- nëse tenvini është i rasës kallëzore, pra En (ًا), atëherë tenvini zëvendësohet me elif, pra me zgjatim në të ndalur. P.sh.:

عِلْمًا ، خَبِيرًا ، أَمَدًا ، حَكِيمًا ،

- nëse tenvini është i rasës emërore __ٌ__ ose i rasës gjinore __ٍ__

, tenvini eliminohet në tërësi, sikurse të mos ekzistonte fare dhe ndalja bëhet me sukun në shkronjën e fundit të fjalës. P.sh.:

وَ اللهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ،
رَحِيمٍ ،

LLOJI I TRETË – Kur shkronja e fundit e fjalës është me zanoren FET-HATU __◌́__ , nuk lejohet mënyrë tjetër, pos:

- shkurt, 2 vokale me sukun të plotë,
- mesëm, 4 vokale me sukun të plotë, dhe
- gjatë, 6 vokale me sukun të plotë,

pra, nuk lejohet REVMI dhe ISHMAMI. P.sh.:

عَالَمِينَ ، وَ من عَادَ ،

Shënim

❋ Kur shkronja e fundit e fjalës është me zanoren DAMETU __◌ُ__ , ndalja lejohet në shtatë forma:

1. Shkurt me sukun të plotë,
2. Mesëm me sukun të plotë,
3. Gjatë me sukun të plotë,
4. Shkurt me ishmam,
5. Mesëm me ishmam,
6. Gjatë me ishmam,
7. Shkurt me rumë, pra rumi bëhet vetëm nëse ndalemi te Medi Aridi shkurt, ndërsa nëse e këndojmë gjatë nuk lejohet të ndalurit me rumë, sepse rumi i ngjason vazhdimit të leximit dhe pse ndalemi dhe sikurse po të vazhdonte leximi nuk lejohet pos shkurt dy vokale, ashtu nëse këndohet shkurt vjen në radhë rumi. P.sh.:

يَا نُوحُ ،
يَا إِبْرَاهِيمُ ،
نَسْتَعِينُ

❋ Kur shkronja e fundit e fjalës është me zanoren KESRETU __◌ِ__ , ndalja bëhet vetëm në 4 forma:

1. Shkurt me sukun të plotë,
2. Mesëm me sukun të plotë,
3. Gjatë me sukun të plotë, dhe

4. Shkurt me Reumë.

P.sh.:

إِلَى صِرَاط الْمُسْتَقِيمِ

Shënim: Nëse është kesretu binai **وَ إِلَيْهِ متَابَ**

- Nëse bëhet ndalja e Medi Lijnit me Rumë duhet ta dimë se nuk bëhet zgjatje fare, pra sikurse gjatë vazhdimit të leximit ku nuk ka zgjatim dy vokalesh, por vetëm shkurt një vokale, ndërsa nëse bëhet zgjatimi dy vokalesh te MEDI LINI, atëherë nuk lejohet të bëhet Rumi.

- Nëse shkronja e fundit është me tevin, pa marrë parasysh me __ً__ apo __ٌ__ , atëherë eliminohet tenvini dhe bëhet Rumi vetëm për kesre apo për damen, e jo për tenvinin.

LLOJI I KATËRT – Kur shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi është hemze (**ء**), ndërsa para saj është zanorja e gjatë e që quhet MEDI MUTASIL, pra bëhet më e fuqishme se MEDI ARID.

- nëse vokali i hemzes (**ء**) është fet-ha __ٔ__ , ndalja bëhet në tri forma:

E para: Mesëm, 4 vokale.
E dyta: Më shumë se mesëm, 5 vokale.
Pra, siç bëhet zgjatimi në të vazhduar të leximit ashtu bëhet zgjatimi në të ndalur të leximit.
E treta: Gjatë, 6 vokale, mirëpo në këtë rast ky zgjatim quhet MEDI ARID LI SUKUN dhe nuk quhet MEDI ARID. P.sh.:

وَ لا وٴتوا السفهآء
و يمسك السمآء
شآء ما افآء

- Nëse shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi është hemze (**ء**) me kesre (__ٕ__) , ndalimi bëhet në pesë forma:

E para – Mesëm, 4 vokale, me sukun të plotë,
E dyta – Më shumë se mesëm, 5 vokale, me sukun të plotë,
E treta – Mesëm, 4 vokale, me Rum,
E katërta – Më shumë se mesëm, 5 vokale, me Rum,

E gjashta – Gjatë, 6 vokale, me sukun të plotë, pra nëse bëhet zgjatimi 6 vokale nuk lejohet Rumi, sepse ky zgjatim nuk lejohet në të vazhduarit të leximit, por vetëm në të ndalur. P.sh.:

مِنَ الْمَآءِ ، مِنْ مَآءٍ

- Nëse shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi është hemze (**ء**) me dametun __ُ__ , ndalimi bëhet në 8 forma:

E para – Mesëm, 4 vokale, me sukun të plotë,
E dyta – Më shumë se mesëm 5 vokale, me sukun të plotë,
E treta – Mesëm 4 vokale, me Rumë,
E katërta – Më shumë se mesëm, 5 vokale me rumë,
E pesta – Mesëm, 4 vokale, me ishmam,
E gjashta – Më shumë se mesëm 5 vokale, me ishmam,
E shtata – Gjatë, 6 vokale, me sukun të plotë,
E Teta – Gjatë, 6 vokale, me ishmam.

LLOJI I PESTË – Kur shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi është i dyfishuar (me teshtid), ndërsa para saj është zanorja e gjatë e që quhet MEDI LAZIM.

- Nëse shkronja e dyfishuar është me el-fet-ha-tun, këndohet gjatë, vetëm 6 vokale dhe me sukun të plotë, ndërsa nuk lejohet RUMI dhe ISHMAMI. P.sh.:

صَوَآفَّ ،
لا تضَآرَّ

- Nëse shkronja e dyfishuar është me el-kesretun, këndohet gjatë, vetëm 6 vokale, por lejohet edhe me sukun të plotë dhe me Rumë. P.sh.:

إِنَّ شر الدّواب ،
غَيْر مضآرّ

- Nëse shkronja e fundit e dyfishuar është me ed-dametu këndohet gjatë, 6 vokale, por lejohet me sukun të plotë, me ishmam dhe me Rumë. P.sh.:

كانها جَآنٌّ ،

LLOJI I GJASHTË – Kur shkronja e fundit ku ndalemi është " ﻫ " e përemrit vetor, pra " ﻫ " shtesë e fjalës së vetës së parë të gjinisë mashkullore.

Këtu nuk bën pjesë " ﻫ " e rrënjës së fjalës, apo " ﻫ " e cila është pjesë përbërëse e fjalës, si p.sh.:

فَوَكِه ، نفقه ، وَ إِنَّهُ عَنِ الْمنكر ،
لَئِنْ لَمْ تَنْتَهِ ، لَئِنْ لَمْ يَنْتَهُ ، وجه ابيكم

" ﻫ " e përemrit vetor ka shtatë forma:

Forma e parë – Kur para saj është zanorja e gjatë e "vavun" pa marrë parasysh a është edhe shkronja e Linit apo jo. P.sh.:

خذوهُ ثم الجهيم صلوه رَأَوْهُ
وشروهُ و ليرضوه

Forma e dytë – Kur para saj është zanorja e shkurtë e dametu. P.sh.:

فَإِنَّ اللهَ يعلمُهُ عَلَى من يكفلهْ فَإِنَّهُ اثم قلبُهْ

Forma e tretë – Kur para saj është zanorja e gjatë " ى – Jaun" pa marrë parasysh a është Linë apo jo. P.sh.:

فالقيه قصيه عليه
إِلَيْه لديه

Forma e katërt – Kur para saj është zanorja e shkurtë kesre. P.sh.:

بِأَمْرِه لِحُكْمِه ذكر ربه

Forma e pestë – Kur para saj është zanorja e gjatë elif. P.sh.:

إجتباه هدیناه و فدیناه

Forma e gjashtë – Kur para saj është sukuni i vërtetë. P.sh.:

مِنْه فَلْيَصُمْه ابلغه

Forma e shtatë – Kur para saj është el Fet-hatu. P.sh.:

ثُمَّ أَمَاتَهُ فَأَقْبَرَه .
ثُمَّ إِذَا شَآءَ أَنشَرَه .

LLOJI I SHTATË - Kur shkronja e fundit ku ndalemi është me ndonjërën prej zanoreve të shkurta, dhe para saj nuk ka " هـ " të përemrit vetor, as zanore të gjatë, e as shkronjë të Linit.

- Nëse është me zanoren e shkurt el fet-hatu, atëherë ndalja bëhet vetëm me sukun të plotë dhe nuk lejohet Rumi dhe Ishmami:

لكيلا يعلم
الا من ظلم
أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَر
هنالك

- Nëse është me zanoren e shkurtë ed-dametu lejohen tri format: me sukun të plotë, me rumë dhe me ishmam:

إِنِّى توكلت
اين ما كنتُ
يَا مَرْيَمُ
يَا صَالِحُ
من قبل و من بعد

- Nëse është me zanorën e shkurtë el-kesretu lejohen dy format: me sukun të plotë dhe me rumë. P.sh.:

وَ الْعَصْرِ
فِى الْمَسَاجِدْ
فَهل من مدكر
اهكذا عرشكِ
انى لكِ

Ky lloj ndalimi quhet **sukuni arid** i të ndalurit.

LLOJI I TETË – Kur shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi është " ة " e gjinisë femërore e cila për shkak të ndaljes shndërrohet në " هـ " (H).
Kjo shkronjë vjen në dy forma:

Forma e parë: Nëse para saj është elifi (ا). P.sh.:

وَ أَقِيمُوا الصَّلاةَ ،

عَلَى حياة ،

Lejohet të zgjatet:

- shkurt, 2 vokale, me sukun të plotë,
- mesëm, 4 vokale, me sukun të plotë,
- gjatë, 6 vokale, me sukun të plotë.

Forma e dytë: Nëse nuk ka para saj elif (ا). P.sh.:

الْجَنَّة ، رَحْمَة ، نعمة

Në këto raste bëhet vetëm shndërrimi i shkronjës " ة " (T) në " ه " (H) dhe nuk lejohet as rumi, as ishmami, sepse zanorja ka qenë pjesë përbërëse e shkronjës " ة " (T) e jo e shkronjës " ه " (H).

Mirëpo, në 13 fjalë ku shkronja " ة " (T) e rrumbullakët është shkruar me " ت " (T) të shtrirë të zgjatur, lejohet edhe rumi edh ishmami, sepse zanorja është pjesë e shkronjës " ت " (T).

LLOJI I NËNTË – Kur shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi ka qenë me sukun të plotë, mirëpo për shkak të lidhjes, nuk janë shkruar dy sukuna (sukuni i shkronjës së fundit të fjalës së parë me sukunin e shkronjës së parë të fjalës së dytë), por është zëvendësuar me zanoren e ngjitjes së fjalëve. P.sh.:

قُمْ – قُمِ اللَّيْلَ
رُجّتْ – رُجّتِ الأَرْ
وَ أَنْتُمْ - وَ أَنْتُمُ الأَعلون

Nëse bëhet ndalja në këto fjalë, ndalja bëhet vetëm me sukun të plotë dhe nuk lejohet as Rumi, as Ishmami, sepse esenciale ka qenë sukuni i plotë, ndërsa shtesë apo sekondare zanorja.

LLOJI I DHJETË – Kur shkronja e fundit e fjalës ku ndalemi është shkronja " م " e shumësit. P.sh. fjala:

عَلَيْهِمْ
غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ

Në këtë rast nuk lejohet as ishmami, as rumi, por vetëm të ndalurit me sukun të plotë.

PËRFUNDIM

- Nga e gjithë ajo çka treguam më lart, kuptojmë se Rumi dhe Ishmami nuk bëhen në shkronjën e fundit të fjalës e cila është me fet-hatun __ـ__ .

Nuk bëhet Rumi në zanoren el-fet-hatu, sepse zanorja el-fet-hatu është zanore e shpejtë në theksim dhe nëse një pjesë e zanores theksohet, theksohet zanorja e plotë.

Nuk bëhet Ishmami në zanoren el-fet-hatu, sepse bashkimi i buzëve pas sukunit sinjalizon damen, e jo fet-hatun.

- Rumi dhe Ishmami nuk bëhen në shkronjën “ة – t” të gjinisë femërore e cila shndërrohet në “ه – h” për shkak të ndaljes.
- Rumi dhe ishmami nuk bëhen në shkronjën “ م - m ” të shumësit.
- Rumi dhe ishmami nuk bëhen në zanoren, e cila paraqitet vetëm për shkak të takimit të dy sukunave.
- Ishmami nuk bëhet në zanoren me el-kesretu, sepse bashkimi i buzëve sinjalizon el-dametun, ndërsa zanorja el-kesretu tregon gjinoren.
- Rumi bëhet në zanoren me el-kesretu dhe zanoren me el-dametu, sepse që të ey zanoret janë të rënda dhe me Rum mund të sinjalizohen.

KAPITULLI I SHTATË

NUNI ME SUKUN (SHKRONJA ن – Nun E PAVOKALIZUAR) DHE TENVINI (DYZANORËSHI)

NUNI ME SUKUN DHE TENVINI

Cilësitë e shkronjës **ن** - Nun janë:

Rrëshqitëse	Shkëputëse	Ultësuese	Mesatare	Haptësuese
الادلاف	الانفتاح	الاستفال	التوسط	الجهر

Shkronja “ **ن** - nun ” mundet të jetë:

- me sukun ◌ْ ,
- me vokale (__◌َ___ _____ ___◌ُ__) ,
- në mes të fjalës, dhe
- në fund të fjalës.

Ne do të flasim vetëm për nunin me sukun (të pavokalizuar).
Nuni me sukun (i pavokalizuar) paraqitet në emra, folje dhe pjesëza:

- Në emra **سنبلة سندس**
- Në folje **يَنْظُرْ ، يَنْهَى**
- Në pjesëza **مِنْ ، عَنْ ، إِنْ**

Nunin me sukun kemi për qëllim jo nunin me sukun i cili ndodhet brenda teshtidit, p.sh. **أَنَّارُ أَنْنَارُ ، إِنَّ إِنْنَ**

- As nunin me zanore ose të vokalizuar, p.sh.: **إِنِ ٱرْتَبْتُمْ**
- As nunin i cili është me zanore në fund të fjalës, por bëhet me sukun vetëm pas ndaljes e që quhet sukuni arid i shkronjës. P.sh.:

تَعْلَمُونَ - تَعْلَمُونْ -

Tenvini është dyfishimi i zanoreve i cili shkruhet vetëm në fund të fjalës dhe atë në fund të fjalës e cila tregon emër e jo folje. Disa dijetarë e kanë përshkruar se tenvini e përcjellë emrin deri në fund nëse kalon apo vazhdon më tutje, ndërsa nëse ndalet leximi nuk e përcjell emrin. Që do të thotë se tenvini është zërim (fonim) i nunit me sukun, i cili vjen në fund të fjalës p.sh.: **نَارٌ - نَارُنْ** pra, përfundimi është me nun me sukun por ne nuk e shkruajmë, por vetëm e mbajmë në mendje dhe e lexojmë **نْ** nun me sukun.

Tenvini i ka tri zanore të dyfishta, pra dy dametun, dy kesretun dhe dy fet'hatun. Përfundimi është me nun me sukun, por ne nuk e shkruajmë.

Sikurse edhe njeriu i cili sillet me njerëzit tjerë në bazë të raporteve me tjerët: ndonjëherë ndahet në vete, veçohet dhe largohet nga të tjerët, ndonjëherë bashkohet me të tjerët dhe bëhet si një trup, ndonjëherë fshihet prej të tjerëve, ashtu ndonjëherë e ndryshon personalitetin e tij dhe bëhet sikur person tjetër. Ashtu edhe nuni i palokalizuar dhe tenvini sillet me shkronjat e tjera të alfabetit prej *hemzes* e deri te *Janun*.

Pra, gjendja e tij ndryshon varësisht se me cilën shkronjë është në raport:

- ndonjëherë ndahet, veçohet dhe nuk bashkohet me disa shkronja,
- ndonjëherë bashkohet me shkronjat tjera dhe bëhet trup me to,
- ndonjëherë e fshehë personalitetin para shkronjave tjera,
- ndonjëherë shndërrohet tërësisht në personalitet (shkronjë) tjetër.

Pra, rregullat e nunit me sukun dhe tenvinit janë:

1. Idh-hari (të kënduarit e plotë dhe rrjedhshëm),
2. Idgami (të bashkëngjiturit dhe të asimiluarit),
3. Iklabi (të shndërruarit, disimilimit), dhe
4. Ihfa-ja (të fshehurit).

1. IDHHARI

IDHHAR do të thotë qartë, thekshëm dhe rrjedhshëm.
Në terminologji do të thotë: Shqiptimi i shkronjës sa më qartë, sa më thekshëm dhe sa më rrjedhshëm.

Shkronjat e IDHHARIT janë 6: Hemze (ء), haun (ه), ajnun (ع), Haun (ح), gajni (غ) dhe Haun (خ).

Nëse para nunit me sukun apo tenvinit gjendet ndonjëra prej 6 shkronjave të fytit (ا ه ح ع غ خ), patjetër nuni me sukun duhet të shqiptohet rrjedhshëm dhe i plotë.

مَنْ ءَامَنَ مِنْهُمْ ، إِنْ أَرَدْتُمْ ، مِنْ هَادٍ ، فَمَنْ حَآجَّكَ ، مَنْ خَيْرٍ ، مَنْ خَشِيَ ، فَإِنْخِفْتُمْ ، مِنْ عَمَلِنْ ، مِنْ غَيْرِكُمْ ، مِنْ غِسْلِينٍ .

Gjatë idhnarit – shqiptimit të rrjedhshëm duhet pasur kujdes që, as të mos bëhet kalkale, as idgam, as sekte (ndërprerje), por me saktësi shqiptim të plotë dhe të rrjedhshëm të nunit.

Idhhari ka tri kategori:

Kategoria e lartë – Shqiptimi para hemzes dhe shkronjës **ها**

Kategoria e mesme – Shqiptimi para Ajnit dhe Haut **ح**

Kategoria e ulët – Shqiptimi para hajnit dhe Haut **خ**

Idhhari i nunit me sukun mund të vjen në trup të fjalës dhe në kufirin mes dy fjalëve, ndërsa Idhhari i tenvinit vjen vetëm në kufirin mes dy fjalëve. Nga kjo vijmë në konkludim se Idhhari vjen në 18 raste, që do të thotë 12 raste të nunit me sukun dhe 6 të tenvinit.

الحرف	مع النون الساكنة فى كلمة	مع النون الساكنة فى كلمتين	بعد التنوين
الهمز	(ينأون)	(من آمن)	(و جنات

			ألفافا)
الهاء	(ينهون)	(من هاد)	(حرف هار)
العين	(أنعمت)	(من عمل)	(سميع عليم)
الحاء	(و انحر)	(فان حاجوك)	(عليم حليم)
الغين	(فسينغضون)	(من غل)	(و رب غفور)
الخاء	(و المنخنقة)	(من خلاق)	(عليم خبير)

Shkak i Idhharit është se nuni me sukun dhe tenvini artikulohen prej majës së gjuhës, ndërsa shkronjat gërmazore prej thellësisë së fytit, pra pasi nuk kanë gjëra të përbashkëta shqiptohet nuni me sukun dhe tenvini qartë.

Sikurse shenjat e komunikacionit, kur një shenjë tregon "**ndalu"** , ndërsa ndonjë shenjë "**ndalim parkingu**", ashtu edhe Idhhari e ka shenjën – e shenja e saj është koka e shkronjës "**خ** ", ﺧـ pa pikë. sh.

مِنْ خَيْر

Ndërsa kur të jetë tenvini i cili bëhet Idhhar, atëherë dy fet'hatun, dy kesretun dhe dy dametun janë paralel.

(__ً___ _____ ___ٌ__) ,

ٍ

2. IDGAMI - BASHKËNGJITJA

IDGAM do të thotë depërtim i diçkaje në diçka.
Në terminologji do të thotë: Depërtimi i shkronjës me sukun në shkronjën me zanore ashtu, që bëhen një shkronjë e përforcuar si me teshtid. Në këtë

rast kemi të bëjmë depërtimin e nunit me sukun apo tenvinit në shkronjën me zanore ashtu, që shkrirja e saj shndërrohet në shkronjën në vijim. Shkronjat në, të cilat depërton, shkrihet dhe shndërrohet nuni me sukun janë:

الْيَاءُ - ي
النُّونُ - ن
الْمِيمُ - م
الْوَاوُ - و
اللامُ - ل
الرَّاءُ - ر

Idgami është dy llojesh:

- Idgami meal guneh / hundërzore /,
- Idgami bila guheh / çhundërzore /.

Fusnotë: Asimilimi – Asimilimi është ndërrimi fonetik që pëson një zanore ose bashkëtingëllore në kontakt me një tjetër brenda një fjale, në kufirin midis dy fjalëve ose si rezultat i rënies së (ë)-së së patheksuar. Tingulli që shërben si asimilues i një tingulli tjetër, i transmeton këtij të fundit, plotësisht ose pjesërisht, njërin ose disa prej tipareve të tij nyjëtimore.

2. a) IDGAMI MEAL GUNEH

BASHKËNGJITJA DHE SHNDËRRIMI I HUNDËRZUAR

Kur në fund të fjalës ndodhet nuni me sukun apo tenvini dhe menjëherë në fjalën tjetër njëra prej katër shkronjave (**ي م ن و**), atëherë bëhet depërtimi – shkrirja dhe bashkëngjitja e tyre në shkronjën paraprake.

Kjo shkrirje dhe bashkëngjitje quhet Idgamu meal gune (shkrirje dhe shndërrim dhe bashkëngjitje e hundëruar). P.sh.:

مِنْ وَلِيٍّ ← مِوْ وَلِيٍّ ← مِوَّلِيٍّ
مِنْ نَارٍ ← مِن نَارٍ ← مِنَّارٍ
مِنْ يَوْمٍ ← مِي يَوْمٍ ← مِيَّوْمٍ
مِنْ مَا ← مِمْ مَا ← مِمَّا
مِنْ مَالٍ ← مِمْ مَالٍ ← مِمَّالٍ
مَنْ يَقُولَ ← مَيْ يَقُولُ ← مَيَّقُولُ
بَرْقٌ يَجْعَلُونَ ← بَرْقُيْ يَجْعَلُونَ ← بَرْقُيَّجْعَلُونَ
مِنْ وَادٍ ← مِوْ وَادٍ ← مِوَّادٍ
مِن نَاصِرِينَ ← مِنْ نَاصِرِينَ ← مِنَّاصِرِينَ
مِنْ وَلِيٍّ ← مِوْ وَلِيٍّ ← مِوَّلِيٍّ
عَذَابٌ مُهِينٌ ← عَذَابُمْ مُهِينٌ ← عَذَابُمُّهِينٌ
قَوْلٌ مَعْرُوفٌ ← مِوْ وَادٍ ← مِوَّادٍ

مَن يَعْمَلْ ، وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ
مِن وَلَدٍ ، خَيْرٌ وَ أَبْقَى
مِن مَسَدٍ ، قَوْلٌ مَعْرُوفٌ
مِن نَذِيرٍ ، كُلَّا نُمِد

Shkrirja dhe bashkëngjitja bëhet në atë mënyrë sa që formohet një tingull i këndshëm i cili duhet të burojë nga fyti dhe të kalojë në fortësinë e hundës (Hajshumit).

- GUNEH duhet të shqiptohet me fortësinë e hundës, e jo me zërimin e gjuhës.
- Zgjatja e idgamu meal guneh duhet të jetë dy vokale.
- Idgamu meal guneh ndryshe edhe quhet idgami i mangët për arsye se mbetet pjesërisht nuni me sukun apo tevini. Pra, Ruhet karakteri hundor i bashkëtingëlloreve.

Shkak i bashkëngjitjes është ngjashmëria, afërsia dhe njëllojshmëria e këtyre shkronjave me nunin me sukun (të pavokalizuar) dhe tenvinit.

1. Se është i njëjtë me shkronjën **ن** - n ;
2. Se është i përngjashëm me shkronjën **م** - m, si në vendartikulim, si në hundorëzim, si në të gjitha cilësitë tjera;

3. Se është i përafërt me shkronjën **و** - v dhe **ي** - j, si nga vendartikulimi, si nga cilësitë.

Shenja e Idgamit në Mus'haf është vendosja e teshtidit mbi shkronjë.

Është kusht te idgami që shkronjat e idgamit të jenë në fjalë të ndryshme, që do të thotë: nëse këto shkronja janë brenda fjalës ku është nuni me sukun nuk bëhet idgam siç është rasti në mes të fjalës, por është vaxhib (e domosdoshme) të këndohet nuni me sukun rrjedhshëm, dhe quhet Idhhar asnjënës (qartësi e plotë). Pra, Idhhar asnjanës (mutlak) P.sh.:

بُنْيَان ، قنوان ، سنوان ، دُنْيَا

P.sh. po të bëhej Idgami në fjalën **سنوان** do të merrte kuptimin **سوان** e që ka krejt domethënie tjetër.

Ky lloj i Idhharit quhet Idhhar asnjanës për arsye se kemi katër lloje të Idhharit dhe për të dalluar prej tyre. Llojet e Idhharit janë:

1. Idhhari Halkij (Fytor);
2. Idhhari Kamerij (Hënor);
3. Idhhari Shefevij (Buzor) dhe
4. Idhhari Mutllak (Asnjanës).

Shenja e këtij lloji të Idhharit është se shkronja **ن** me sukun dhe shkronja **و** ose **ى** janë në trup të fjalës shenja e Idhharit asnjanës nuk është **ن** elipsoide, por plotësisht ◌ْ e rrumbullakët.

Në Kur'an ekzistojnë dy raste ku dijetarët kanë dhënë dy mendime:

1. Dijetarët të cilët mendojnë se bëhet idgam si në rastet tjera;
2. Dijetarët të cilët mendojnë se nuk bëhet idgam, por idhhar, duke u arsyetuar se " **س** " dhe " **ن** " janë shkronja të alfabetit të cilat edhe pse mund të ngjiten me ajetin vijues ato konsiderohen sikur të ishim ndalur e pastaj të vazhdojmë. Këto dy raste janë:

ياسين (1) وَالْقُرْءَانِ الْحَكِيمِ (2)
ن وَ الْقَلَمِ وَ مَا يَسْطُرُونَ (2)

Sipas mendimit të parë lexohet:
Jasiiii**n**. vel Kur'anil Hakimë.
Nuuuu**n** – vel Kalemi ve ma jesturunë.

Sipas mendimit të dytë lexohet:
Jasiiii**v** vel Kur'anil hakim.
Nuuuu**v** vel kalemi ve ma jesturunë.

2. b) IDGAMI BILA GUNEH - ASGJËSIMI BASHKËNGJITJA E ÇHUNDËRZUAR (GOJOR)

Kur në fund të fjalës ndodhet nuni me sukun apo tenvini dhe menjëherë në fillim të fjalës tjetër njëra nga bashkëtingëlloret (ل dhe ر), atëherë bëhet depërtimi, shkrirja dhe bashkëngjitja në shkronjën paraprake.

Kjo shkrirje dhe bashkëngjitje quhet Idgamu bila guneh, që do të thotë shkrirje e plotë dhe pa mbetjen e pjesshme të nunit me sukun apo teminit, por bëhet plotësisht "ل" e dyfishuar (me teshtid), respektivisht " ر " e dyfishuar (me teshtid). P.sh.:

مِن رَبِّكَ ← مِرْ رَبِّكَ ← مِرَّبِّكَ
مِن لَدُنْ ← مِلْ لَدُنْ ← مِلَّدُنْ
مِن رَبِّهِمْ ← مِرْ رَبِّهِمْ ← مِرَّبِّهِمْ
هُدًا لِلْمُتَّقِينَ ← هُدَلْ لِلْمُتَّقِينَ ← هُدَلِّلْمُتَّقِينَ
ثَمَرَتٍ رِزْقًا ← ثَمَرَتِرْ رِزْقًا ← ثَمَرَتِرِّزْقًا
غَفُورٌ رَحِيمٌ ← غَفُورُرْ رَحِيمٌ ← غَفُورُ رَّحِيمٌ

Ky Idgam është i plotë, që do të thotë: Humbet karakteri hundor i shkronjës dhe ruhet karakteri gojor i shkronjës pasuese.

Ky idgam është i plotë.

Për dallim nga idgamu meal guneh, ky idgam nuk mbahet sa dy vokale, por më shkurt, pra sa një vokal.

Është kusht te Idgami bila guneh që shkronjat të jenë në fjalë të ndryshme që do të thotë – nëse këto shkronja janë brenda fjalës ku është nuni me sukun nuk bëhet idgam, por bëhet idhharë i plotë.

Sikurse te Idgami mealgune edhe te Idgami bilagune shkak i bashkëngjitjes është ngjashmëria, afërsia dhe njëllojshmëria e këtyre dy shkronjave me nunin me sukun (të pavokalizuar) dhe tenvinin.

Përfundim:

Idgami është dy llojësh:

1. Idgami mealgune (Idgami i hundorëzuar);
2. Idgami bilagune (Idgami i johundor).

Përpos kësaj kemi edhe ndarjen tjetër, i cili është dy llojesh:

1. Idgami Kamil (I plotë);
2. Idgami Nakis (Jo i plotë).

3. IKLABI – SHNDËRRIMI, TJETËRSIMI DISIMILIMI

IKLAB do të thotë shndërrim apo konvertim.

Shkronja e cila e shkakton IKLABIN është shkronja ب pas nunit me sukun apo tenvinit.

Pra, kur pas nunit me sukun apo tenvinit vjen shkronja ب, bëhet shndërrimi i nunit me sukun në shkronjën م dhe quhet IKLAB.

Shndërrimi i sukunit dhe tenvinit në shkronjën م, pastaj edhe fshehja me hundorëzim është vaxhib.

Për ta shndërruar shkronjën ب në م nevojiten tutre hapa të njëpasnjëshëm:

1. Shndërrimi i nunit me sukun apo tenvinit në م të plotë në të shqiptuar, jo në të shkruar.

2. Shkronjën م të shndërruar para shkronjës ب të fshihet duke i lënë buzët e çelura pak.
3. Të formohet tingulli hundor (guneh) deri sa është duke u fshehur shkronja م , sepse cilësi e shkronjës م është tingulli gjysmë hundor (guneh), pastaj plotësisht plotësisht të bashkohen buzët në shqiptimin e shkronjës ب .

Për dallim nga Idgamu meal guneh dhe Idgamu bila guneh, Idgami bëhet edhe në një fjalë, por edhe në lidhje të dy fjalëve, pra në trup të fjalës dhe në kufirin në mes dy fjalëve. P.sh.:

- Në trup të fjalës **أَنبِئْهُمْ**
- Në kufirin mes dy fjalëve **شَهَادَاتٍ بِاللهِ ـ مِن بَعْدِ**

IKLABI mbahet (tingëllon) sa dy vokale dhe bëhet me zërim hundor (meal guneh). P.sh.:

شَهَادَاتِ بِالله ، لَنَسْفَعَا بِالنَّاصِيَة ، زوجٍ بهيج ، وَ أَمَّا مَنْ بَخِلَ ، أَنْ بُورِكَ ، سَمِيعٌ بَصِيرٌ.

أَنبَاكَ هَذَا ، أَنبِؤُونِى ، أَنبورك ، آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ ، صُمٌّ بُكْمٌ

Shkak i iklabit: Afërsia e shkronjës ن dhe tenvinit me shkronjën ب .

Shkaku tjetër: është ajo se, vetëm me një angazhim dhe përpjekje të vogël mund të shndërrohet ن dhe tenvini në م , e pastaj me një përpjekje të vogël bëhet fshehja se sa po të bëhej *shqiptimi i qartë* (Idhhar) apo bashkëngjitje (Idgam).

Shkak tjetër: Sepse është vështirë të bëhet bashkëngjitje (Idgam), që do të thotë se prej ن me sukun të kalohet drejtpërsëdrejti në shkronjën ب , po ashtu është vështirë të këndohet rrjedhshëm (Idhhar), sepse ن me sukun artikulohet me gjuhë dhe me prekje të qiellzës, ndërsa shkronja ب me bashkimin e buzëve. Për këtë arsye shndërrohet në م , pastaj shkronja م fshihet para ب , sepse atëherë bëhen të përafërta.

Shenja e Iklabit është të vendosurit e shkronjës (ِ) të vogël mbi shkronjën ن ose paralel me tenvinin (n) , me fjalë tjera zëvendësm të njërës vokal të tendinit.

Fusnotë:
Në gjuhën shqipe ndodhë shndërrimi i një shkronje në një shkronjë tjetër siç është rasti: vnerë – vrerë; rënë – rërë.

4. IHFAJA - FSHEHTËSIMI

IHFA do të thotë fshehje.

Kur pas nunit me sukun apo tenvinit ndodhet njëra prej 15 shkronjave (ت ث ج د ذ ز س ش ص ض ط ظ ف ق ك), atëherë bëhet fshehja e nunit me sukun ose e tenvinit dhe quhet IHFA.

Në rastin e Ihfasë, nuni me sukun nuk asimilohet, as nuk asgjësohet, as nuk shkrihet, as nuk shndërrohet në ndonjë shkronjë tjetër, por mbahet në vetvete e fshehur dhe duke lëshuar tingull.

Pas shkronjave të Idh-harit, idgamit dhe shkronjës së iklabit, 15 shkronjat e Ihfasë shkaktojnë Ihfanë.

Shkaku
– nuni me sukun nuk është i përafërt në artikulim sikurse shkronjat e Idgamit, por edhe nuk janë shumë të largëta në vendartikulim sikurse shkronjat e idh-harit, prandaj as nuk shkrihet (si në Idgam), por as nuk shqiptohet shumë rrjedhshëm si në Idh-har. Për këtë arsye çdo shkronjë e Ihfasë sa më shumë i afrohet nunit me sukun, i afrohet Idgamit, ndërsa sa më shumë i largohet nunit me sukun, i afrohet idh-harit.

Mënyra
– Të shqiptuarit e nunit me sukun dhe të tenvinit:
1. As Idgam (shkrirje), as Idh-har (shqiptim i plotë), por shqiptim duke e ruajtur edhe shkronjën, edhe cilësinë e shkronjës, pra humbja e shqiptimit të shkronjës, e jo cilësisë.

2. Nuni nuk mbështetet fort në gjuhë siç duhet dhe si e ka vendin.
3. Të mos bëhet nuni si me teshtid.

Ihfaja e nunit me sukun apo tenvinit mbahet dy vokale.

IHFAJA (fshehtësimi) është tri llojesh:

- **Ihfaja e shkallës më të lartë,** ku bëjnë pjesë shkronjat: د ط dhe ت . Këto shkronja janë më të afërta me nunin me sukun dhe tenvinin për këtë arsye edhe shkalla është më e larta.

- **Ihfaja e shkallës së ultë,** ku bëjnë pjesë shkronjat ق dhe ك . Këto shkronja janë më të largëta me nunin me sukun dhe tenvinin.

- **Ihfaja e shkallës së mesme,** ku bëjnë pjesë 11 shkronja tjera të cilat as nuk janë shumë të largëta, as nuk janë shumë të afërta.

Ihfaja vjen në 45 raste të cilat përsëriten, sepse 15 shkronja në tre raste është e barabart me 45 raste.

الحرف	مع النون الساكنة فى كلمة	مع النون الساكنة فى كلمتين	بعد التنوين
الصاد	(ينصرون)	(من صلصال)	(ريحا صرصرا)
الذال	(ء أنذرتهم)	(من ذا الذى)	(سراعا ذلك)
الثاء	(منثورا)	(من ثمرة)	(تمهيدا ثم يطمع)
الكاف	(منكم)	(من كان)	(رزق كريم)
الجيم	(ننجى)	(من جاء)	(فصبر جميل)
الشين	(إنشاءا)	(من شاء)	(علم شيئا)
القاف	(ينقضون)	(من قبل)	(ثمنا قليلا)
السين	(منسأته)	(من سوء)	(عابدات سائحات)
الدال	(أندادا)	(من دابة)	(قنون دانية)
الطاء	(ينطقون)	(من طيبات)	(حلالا طيبا)
الزاي	(ينزفون)	(فإنزللتم)	(يومئذ زرقا)
الفاء	(الأنفال)	(و إن فاتكم)	(سوء فاسقين)
التاء	(أنت)	(من تاب)	(جنات تجرى)
الضاد	(منضود)	(من ضل)	(مسجدا ضرارا)

الظاء	(ينظرون)	(من ظلم)	(قوم ظلموا)

Ihfaja e nunit me sukun quhet Ihfa e vërtetë, sepse fshehet plotësisht në krahasim me Ihfatë e rasteve tjera. Pra, nuk është Ihfa buzore, gjithashtu humbet shkronja ن - n me sukun në tërësi dhe i mbetet vetëm hundorëzimi, i cili e tregon atë, po ashtu kjo Ihfa bëhet në trup të fjalës dhe në kufirin mes dy fjalëve, ndërsa Idgami me dy llojet e tij bëhet vetëm në kufirin mes dy fjalëve.

Quhet Ihfa e plotë sepse për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët.

- Ihfaja është mes i Idgamit dhe Idhharit, pra as nuk shqiptohet rrjedhshëm në tërësi, e as nuk humbet dhe shkrihet në tërësi.

Shenja e Ihfasë në Mus'haf - Kur nuni nuk ka kurrfarë shenje që do të thotë është e zhveshur prej çfarëdo shenje tregon se duhet të bëhet Ihfa (fshihet). Tenvinat pa teshtid tregojnë se bëhet Ihfa.

Shumica gabojnë atëherë kur duhet të këndohet rrjedhshëm nuk e këndojnë rrjedhshëm, kur duhet të bëhet Ihfa nuk e bëjnë Ihfa dhe kur duhet të bëhet Idgam nuk e bëjnë Idgam.

DALLIMI MES IHFASË DHE IDGAMIT

Ekziston dallimi mes Ihfasë (fshehjes) dhe Idgamit bashkëngjitjes për shkaqet në vijim:

1. IHFAJA nuk ka teshtid, ndërsa IDGAMI kur të jetë i plotë është si me teshtid.
2. IHFAJA është në vetë shkronjën e fshehur. Ndërsa IDGAMI kalon në shkronjën paraprake, për këtë arsye thuhet është fshehur shkronja (te Ihfaja) para shkronjës " د ", ndërsa te IDGAMI thuhet shkronja " ن " iu ka bashkangjitur dhe është shkrirë në shkronjën " ل ".
3. IHFAJA bëhet brenda fjalës dhe në mes të dy fjalëve, jo brenda fjalës, ndërsa IDGAMI bëhet vetëm në mes të dy fjalëve, jo brenda fjalës.

Vërejtje:

* Duhet pasur kujdes që gjuha të mos e prekë qiellzën me rastin e Ihfasë së "nunit".
* Duhet pasur kujdes që gjatë fshehjes të mos kalohet në zgjatim të shkronjës. P.sh. كُنتُمْ të këndohet كُونتُمْ , apo مِنكُمْ të këndohet مِينكُمْ .
* Të bëhet dallimi i ihfasë para shkronjës ق dhe ك , dhe para ت ، د dhe ط , që do të thotë se te shkronja më e rëndë (f.v. ق dhe ط) të bëhet me fshehtësuese se sa te shkronjat e lehta د ، ك dhe ت e kështu me radhë.

DALLIMI MES NUNIT ME SUKUN DHE TENVINIT

Tenvini do të thotë dyfishim i zanoreve, pra dy fet-ha, dy dame ose dy kesre, ndërsa nuni me sukun është bashkëtingëllore e jodyfishuar.

Pesë çështje dallojnë nunin me sukun prej tenvinit:

E Para: Nuni me sukun është shkronjë rrënjësore prej shkronjave të alfabetit, ndërsa tenvini është shkronjë (shenjë) shtesë.

E dyta: Nuni me sukun është i vendosur edhe në të theksuar dhe në të shkruar, ndërsa tenvini është i vendosur në të theksuar, e jo në të shkruar.

E treta: Nuni me sukun theksohet në të ndalur dhe në të vazhduar të leximit, ndërsa tenvini theksohet në të vazhduar kurse humbet në të ndalur të leximit.

E katërta: Nuni me sukun vendoset në emra, folje, pjesëza dhe fjalë ndihmëse, ndërsa tenvini vendoset vetëm në emra, dhe

E pesta: Nuni me sukun vendoset edhe në mes edhe në fund të fjalës, ndërsa tenvini vendoset vetëm në fund të fjalës.

RREGULLAT E MIMIT ME SUKUN

Rahave	Tevessut	Istifal	Infitah	Idhlakë
Haptësuese	Mesatare	Zëultësuese	Shkëputëse	Rrëshqitëse

Mimi me sukun quhet mimi i pavokalizuar i cili sukun mbetet si në të vazhduar të leximit si në të ndalurit, i cili është rrënjësor ose shtesë, i cili vjen në trup të fjalës dhe në trup të fjalës.

- Pra, mimi me sukun i cili nuk është i teshtidit si p.sh. **لَمَّا** as i vokalizuar si p.sh. **مَقَالِيد** , as vokalizimi arid (i paraqitjes së rastit) si p.sh. **قُمِ اللَّيْلَ ، أَمِ ارْتَابُوا** , as sukuni (pavokalizimi) për shkak të ndaljes, si p.sh. **عَلِيمٌ حَكِيمٌ** .

Sukun do të thotë i qetë, i palëvizshëm i pavokalizuar, i pushuar.
Sikurse nuni me sukun apo tenvini që i nënshtrohen disa rregullave para shkronjave tjera, ashtu edhe mimi me sukun (مْ) ka tri rregulla:

1. **IHFA** – Të fshehurit e shqiptimit të saj.

Kur pas shkronjës " مْ " me sukun vjen shkronja " ب " , atëherë " م " (mijmi) fshihet dhe quhet Ihfa buzore.
Ihfaja e mimit bëhet vetëm në kufirin mes dy fjalëve dhe asnjëherë nuk bëhet në trup të fjalës.

Shembuj të Ihfasë së م para ب:

فاْ حْـكُم بَيْنَهُمْ ، وَ هُم بَارزونَ ، إِلَيْهم بهديةٍ ، وَ ان احكم بَيْنَهُمْ ، رَب احكم با لحق ، ام بظاهر من القول ، اذ انتم با لعدوة القصوى ، وَ مَا أَنَاْ عَلَيْكُم بوَكِيلٍ ، فعاقبوا بمثل مَا عُوقِبْتُم بِهِ ، يَخْشَوْنَ رَبَّهُم بِا لْغَيْبِ ، ان رَبّهم بهم ، تنبئهم بِمَا ، لا قِبَلَ لَهُمْ بِهَا ، مَا لَهُمْ بِهِ . هُمْ بِهِ مُؤْمِنُونَ . إِلَيْهِمْ بِهَدِيَة . مُبْتَلِيكُمْ بِنَهَرٍ . فَهَزَمُوهُمْ بِإِذْنِ الله . ءَامَنتُمْ بِالله . كُنتُمْ بِآيَاتِهِ مُؤْمِنُونَ . يومهمْ بارزون . يعتصمْ باللهِ . وَ مَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ . إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ . كَلْبُهُمْ بَاسِطٌ . عليهمْ بنيانا . وَ نبلوكمْ با لشَّرِّ . كُنتُمْ بِهِ .

Shkaku i Ihfasë është se shkronja م - m dhe ب - b janë të përngjashme edhe për nga vendartikulimi edhe për nga cilësitë.

Ihfaja bëhet vetëm kur të jenë shkronja م në fund të fjalës së parë, ndërsa shkronja në fillim të fjalës së dytë.

Quhet Ifha buzore sepse që të dy shkronjat artikulohen prej buzëve për t'u dalluar nga ihfaja e fytit.

Shkronja " نْ " me sukun fshihej para 15 shkronjave, ndërsa " مْ " me sukun fshihet vetëm para shkronjës " ب ".

Shkronja " نْ " është fshehje e vërtetë, ndërsa shkronja " مْ " me sukun nuk mund të quhet fshehje e vërtetë e plotë , për këtë arsye edhe quhet "Ihfa Shefevij" (Fshehje Buzore).

Shenja e saj në mus-haf është mosshënimi i shenjës " ◌ْ - sukunit" mbi shkronjën .

Disa e lejojnë që të këndohet qartë edhe para " ب " .

2. **IDGAMI –** Depërtimi dhe bashkëngjitja e saj.

Kur shkronja " م " e vokalizuar vjen pas shkronjës " م " të pavokalizuar, atëherë paraqitet nevoja e bashkëngjitjes së vogël e që quhet Idgami Sagirë.
P.sh.:

خَلَقَ لَكُم مَّا فِى لأَرْضِ ، إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ، كَم مِّنْ ، وَ مِنْ هُم مَّنْ ءَامَنَ ، مَعَكُم مُّتربصونَ ، وَ مَا هُم مِّنكُمْ ، وَ هُم مُّعْرِضُونَ ، أَتَاهُم مِّن فَضْلِهِ ، أَم مَّنْ أَسس بُنْيَانَهُ ، أَم مَّنْ خَلَقْنَا ، ام مّن يَأْتِى امنا ، ام مّن يَكُون عَلَيْهِمْ وَكِيلًا ، وَ مِنْ هُم مَّنْ عَاهد الله ، لَهُم مَّغْفِرَة ، وَ كُنتُم منهم تَضْحَكُونَ ، سنستدرجهم من حيث لا يَعْلَمُونَ ، إِنكُنتُم مُّؤْمِنِينَ ، وَ يُعَلِّمُكُمْ مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ . وَ هُمْ مُّهْتَدُونَ .

Disa dijetarë e quajnë edhe Idgamu bigune:

كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ . وَ لَكُمْ مَّا كَسَبْتُمْ . يَعِدُكُمْ مَّغْفِرَة

Ndryshe edhe quhet Idgam mithlejn sagirë (Idgam i vogël i shkronjave të njëjta).
Quhet Idgam i vogël për arsye se nuk ka ndonjë vështirësi për t'i bashkëngjitur dhe për t'i bërë si me teshtid.

3. **IDHHAR** – Shqiptimi i qartë i saj.

Kur të gjitha shkronjat tjera pos shkronjës " **ب** " dhe shkronjës " **م** " vijnë pas shkronjës " **م** " të pavokalizuar është e domosdoshme (vaxhib) që " **م** " të shqiptohet rrjedhshëm dhe quhet Idhhar shefevij (Shqiptim i qartë buzor).

Quhet Idhhar Shefevij (Shqiptim i qartë buzor), sepse 26 shkronjat tjera, disa janë: gjuhore, disa janë fytore, disa janë grykore dhe buzore, të gjitha janë shumë të largëta për nga vendartikulimi, për këtë arsye duhet të qartësohet artikulimi me buzë.

Po ashtu quhet Idhhar Shefevij për arsye se shqiptimi i qartë i shkronjës "**ن** - n" para shkronjave fytore quhet Idhhar Halkij (qartësi fytore).

Pra, shkronja " **م** " është e largët edhe për nga vendartikulimi, por edhe për nga cilësia me këto shkronja, përpos shkronjës **ب** dhe **م** .

Idhhari më i forti i mimit me sukun duhet të jetë idhhari para shkronjës **ف** dhe **و** , sepse kanë afërsi.

Nëse themi se edhe shkronja **ف** është buzore, arsyetimi është se shkronja **ف** është shkronjë e dobët buzore, ndërsa **م** është shkronjë e fortë buzore, kurse rregull është që e forta të mos iu bashkëngjitet të dobëtës .

Po ashtu shkronja **م** e pavokalizuar nuk i bashkëngjitet shkronjës **و** që të mos ngatërrohet te dëgjuesi me Idgamin e nunit me sukun. Për këtë arsye edhe para shkronjës duhet të bëhet Idhhar i fortë, d.m.th. shqiptim i qartë shumë i fortë.

غَيْرِ ٱلْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَ لا ٱلضَّآلِّينَ .

Kur të bëhet Idhhari i mimit (**مْ**) para shkronjës **ف** duhet kujdesur që të mos bëhet ndërprerje (sekte). Mbahet dy vokale.

Idhhari Shefevij i mimit bëhet si në trup të fjalës ashtu edhe në kufirin mes dy fjalëve, sepse Idhhari i tij është vaxhib.

Ajeti 19, suretu Jasin është shembull tipik, i cili në vete përfshinë rregullat e " **م** " i idhharin, Ihfanë dhe Idgamin.

قَالُوا طَائِرُكُمْ مَعَكُمْ أَإِنْ ذُكِّرْتُم بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ مُسْرِفُونَ

Idhhar Ihfa Idhhar Idgam

Idhhari bëhet pa marrë parasysh se, a është shkronja **م** me shkronjat tjera në një fjalë apo në dy fjalë:

ء ا – طمْآن ، أَمْ أَمنتُمْ ، إِلَاهُكُمْ إِلَاهٌ وَاحِدٌ ، لَهُمْ أَعْيُنٌ .

ت - يَمْتَرُونَ ، سلَّمْتم ، وَ لا امتا ، كنتم تفرحون ، أَمْ تَقُلُونَ .

ث - أَمْثَالكُمْ ، تمتعوا فِى داركم ثَلاثَة أَيَّامٍ ، مرجعكم ثم ،
ج - و اولئكم جعلنا، ان لَهُمْ جَنَّات، اضل منكم جبلا, وَ مَا جَعَلْنَاهُمْ جَسَدًا
ح - يَمْحَقُ اللهُ الرِّبَا ، يمح الله البطل ام حسبتم ، أَوْ تَأْتِيهِم حيتانهم
خ - أَمْ خلقُوا ، أَهُمْ خَيْرٌ ، وَ جَعَلْنَاهُمْ خَلائف ، من بعدهم خلف ،
أُوْلَـئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّة
د - الْحَمْدُ للّهِ ، وَ امددناهم ، وَ هُمْ داخرون ، عَلَى صَلاتِهِمْ دَآءِمُونَ ،
لَكُمْ دِينُكُمْ و
ذ - من ظهورهم ذزيتهم ، فَقُلْ رَبُّكُمْ ذُو رَحْمَةٍ ، ترهقهم ذلة ، الم ذَالكَ ،
أَوْ ظَلَمُوا أَنفُسَهُمْ ذكروا الله
ر - أَمْرًا ، ربكم رب السماوات و الأرض
ز - إلا رمزا ، أم زاغت
س - تمسون ، فوقكم سبع طرائق
ش - أَمْشَاج ، لهم شراب من حميم
ص - وَ هُمْ صَاغرون
ض - وامضوا
ط - وَ أَمْطَرْنَا ، مسهم طائف
ظ - وَ هُمْ ظَالِمُون
ع - أمعاءهم ، و هم عن اللغو
غ - فَإِنَّهُمْ غير مَلُومِين
ف - و هم فرحون
ق - بل هم قوم يعدلون
ك - فيمكث ، إليكم كتابا
ل - و أملى ، أَمْ لَهُمْ
ن - يمنى ، مستهم نفحة
ه - يمهدون
و - أَمْوَات ، حسابهم وهم
ي - عمى ، أم يريدون .

Shkaku i Idhharit të م para 26 shkronjave për shkak të largësisë së tyre në vendartikulim, sepse vendartikulimi i shkronjës م - m janë buzët, ndërsa

vendartikulimet e shkronjave tjera ose fyti (fillimi, mesi dhe fundi) ose gjuha (fillimi, mesi dhe anësoret, dhe maja)

Idhhari Shefevij vjen 44 raste, sepse 26 shkronja prej tyre 18 shkronja vijnë në trup të fjalës dhe në kufirin mes dy fjalëve, që do të thotë 36 raste, dhe 8 shkronja nuk vijnë me shkronjën **م** - m në trup të fjalës, por vetëm në kufirin mes dy fjalëve.

Vërejtje:

Shkronja " **م** " dhe shkronjat "**و** dhe **ف** " janë shkronja të përafërta (mutekaribani, mutegjanisani).

Mundet që lexuesit, pa dëshirën e tij, t'i shkojë goja dhe të bëjë Ihfanë e mimit (**م**) te shkronjat "**و** dhe **ف** ", kështu që dëgjuesi të mendojë se është Ihfa, sikurse fshihet shkronja **ن** para tyre. Për këtë arsye dijetarët e kanë bërë vaxhib që, posaçërisht tek këto dy shkronja (**و** dhe **ف**) t'u kushtohet rëndësi të posaçme në Idhharin e shkronjës " **م** " para këtyre dy shkronjave.

Ashtu sikurse shkronja " **م** " nuk fshihet, as nuk bëhet Idgamë në këto dy shkronja edhe pse e kanë një vendartikulim, por për të dalluar Idgamin e **ن** para shkronjës **و** që dëgjuesi të mos mendojë se ka qenë "**ن** " para Idgamit, por " **م** - m ".

Po ashtu, nuk bëhet Idgami në shkronjën " **ف** ", sepse shkronja " **م** " është e fuqishme, e fortë, ndërsa shkronja " **ف** " është e dobët dhe rregull është që e fuqishmja të mos bashkëngjitet në të dobëtën.

RREGULLAT E MIMIT DHE NUNIT ME TESHTID

Në esencë teshtidi nuk e lejon Idgamin dhe gunen, formimin e tingullit me zgavër hundore.

Teshtidi mundet me qenë:

- i rrënjës së fjalës,
- i bashkëngjitjes së shkronjave për shkak të ndonjë rregulli.

Për dallim nga shkronjat tjera mimi “ م ” dhe nuni “ ن ” me teshtid ndryshojnë se:

- Vaxhib është tngullimi hundor dhe mbajtja e tyre në gjatësi prej dy vokaleve:

أَنَّ . أَنَّ . كَأَنَّ . ثُمَّ . ثَمَّ . يَتِمُّ .

- Formimi i tingullit hundor (gune) mundet me qenë në brendi të fjalës.

ٱلْجَنَّةَ . إِنَّ . ثُمَّ . يمٌّ .

- Në rast bashkimi të dy fjalëve kur shkronja e fundit e fjalës parë është e njëjtë me të parën shkronjë të fjalës së dytë:

Është e shkruar **وَ لَكُم مَّا كَسَبْتُمْ** **مِن نَّاصِرِينَ**

Lexohet **وَ لَكُمَّا كَسَبْتُمْ** **مِنَّاصِرِينَ**

(dy vokale) (dy vokale)

وَ مِنَ النَّاسِ . أَلا إِنَّهُمْ . فَأَمَّا مَنْ أَعْطَا . أكلا لَمَّا .
قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ . مَلِكِ النَّسِ . إِلَـهِ النَّسِ .
فَأَمَّـا مَنْ ثَـقُلَتْ مَوازِينُهُ فَهُوَ فِى عِيشَةَ رَّاضِيَ .
وَ أَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُمُّهُ هَاوِيَةَ .


أحكام النون الساكنة والتنوين مع حروف الهجاء الـ ٢٨
إظهار حلقى وحروفه (٦)
الهمزة ، الهاء ، العين
الحاء ، الغين ، الخاء
وهى مجموعة فى أوائل كلمات
الجملة التالية :
إن غاب عنى حبيبى همنى حبره
إدغام وحروفه (٦)
الياء ،الراء ،الميم
اللام ،الواو ،النون
وهى مجموعة فى كلمة (يرملون)
إقلاب وله حرف واحد
(الباء)
إخفاء حقيقى وحروفه (١٥)
الصاد ، الذال ، الثاء
الكاف ، الجيم ، الشين
القاف ، السين ، الدال
الطاء ، الزاى ، الفاء
التاء ، الضاد ، الظاء
وهذه الحروف مجموعة فى
أوائل كلمات هذا البيت :
صف ذا ثنا كم جاد شخص قد سما
دم طيبا زد فى تقى ضع ظالما
إدغام بغير غنة وحروفه (٢)
الراء ، اللام
وهما مجموعتان فى كلمة (رل)
إدغام بغنة وحروفه (٤)
ينمو
من كلمة واحدة فلا تدغم لحرفى
الياء ، الواو
ويسمى : إظهارا مطلقا
مثل : دنيا ، بنيان ، صنوان ، قنوان
من كلمتين للحروف الأربعة
الياء ، النون ، الميم ، الواو

KAPITULLI I TETË

RAPORTET E SHKRONJAVE MES VETE

1. MUTEMATHILEJN – SHKRONJAT E NJËJTA

Mutemathilejn do të thotë i njëjtë në emërtim, në të shkruar, në të shqiptuar, në cilësi dhe në çdo aspekt. Pra, kur dy shkronja janë të njëjta edhe në emërtim edhe në artikulim, edhe në cilësi, si p.sh.: dy **ب** ; dy **ت** ; dy **ث** ; dy **د**, e kështu me radhë.

Kjo bashkëngjitje është dy llojesh:

E para: Idgam mithlejn sagirë meal gune (Bashkëngjitja e shkronjës së njëjtë me vetshkronjën e njëjtë me tingull hundor. Ky lloj bashkëngjitje vjen te dy shkronja (**ن** dhe **م**) dhe vetëm kufirin mes dy fjalëve dhe asnjëherë nuk bëhet në trup të fjalës. P.sh.:

يَخْرُجُهُمْ مِّنْ * أَن نَّشَأْ

E dyta: Idgamu mithlejn bila gune (Bashkëngjitja e shkronjës me vetshkronjën pa hundërzim.

Ky lloj bashkëngjitje vjen te të gjitha shkronjat tjera në kufirin mes fjalëve dhe në trup të fjalës. P.sh.:

1. Në kufirin mes fjalëve – **هَل لَّكُمْ**
2. Në trup të fjalës – **يُدْرِكُّمُ الْمَوْتُ**

Idgami i vetshkronjës është vaxhib.

Idgami (bashkëngjitja) e vetshkronjave nuk bëhet në dy raste:

1. Kur bëhet sekte (pauzë - jofrymëmarrje) pasi që vetë pauza (sekteja) e ndanë shqiptimin e shkronjës prej vetë shkronjës tjetër:

مَا لِيهْ هَلَكَ *

- Shkronja " **ه** " e fjalës bashkëngjitet me " **ه** " e fjalës së dytë, kjo nëse bëhet ndërprerje (pazë) e zërit, e jo ndërprerja e frymëmarrjes.
- Nëse nuk bëhet ndërprerja (pauza) e zërit në kufirin mes këtyre dy fjalëve, atëherë bëhet bashkëngjitja (idgamë).

Që të dyja mënyrat janë të lejuara sipas Kiraetit të Hafsës.

2. Kur shkronja është zanore e gjatë, ndërsa vetshkronja në fjalën tjetër është e vokalizuar. Kjo nga arsyeja e mos-humbjes së zgjatimit (meditabisë), i cili është vaxhib. P.sh.:

قَالُوا وَ هُمْ فِى يَوْمٍ *

- Po të bëhej bashkëngjitje atëherë zanorja e gjatë do të humbte dhe do të shndërrohej në zanore të shkurtë.

Shkronjat e njëjta kanë tri rregulla, e ato janë:

RREGULLAT E SHKRONJAVE TË NJËJTA

Shkronjat e njëjta i kanë tri rregulla, e ato janë:

1. **Bashkëngjitja e vogël;**
2. **Jobashkëngjitja e madhe;**
3. **Të njëjtat asnjanëse (neutrale).**

Shkronjat e njëjta mund të vijnë apo mund të takohen njëra me tjetrën në tri mënyra:

MËNYRA E PARË – Kur dy shkronja të njëjta takohen njëra me tjetrën dhe e para është me sukun e dyta me vokale, si p.sh.:

وَ لا بغتب بعضكم
هل لكم

MËNYRA E DYTË – Kur dy shkronja të njëjta takohen me njëra tjetrën dhe që të dyja janë të vokalizuara, si p.sh.:

انه هو

MËNYRA E TRETË – Kur dy shkronja të njëjta takohen me njëra tjetrën dhe e para është e vokalizuar, ndërsa e dyta me sukun, pra e kundërta e të parës. P.sh.:

انا نذير تَتْرى

Nga vetë mënyra e takimit të shkronjave të njëjta njëra me tjetrën, shkronjat e njëjta janë tri llojesh:

1. MUTEMATHILANI SAGIRË (I VOGËL);

2. MUTEMATHILANI KEBIRË (I MADH);
3. MUTEMATHILANI MUTLAK (ASNJANËSE).

1. BASHKËNGJITJA E VOGËL

– Kur dy shkronja të njëjta vijnë njëra pas tjetrës: e para me sukun (e pavokalizuar), ndërsa e dyta e vokalizuar, atëherë bëhet bashkëngjitja e vogël (Sagirë). P.sh.:

إِذهب بِّكِتَبِى هـذا . هَلْ لَّكَ . اضرب بعصاك ، بل لا يخافون
و قد دخلوا ، اذ ذهب مغاضبا ، قُلْ لَوْ كَانَ ، رَبِحَت تِّجَارَتُهُمْ
قُلْ لَوْ انتُمْ ، قُلْ لا اسألكم ، قُلْ لكم ميعاد
قُلْ لا يعلم ، هل لكم من مَا ملكت ،
فقل هل لك ، بل لا يخافون ، وَ هُم مِّنْ ، عَن نَّفْسِى
يُدْرِكْكُمْ ، يوجهْهُ ، ان نشأ ، يخجُهُم مِّنْ

Quhet bashkëngjitje e vogël (e lehtë) për arsye se, pasi që e para është me sukun (e pavokalizuar), ndërsa tjetra e vokalizuar me një përpjekje shumë të vogël bëhet bashkëngjitja e tyre.

Bashkënjgjitja bëhet edhe kur dy shkronjat e njëjta janë në trup të fjalës, edhe kur janë në kufirin mes dy fjalëve.

2. JOBASHKËNJGITJA E MADHE (KEBIRE)

Kur shkronjat e njëjta ndodhen pranë njëra-tjetrës dhe që të dyja janë të vokalizuara, atëherë këndohen rrjedhshëm dhe qartë e që quhet KEBIR. Kjo ndodhë në 17 shkronja, e ato janë:
P.sh.:

1 - التاب بالحق
2 - الموتُ يحسونهما
3 - حَيْثُ ثَقِفْتُمُوهُمْ
4 – النكاح حقى
5 – شَهْرُ رَمَضَان
6 – الناس سكارى
7 – يَشْفَعُ عِندَهُ
8 – يَبْتَغِ غَيْرَ
9 – اختلَف فِيهِ
10 – افاق قَالَ
11 – إِنَّكَ كُنْتَ ، مَنَاسِككُمْ
12 – لا قبل لَهُمْ
13 – الرَّحِيمِ مَالِكِ
14 – نَحْنُ نُسَبِّحُ
15 – فَهُوَ وَلِيُّهُمْ
16 – فِيهِ هُدًا ، انه هُوَ
17 – يَأْتِيَ يَوْمٌ

- Vaxhib është Idhhari te të gjithë ekspertët, përpos Susit.

Përjashtim në këtë rregull, pra nuk bëhet idhhar vetëm në dy raste në Kur'an:

1. **تَأْمَنُّا**

Në esencë kjo fjalë është **تَأْمَنُنَا** pra, dy "nuna" të vokalizuara.

Kjo fjalë mund të lexohet në dy mënyra:

- **تَأْمَنَّا** - Revm.
- **تَأْمَنَّا** - Idgami i nunit të parë, pra shkrirja e nunit të parë me Ishmam.

2. **مَكَنِّى**

Në esencë kjo fjalë është **مَكَنَنِى** , pra dy "nuna" të vokalizuara, mirëpo nuni i parë është shkrirë dhe i është bashkëngjitur të dytit, dhe është bërë teshtid.

Shkronja “ و ” dhe zanorja e gjatë “ و ” nuk konsiderohen të njëjta, sepse shkronja “ و ” vendartikulim ka buzët, ndërs zanorja e gjatë “ و ” vendartikulim ka tërë grykën. Pra, nuk janë të njëjta.

Kjo mënyrë vjen në 17 raste. P.sh.:

حَجَجٌ *
فِيهِ هٰذِهِ *
يعلم مَا *

Quhet TË NJËJTAT E MADHE për arsye se shumë vështirë është kalimi nëpër shkronja të njëjta pranë njëra tjetrës të cilat janë të vokalizuara.

3. TË NJËJTAT ASNJANËSE (NEUTRALE)

Kur dy shkronja të njëjta, e para është e vokalizuar, ndërsa e dyta me sukun, quhet e njëjta asnjanëse (neutrale) MUTEMATHILANI MUTLAK dhe që të dyja këndohen rrjedhshëm. P.sh.:

يمسسه * زَلَلْتُمْ *
مانسح * تَمسَسْهُ
و احيينا *
تَتْلُوَ *
تشطُطْ * شققنا *

Në këtë rast vaxhib është Idhhari i shkronjave të njëjta.

LLOJI I PARË – Kur shkronja e parë është me sukun, ndërsa e dyta me vokale, quhet SAGIRË (i vogël) dhe është vaxhib idgami (bashkëngjitja e tyre). Quhet SAGIRË (i vogël) për arsye se për bashkëngjitjen (IDGAMIN) e tyre nuk nevojitet mund i madh, por në të lexuar shumë lehtë me mund të vogël bëhen si me qenë me teshtid. P.sh.:

و من بكرهن * اضرب بعصاك الحجر
يدرككم المْت * رَبِحَت تِجَارَتُهُمْ
وَ قَد دَخَلُوا * وَ هم من
اذ ذَهَبَ * عَن نَفْسٍ
هَل لَكَ * يوحهْهُ
وَ لا بغتب بعضكم *

Nga ky rregull bën përjashtim kur shkronja e parë është e pavokalizuar, por e ka rolin e shkronjës së gjatë, pra nuk bëhet Idgami i tyre. P.sh.:

قَالُوا وَ هُمْ
فِي يُوسُف
الَّذِى يُوَسْوِسُ
آوُوا وَ نصروا

Po ashtu nga ky rregull bën përjashtim një rast i veçantë në Kur'an, kr "**هـ** - H-ja " e parë është me sukun, ndërsa "**هـ** - H-ja " e dytë është e vokalizuar, por bëhet SEKTE (jo ndalim i plotë i këndimit, por ndalim frymëzimi). Ky rast është në Suretul Haka-tun:

ماليه (sekte) **هلك**

MITHLEJN

Lloji	Shart-Kusht	Rregulli	
Mithlani Sagirë	e para me sukun e dyta me vokale	Vaxhib Idgami	**وَقَددَخَلُوا**
Mithlani Kebirë	të dyjat me vokale	Lejohet Idgam dhe Idhhar	**فِيهِ هُدًى . إِنَّهُ هُوَ**
Mutlak	e para me vokale e dyta me sukun.	Vaxhib Idhhari	**تَتْلُوا. زَلَلْتُمْ .**

			تَشطَطْ

2. MUTEKARIBANI - PËRAFËRTAT

- Mutekaribani quhen dy shkronja, të cilat janë të përafërta për nga cilësia dhe vendartikulimi; ose të përafërta për nga vendartikulimi, jo për nga cilësia; ose të përafërta për nga cilësia, jo për nga vendartikulimi.

Pra, janë shkronja të cilat ndryshojnë për nga vendartikulimi, por janë të përafërta, sepse njëra është në fund të një vendartikulimi, ndërsa tjera në fillim të vendartikulimit tjetër.

Pra, vijmë në përfundim se munden me qenë:

a. dy shkronja të përafërta edhe për nga cilësia, edhe për nga vendartikulimi. P.sh. shkronja ل dhe ر .

Këto dy shkronja janë prej anësorëve të gjuhës dhe i kanë të gjitha cilësitë e njëjta, përpos që shkronja ر e ka një cilësi më shumë (shtesë), e ajo cilësi është cilësia e Tikrarit (përsëritjes). Pra:

- shkronja ر artikulohet prej majës së gjuhës;
- shkronja ل artikulohet prej majës anësore të gjuhës.

Nëse bëjmë një vështrim shohim se maja e gjuhës dhe anësori i gjuhës janë të përafërta, vetëm se shkronja ر e ka cilësinë e Tikrarit (përsëritjes).

قُلْ رَبِّ ، بَلْ رَفَعَه

b. dy shkronja, të cilat janë të përafërta për nga vendartikulimi, e jo për nga cilësia. P.sh. shkronja **د** dhe **س**.

الدَّالُ	السِّينُ
حرف مجهور لا مهموس - Haptësuese	**حرف مهموس لا مجهور** - Fshehtësuese
حرف فيه شدة - Fortësuese	**حرف فيه رخاوة** - Çliruese
حرف يقلقل - Tronditësë	**حرف من حروف الصفير** - Fishkëlluese
رف استفال - Zëultësuese	**حرف استفال كالدال** - Zëultësuese
حرف انفتاح - Shkëputëse	**حرف انفتاح كالدال** - Haptësuese

Siç po shihet këto dy shkronja në tri cilësi dallojnë me vete ndërsa në dy cilësi tjera janë të njëjtë.

Shkronja **د** dhe **س** vendartikulohen prej anësorëve të gjuhës, mirëpo **د** artikulohet prej anësorëve dhe fundit të qiellzës së epërme, ndërsa shkronja **س** artikulohet prej anësorëve të gjuhës dhe mes dhëmbëve (pra, prej dhëmbëve të epërm dhe të poshtëm), pra nuk janë të përafërt për nga cilësia.

c. dy shkronja, të cilat janë të përafërta për nga cilësia, e jo për nga vendartikulimi. P.sh. shkronja **س** dhe **ش**.

Shkronja **ش** artikulohet prej mesit të gjuhës dhe qiellzës së epërme, ndërsa **س** artikulohet prej anësorëve të gjuhës dhe mes dhëmbëve (të epërm dhe të poshtëm), pra nuk janë të përafërta për nga vendartikulimi, por janë të përafërta për nga cilësia, sepse secila prej tyre i ka nga 6 cilësi, me pesë prej tyre janë të përbashkëta, e një jo.

Afërsia e cilësisë së shkronjës **ت** dhe **ث**.

التـاء	الثـاء

١ ـ حرف من حروف الشدة	الثاء حرف من حروف الرخاوة .
٢ ـ من صفاتها : الاستفال .	من صفاتها : الاستفال .
٣ ـ من صفاتها : الانفتاح .	من صفاتها : الانفتاح .
٤ ـ من صفاتها : الإصمات .	من صفاتها : الإصمات .
٥ ـ من صفاتها : الهمس .	من صفاتها : الهمس .

Pra, shihet se katër cilësi i kanë të njëjta, ndërsa vetëm në një cilësi dallojnë. Për këtë arsye quhen shkronja të përafërta (Mutekarribani).

LLOJET E SHKRONJAVE MUTEKARIBANI – TË PËRAFËRTA

Llojet e shkronjave Mutekarribani – të përafërta janë:
Lloji i parë:

1. Të përafërta në vendartikulim dhe cilësi, aq afër njëra-tjetrës janë në cilësi, aq sa nuk e kanë vetëm një cilësi të njëjtë, ndërsa të gjitha cilësitë tjera i kanë të njëjta. P.sh. shkronja ل dhe ر .

قُلْ رَبِّ ، بَلْ رَفَعَه

2. Të përafërta në vendartikulim, jo të përafërta në cilësi, që do të thotë se cilësitë i kanë shumë të ndryshme me njëra-tjetrën. P.sh. shkronja د dhe س . Shembull: **قَدْ سَمِعَ اللّٰهُ**

3. Të përafërta në cilësi, ndërsa të largëta për nga vendartikulimi. Sa i përket cilësive ndryshojnë vetëm në një cilësi. P.sh. shkronja ش dhe س .

ذى العرش سبيلا

4. Të përafërta në vendartikulim, ndërsa janë në përputhshmëri në cilësi. P.sh. shkronja ح me shkronjën ه . Shembull: **فَسَبِّحْهُ**

Shkronja م me shkronjën ن . P.sh.:

مِنْهُمْ نَمَارِق

Shkronja و me shkronjën ى (të vokalizuar). P.sh.:

وَ يَوْمَ ، يَوَدُّ

Shkronja و dhe ى (të vokalizuara) me (ا) Elifin. P.sh.:

وال ، يَا قَوم

Nga ajo që thamë më lart, shkronjat e përafërta janë në pesë mënyra:

E para: Kur të jenë të përafërta edhe për nga cilësia edhe për nga vendartikulimi, sikurse shkronja ل me ر ; shkronja ت me ث .

Shkronja ت me shkronjën ث janë të përafërta për nga vendartikulimi, të përafërta për nga cilësitë, por dallojnë vetëm në një cilës, se shkronja ت është Sheditë (fortësuese), ndërsa shkronja ث është Rehave (çliruese).

E dyta: Kur të jenë të përafërta për nga vendartikulimi, ndërsa nuk i kanë cilësitë e njëjta apo të përafërta. P.sh.: shkronja د me س dhe shkronja ض me ر .

E treta: Kur të jenë të përafërta për nga cilësia, por janë të largëta për nga vendartikulii, si: shkronja ك me ث dhe shkronja ل me ر .

E katërta: Kur janë të përafërta për nga vendartikulimi dhe i kanë të gjitha cilësitë e njëjta. P.sh.: shkronja ح me ه dhe shkronja ج me د .

E pesta: Kur janë të largëta për nga vendartikulimi dhe i kanë të gjitha cilësitë e njëjta. P.sh.: shkronja ك dhe ت , shkronja ث me ح , shkronja م me ن , shkronja و me ى , shkronjat و dhe ى me elifin (ا) .

Shkronjat Mutekaribani (e përafërta) janë tri llojesh:

1. MUTEKARIBANI SAGIRË,
2. MUTEKARIBANI KEBIRË,

3. MUTEKARIBANI MUTLAK.

LLoji i parë: Kur shkronja e parë është me sukun, ndërsa pranë saj është shkronja e dytë e përafërt me vokale, quhet **Sagirë**. P.sh.:

ت me **ث** - **أَوْرَثْتُمُوهَا**

ت me **ث** - **يرد ثواب**

Lloji i dytë: Kur dy shkronjat e përafërta janë me vokale quhen **Kebir**. P.sh.:

نفقد ، عدد سنين ، ذى العرش ، سبيلا ، وَ الذَّارِيَاتِ ذَرْوًا
صواع ، مِنْ بَعْدِ ضرآء

Bëhet Idhharë (shqiptimi i qartë) i shkronjave.

Lloji i tretë: Kur shkronja e parë është me vokale, ndërsa e dyta e përafërt me sukun quhet **asnjanëse** (mutlak).

لَنْ ، إِلَيْكَ ، عَلَيْكَ ، لَدَيْكَ

Sipas tarikut Hirzit për rastet në vijim bëhet Idgam:

قُلْ رَبِّ
بَلْ رَفَعَهُ
قُلْ رَبِ إِمَّا تُرِيَنِّى
وَ قُل رَبِّ أَعُوذُ بِكَ
قُل رَبِّ يعلم الْقول
بَل رَفَعَهُ الله إِلَيْه
بَل رَبُّكُم

Llji i parë:

a) Kur e para është me sukun, kurse e dyta me vokale.

Edhe pse janë të përafërta bëhet idhhar i shkronjave. Përjashtim bën: shëndrrimi i **ل** në **ر** , pra shkronja **ل** tërësisht shkrihet dhe shndërrohet në **ر** . P.sh.:

بَلْ رَفَعَهُ - بَلْ رَفَعَهُ - بَرَّفَعَهُ

Nga të gjitha ajetet e Kur'anit vetëm në një vend ndodhet që për shkak të sektes (pauzimit frymor) që **ل** nuk shkrihet në **ر**:

كَلا بَلْ رَانَ (sekte)

b) Shndërrimi i shkronjës ق në ك, ku shkronja ق shndërrohet në ك. P.sh.:

نَخْلُقْكُمْ – نَخْلُكْ كُمْ – نَخْلُكُّمْ

Sipas Hafsës bëhet bashkëngjitja e plotë (Idgam Kamil), ndërsa sipas tjerëve bashkëngjitje jo e plotë (Idgam nakis).

Shndërrimi i ك në ق dhe i ر në ل nuk ndodh.

Kur dy shkronja të përafërta qëndrojnë pranë njëra-tjetrës, e para e pavokalizuar (me sukun), e dyta e vokalizuar, atëherë e para shkrihet dhe shndërrohet në të dytën:

a. Shkronja ن shkrihet dhe shndërrohet në ل. P.sh.:

مِنْ لَدُنْهُ - مِلْ لَدُنْهُ - مِلَّدُنْهُ

b. Shkronja ل shkrihet dhe shndërrohet në ر. P.sh.:

قُلْ رَبِّ - قُرْ رَبِّ - قُرَّبِّ

c. Shkronja ق shkrihet dhe shndërrohet në ك. P.sh.:

نَخْلقْكُمْ - نَخْلكْكُمْ - نَخْلُكُّمْ

قَدْ سَمِعَ الله

يغفرْ لكم

	E para me sukun e, dyta me vokale. **Sagirë**	E para dhe e dyta me vokale. **Kebirë**	E para me vokale, e dyta me sukun. **Mutlak**
Mithlani	فَمَا رَبِحَتْ تِجَارَتُهُمْ	أَتَتْ تَسْمَعُ	تَتْرَى
Mutekaribani	قُلْ رَبِّ	قَالَ رَبِّ	لَنْ
Mutexhanisani	ٱرْكَب مَعَنَا	يُعَذِبُ مَنْ	مُبْطِلُونَ
Mutebaidani	عَلَيْهِمْ غَيْرِ	مَحَبَّةً مِنى	الْحَمْدُ

IDGAMI është të bashkëngjiturit e shkronjave dhe të shqiptuarit një shkronjë e vetme.

IDGAMI MITHLEJN bëhet kur dy shkronjat janë të njëjta, pra si në cilësi ashtu edhe në vendartikulim.

- Në këtë rast Idgami është vaxhib.

IDGAMI MUTEKARIBEJNI bëhet kur dy shkronja janë të përafërta për nga cilësia dhe për nga vendartikulimi.

- Në këtë rast Idgami është i lejuar: **نَخْلقْكُمْ**

IDGAMI MUTEXHANISEJN bëhet kur dy shkronja janë të një vendartikulimi, por ndryshojnë nga cilësia.

3. SHKRONJAT E NJËLLOJTA MUTEXHANISEJN

MUTEXHANISEJN quhen shkronjat, të cilat e kanë një vend të përbashkët të artikulimit, mirëpo ndryshojnë për nga cilësia.

Pa marrë parasysh shkronjat a janë brenda fjalës (**قد تبين أَبْوَاب**) apo në fjalë të ndryshme, rezultojnë rregullat në vijim:

Shkronjat e njëllojta (mutexhanisejn) takohen në mes vete në tri mënyra:
E para: Takimi me distancë të vogël (sagirë).
E dyta: Takimi me distancë të madhe (kebirë).
E treta: Tamimi me distancë të mesme (mutlak).

E para: MUTEXHANISEJNI SAGIRË - Takimi i shkronjave të njëllojta me distancë të vogël (sagirë).

Takimi i shkronjave me distancë të vogël (Mutexhanisejni Sagrië) është tri llojesh:
Lloji i parë: Shkronjat e njëllojta – mutexhanisejn për të cilat të gjithë dijetarët janë pajtuar se bëhet bashkëngjitje (Idgam) dhe atë me shkronjat në vijim:

Idgami i shkronjës **د** në **ت** - Sagire – Bashkëngjitja e lehtë dhe e vogël:

- Kur shkronja **د** është me sukun dhe pason shkronja **ت** e vokalizuar, atëherë shkronja "**د**" shkrihet dhe shndërrohet në "**ت**" përshkak të afërsisë që kanë në artikulim, sepse edhe "**د**" edhe "**ت**" janë shkronja të prekjes së qiellzës me maje të gjuhës. P.sh.:

a)

كدتُ - قَالُوا تَاللهِ إِن كِدتَ لَتُرْدِين
قَد تَبَيَّنَ

b) Idgami i shkronjës **ت** në **د** :

أَثْقَلَت دَعْوَا أَرَدتُمْ وَ لَوْ تَوَاعَدتُمْ

ose Idgami i shkronjës **ت** në **ط** :

هَمَت طَائِفَةٌ قَالَت طَائِفَةٌ كَفَرَت طَائِفَةٌ آمَنَت طَائِفَةٌ

Sa i përket shkronjës ط me sukun dhe kur pas saj vjen shkronja ت gjithmonë bëhet Idhhar, përpos që shkronja ط me sukun e humbë cilësinë e tronditjes (kalkale) apo të vibrimit. p.sh.

أَحَطْتُ بَسَطْتُ

Kjo nga shkaku se shkronja e rëndë nuk lejohet që të shndërrohet në shkronjë të lehtë. Njësoj edhe te shkronjat tjera bëhet Idhhar. Si p.sh.:

وَ خُضْتُمْ

c) Idgami i shkronjës ذ në ظ :

إِذْ ظَّلَمْتُمْ إِذ ظَّلَمُوا

d) Idgami i shkronjës ث në ذ :

يَلْهَث ذَّالِك

Në këto fjalë vaxhib është Idgami (bashkëngjitja) për shkak të njëllojshmërisë.

Loji i dytë: Shkronjat e njëllojta (mutexhanisejn), të cilat takohen me distancë të vogël, pra e para me sukun, ndërsa e dyta e vokalizuar, për të cilat dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme Idhhar dhe Idgam.

Në këtë lloj bën pjesë takimi i shkronjës ب me م ku shkronja ب bëhet Idgam me shkronjën م , por jo sipas Hafsës.

يَا بُنَيَّ ٱرْكَب مَعَنَا

Sipas tarikit të Hirzit bëhet Idhhar, ndërsa sipas tarikit të Tibes bëhet Idhhar dhe Idgam.

Kjo është sa i përket shndërrimit të shkronjës ب në م , ndërsa shkronja م nuk shndërrohet në ب nëse shkronja م është me sukun, ndërsa pas saj është shkronja ب e vokalizuar, por bëhet Ihfa (të fshehurit) e shkronjës م . p.sh.:

لَعَلَّهُم بِلِقَآءِ نَبَأَهُم بِالْحَقِّ

Lloji i tretë: Takimi i shkronjave të njëllojta në distancë të vogël (sagirë), pra kur e para është me sukun, ndërsa e dyta e vokalizuar, por që këndohet rrjedhshëm (Idhhar) e nuk bashkëngjiten (nuk bëhen Idgam). P.sh.:

فَاصْفَحْ عَنْهُمْ فَسَبِّحْهُ

Këto shkronja quhen mutexhanisejn sipas mendimit Mutexhanisejn (të njëllojta) quhen edhe kur dy shkronja i kanë cilësitë e njëjta edhe pse ndryshojnë për nga vendartikulimi, siç është rasti:

أَنْتُمْ وَ آبَاؤكم أشيآء

E dyta: MUTEXHANISEJNI KEBIRË - Takimi i shkronjave të njëllojta me distancë të madhe (kebirë).

Takimi i shkronjave të njëllojta (mutexhanisejn) me distancë të madhe quhet kur e para është e vokalizuar dhe poashtu shkronja në vijim është e vokalizuar. Për këtë janë pajtuar dijetarët se bëhet Idhhari i tyre. P.sh.:

النُّفُوسُ زُوِّجَتْ بِمَ وَ عَلَى مَرْيَم بُهْتَانا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَ عَمِلُوا الصَّالِحَاتِ طُوبا

Te të gjithë dijetarët vaxhib është Idhhari i tyre.

- Bëhet Idhhar tepër i qartë (i madh).

E treta: MUTEXHANISEJNI MUTLAK - Takimi i shkronjave të njëllojta me distancë mesatare apo asnjanëse (mutlak)

Takimi i shkronjave të njëllojta (mutexhanisejn) me distancë mesatare apo asnjanëse (mutlak) quhet kur dy shkronja të njëllojta janë pranë njëra tjetrës, mirëpo e para është e vokalizuar, ndërsa e dyta me sukun. Sh. shkronja م me ب.

Të gjithë Kurratë janë të pajtimit se vaxhib është rrjedhësimi (Idhhari) i tyre. P.sh.:

مَبْعُوثُون تدعوا يشْكُرُ

Në të gjitha këto raste bëhet rrjedhësimi apo qartësia mesatare, për shkak se e para është e vokalizuar, ndërsa e dyta e pavokalizuar.

Po ashtu shkronja ص me shkronjën ر.

Po ashtu shkronja ك me shkronjën ث janë të përafërta për nga cilësitë, por ndryshojnë për nga vendartikulimi. Shkronja ك është prej fundit të gjuhës, ndërsa shkronja ث është prej fillimit të gjuhës.

Shkronja ل me shkronjën م . P.sh. لِمَ

Janë të përafërta për nga cilësitë, por të largëta për nga vendartikulimi.

Shkronja ل prej anësorëve të gjuhës, ndërsa shkronja م prej buzëve.

Për shkronjat të cilat i kanë të gjitha cilësitë e njëjta, mirëpo ose janë të përafërt në vendartikulim ose janë të largëta për nga vendartikulimi, dijetarët i kanë dhënë dy mendime:

- Mendimi i parë, ato janë të llojit Mutekaribejn.
- Mendimi i dytë, ato janë të llojit Mutexhanisejn.

Dy shkronja të cilat janë të përafërta për nga vendartikulimi dhe të gjitha cilësitë i kanë të njëjta. P.sh. shkronja ح me shkronjën ه , p.sh. فَسَبِّحْهُ , ose shkronja me shkronjën . P.sh. قَدْ حَائكم

Dy shkronja të cilat janë të largëta për nga vendartikulimi, por që i kanë cilësitë e njëjta janë:

1. Shkronja ك me shkronjë ت . P.sh. كُتِبَ ، تَكْفُرُونَ
2. Shkronja ث me shkronjën ه ose me ح . P.sh. ثلثة ، يلهث ، يبحث

Shkronja م me shkronjën ب .

مَبْعُثُونَ

Në këtë rast bëhet rrjedhësimi i shkronjës “b - ب ” para shkronjës “ع ” , sikurse edhe në rastet në vijim:

Idhhar (qartë) كَذَبَتْ ثَمُودُ

Idhhar (qartë) قَدْ سَمِعِ

Pra, sikurse rregullat e shkronjave të njëjta (Mutemathilani) ashtu edhe shkronjat Mutexhanisejni janë tri llojesh:

a. Mutexhanisejni Sagirë (i vogël)
b. Mutexhanisejni Kebirë (i madh)
c. Mutexhanisejni Mutllak (absolut).

1. Mutexhansiejni Sagirë është tri llojesh:

Lloji i parë: Shkronjat mutexhanisejn, për të cilat të gjithë dijetarët janë pajtuar se bëhet bahshkëngjitje Idgam.

a. Idgami i shkronjës **د** në **ت** pa marrë parasysh a janë në një fjalë apo në dy. P.sh.:

كدْتُ
قَالُوا تَا الله ان كدْت لتردين
قَدْ تَبَيَّنَ

b. Idgami i shkronjës **ت** në **د** .

اجيبت دعوتكما

ose Idgami i skronjës **ت** në **ط** .

فآمَنَتْ طَآئِفَة
ودت طَآئِفَة
همت طَآئِفَة

c. Idgami i shkronjës **ذ** në **ظ** . **اذ ظلمتم**

Lloji i dytë: Idgami i shkronjës së parë në të dytën, por jo sipas Hafsës. Në Kur'an kemi vetëm një rast të tillë ku bëhet.

Idgami i shkronjës **ب** në **م** .

يَا بَنَىَ ٱرْكَبْ مَعَنَا

Sipas tarikit të Hirzit në këto dy raste të fundit bëhet Idhhar, ndërsa sipas tarikit të Tibes Idhhar dhe Idgam.[12]

---

[12] *Në gjunën shqipe, ndërrimi kryesor i bashkëtingëlloreve është qiellzorizimi, domethënë, kalimi në një bashkëtingëllore qiellzore: k > q, g > gj, ll > j, l > j, r > j, po edhe ndërrime të tjera si: s > t, rr > r, k > s, nj > n.*

Qiellzorizime të bashkëtingëlloreve:
k > q: mik/miq, ujk/ujq, peshk/peshq, fik/fiq, rrezik/rreziqe etj.;
g > gj: zog/zogj, murg/murgj, gardh/gjerdhe, i vogël/të vegjël, djeg/dogja etj.;
ll > j: shekull/shekuj, mashkull/meshkuj, kërcyell/kërcej, pyll/pyje etj.;
l > j: kal/kuaj, muskul/muskuj, fle/fjeta etj.;
r > j: flamur/flamuj, lepur/lepuj, bir/bijë etj.;
s > t: shes/shet, flas/flet, shkas/shket etj.;

Lloji i tretë**:** Përpos këtyre dy llojeve shkronjat mutexhanisejn kur bëhet Idhhar e jo Idgam edhe pse e para është me sukun e dyta e vokalizuar. P.sh.:

فاصفع عَنْهُمْ
فسبحْهُ

Këto shkronja quhen Mutexhanisejn sipas mendimit se Mutexhanisejn është edhe kur dy shkronja i kanë cilësitë e njëjta, ndërsa ndryshojnë për nga vendartikulimi, siç është rasti:

أَنْتُمْ وَ آبَآؤُكُمْ
أَشْيَآءٌ

MUTEXHANISEJN IDHHAR (Qartë idhhar)

فمن الضطرَّ ط – ض
سوآء علينا ا وعظت ت – ظ
فإذا افضتم ت - ض

Shembull, shkronja **د** dhe shkronja **ت** , vendartikulimin e kanë anësorin e gjuhës dhe përfundimin e qiellëzes së epërme, mirëpo ndryshojnë për nga cilësitë, sepse shkronja **د** ka 6 cilësi, ndërsa shkronja **ت** ka 5 cilësi. Ata të përbashkëta i kanë 4 cilësi, ndërsa ndryshojnë në tjerat.

---

rr > r: nxjerr/nxora, tjerr/tora, mar/mora etj.

د - *xhehr*, shide, istifal, infitah, ismat, *kalkale*;

ت - *hemse* , shide, istifal, infitah, ismat, _____

SKEMA E SHKRONJAVE TË NJËLLOJTA (MUTEXHANISEJN)

Shkronjat		
د me **ت** **ت** me **د** **ت** me **ط** **ط** me **ت**	Skrirja dhe shndërrimi i të parës në të dytën.	**قَدْ تَبَيَّنَ** **إِن كِدْتَ لَتَرْدِين** **أجيبت دعوتكما** **اثقلت دعوا** **فآمَنَتْ طَآئِفَة** **ودت طَآئِفَة**

لَئِنْ بَسَطتَّ أَحَطتُ فَرَّطتُمْ		
إِذ ظَّلَمْتُمْ		ظ me ذ ك me ق
إِرْكب مَعَنَا يلهث ذَالِكَ	Lejohet Idgami, por edhe Idhhari.	م me ب ذ me ث
فَسَبِّحْهُ فَاصْفَحْ عَنْهُمْ	Idhhari	Shkronjat tjera

e. Idgami i shkronjës **ط** në **ت** . P.sh.:

لَئِنْ بَسَطتَّ ، فَرَّطتُمْ ، أَحَطتُ ، فَرَّطتُ

f. Idgami i shkronjës **ق** në **ك** . P.sh.:

الم نخلقكم

Idgami i shkronjës **د** në **ت** ; **ت** në **د** dhe **ط** ; **ذ** në **ظ** është idgam i plotë (Kamil), sepse bashkëngjitja bëhet në shkronjë dhe në cilësi, pra testid i plotë, ndërsa sa i përket Idgamit të **ط** në **ت** është Idgam i mangët (Nakis), sepse bashkëngjitja bëhet në shkronjë, e jo në cilësi të shkronjës, sepse të gjithë dijetarët janë pajtuar se cilësia e ITBAKIT (përmbyllëses) të **ط** të mbetet në fjalë, pra shkronja **ط** është e fortë, ndërsa shkronja **ت** e dobët, e, e forta nuk shkrihet në të dobëtën në tërësi, po mos të ishin shkronjat mutexhanisejn nuk do të bëhej idgami fare, pra këto dy shkronja janë të një vendartikulimi, ndërsa nuk i kanë cilësitë e njëjta.

Sa i përket Idgamit të shkronjës **ق** në **ك** në fjalën **نخلقكم** dijetarët janë pajtuar për shkrirje dhe bashkëngjitje, mirëpo disa kanë dhënë mendim se duhet të mbetet cilësia e shkronjës **ق** , ndërsa të tjerët kanë dhënë mendim se bëhet Idgam i plotë, pra humb edhe shkronja, edhe cilësia. Pra, që të dy vexhhet (mënyrat) janë të lejuara.

Dijetarët janë pajtuar për të mbetur cilësia e shkronjës ط (Itbaki), e jo cilësia e shkronjës ق (Istiëlai), sepse cilësia Itbak është më e fortë se cilësia Istiëla, kështu që kanë dashur ta ruajnë cilësinë më të fortë.

4. MUTEBAIDEJN – TË LARGËTA

Mutebaidejni quhen shkronjat të cilat janë të largëta njëra me tjetrën për nga vendartikulimi dhe poashtu kanë cilësi të kundërta. P.sh.:

Shkronja م është shkronjë buzore, ndërsa shkronja ح është shkronjë e fytit. P.sh.: يَحْمِلُونَ

Apo shkronja د me hemzen أ . P.sh.: دأبا

Apo shkronja ت me ع . P.sh.: تليت عَلَيْهِمْ

Apo shkronja ط me ه . P.sh.: يَطْهُرْنَ

Apo shkronja خ me ر . P.sh.: خَرَجُوا

Apo shkronja ق me ص . P.sh.: قصد ٱلسبيل

Në këto raste vaxhib është idhhari i shkronjës me sukun dhe assesi nuk guxon të fshihet, të shkrihet apo të bashkëngjitet.

Shkronjat të cilat janë të largëta me njëra-tjetrën (Mutebaidejn) kanë tri rregulla:

E para: Idhhari sagirë (qartësia e vogël);

E dyta: Idhhari kebirë (qartësia e madhe);

E treta: Idhhari mutllak (qartësia e mesme), pra qartësia në mes të qartësisë së vogël dhe qartësisë së madhe.

1. Rregulla e parë – Idhhari sagirë (qartësia e vogël).

Shembull "**ن**" i pavokalizuar me shkronjat e fytit:

أَنْعَمْتَ * مَنْ أَضلَّ * وَ ٱلْمنخنقةُ

تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ

Mutebaidejni Sagirë (Qartësia e vogël) bëhet Idhhar në të gjitha rastet, përpos në dy raste bëhet Ihfa dhe atë:

a) Kur pas nunit me sukun (të pavokalizuar) vjen shkronja **ق** dhe

b) Kur pas nunit me sukun (të pavokalizuar) vjen shkronja **ك**.

2. Rregulla e dytë – Idhhari kebirë (qartësia e madhe).

P.sh. shkronja **ز** me hemzen (**ء**):

يَسْتَهْزِءُونَ * لَهُمْ فِيهَا فَاكِهَه

3. Rregulla e tretë – Idhhari mutllak (qartësia e mesme).

P.sh.: Shkronja **ق** me shkronjën **و**, ose **ح** me **ق** :

قَوْلٌ * ٱلْحَقُّ مِن رَّبِّكَ

Përjashtim nga tri rregullat bën kur "**ن**" e pavokalizuara qëndron para **ق** dhe **ك** edhe pse janë të largëta "**ن**" i pavokalizuar bëhet ihfa (fshihet) dhe nuk këndohet qartë:

ٱنقَلَبُوا * أَنكَاثًا

- Rregull e rendësishme

Nëse në mes shkronjave qëndron një vend i zbrazët (ndonjë shkronjë tjetër), e cila në atë rast nuk është në mes të atyre dy shkronjave quhen MUTEBAIDANI.

Nga kjo konkludojmë se:

6 shkronjat e fytit me 18 shkronjat e gjuhës janë MUTEBAIDANI. Sepse fyti është një vendartikulim, ndërsa gjuha vendartikulim tjetër. Përpos çka cekëm më lart غ me ق dhe ك , dhe خ me ق dhe ك.

Po ashtu shkronjat e **fytit** me shkronjat e **buzëve** janë MUTEBAIDANI.

Sepse **fyti** është vendartikulim, **buzët** janë vendartikulim, ndërsa ata i ndanë gjuha. Po ashtu shkronjat e **gjuhës** me shkronjat e **buzëve** janë shkronja MUTEBAIDANI, sikurse janë shkronjat e fytit.

Çdo dy shkronja kur të takohen njëra me tjetrën duhet shikuar:

- a janë prej një vendartikulimi;
- a janë prej dy vendartikulimeve.

Nëse janë prej dy vendartikulimeve, atëherë janë shkronja të përlargëta – MUTEBAIDANI. Mirëpo këtu bën përjashtim shkronja غ me خ dhe shkronja ق me ك .

Kur të takohen shkronja غ me ق ose me ك , ose kur të takohen shkronja خ me ق ose me ك, këto quhen shkronja të përafërta (MUTEKARIBANI) edhe pse janë prej dy vendartikulimeve, mirëpo vendartikulimet janë shumë afër njëra-tjetrës prej dy pjesëve të gojës. Pra, shkronja غ dhe خ artikulohen prej fillimit të fytit nga goja, ndërsa ق dhe ك artikulohen prej fundit të gjuhës, e cila është shumë afër prej fillimit të fytit nga goja, se në fund të gjuhës fillon fundi i fytit. Vetëm nga ky shkak غ me ق dhe ك quhen Mutekaribani, po ashtu edhe خ me ق dhe ك quhen Mutekaribani.

Nëse shkronjat janë prej një vendartikulimi (pjesë të gojës), nëse nuk ka distancë të largët mes tyre, quhen Mutekaribani.

PËRFUNDIM I RAPORTEVE TË SHKRONJAVE

Nga e gjithë ajo çka përmendëm të shkronjat dhe rapotet e tyre mes vete mund të përfundojmë se:

1. Shkronjat, të cilat kanë një vendartikulim dhe të gjitha cilësitë e njëjta janë MUTEMATHILANI (shkronja të njëjta).
2. Shkronjat, të cilat kanë një vendartikulim, ndërsa nuk i kanë cilësitë e njëjta janë MUTEXHANISANI.
3. Shkronjat, të cilat janë të përafërta edhe për nga vendartikulimi, edhe për nga cilësitë; ose janë të përafërta në vendartikulim, e jo për nga cilësitë; ose janë të përafërta për nga cilësitë, e jo për nga vendartikulimi, janë MUTEKARIBANI.
4. Shkronjat, të cilat janë të largëta për nga vendartikulimi dhe kanë cilësi të kundërta janë MUTEBAIDANI.
5. Për shkronjat, të cilat i kanë cilësitë e njëjta edhe të përafërta në vendartikulim, ose janë të largëta në vendartikulim, dijatarët kanë dhënë dy mendime:

Mendimi i parë: Janë shkronja Mutekaribani.
Mendimi i dytë: Janë shkronja Mutexhanisani.

Sa i përket raporteve të shkronjave mes vete si mutemathilejni, si mutekaribejni, si mutegjanisejni, si mutebaidejni, ndahen në: Sagirë (të vogël), kebirë (të madhe) dhe mutlak (asnjanëse).

Mithlejni Sagirë (të njëjtat e vogël) bëhet Idhhar dhe Idgam.

Mutebaidejni Sagirë (të largëtat e vogël) bëhet Idhhar dhe Ihfa.

Mutexhanisejni Sagirë (të njëllojtat e vogël) bëhet Idhhar, Ihfa dhe Idgam.

Mutekaribejni Sagirë (të përafërtat e vogël) bëhet Idhhar, Ihfa, Idgam dhe Iklab.

Ndërsa, sa i përket kebirë (të madhe) dhe mutlak (asnjanëse), si te shkronjat mithlejn, si te shkronjat mutebaidejn, si te shkronjat mutexhanisejn, si te shkronjat mutekaribejn, gjithmonë bëhet Idhhar.

KAPITULLI I NËNTË

RREGULLAT E FILLIMIT DHE TË PËRFUNDIMIT TË LEXIMIT

EL-VAKF VEL IBTIDAË
(TË NDALURIT DHE TË FILLUARIT E LEXIMIT)

Të ndalurit (vakfi) dhe rifillimi (ibtidai) i leximit është prej çështjeve më të rëndësishme të texhvidit të cilat duhet t'i dijë lexuesi i Kur'anit.

Nuk ka vendndalje në Kur'an ku është vaxhib, që do të thotë bën mëkat lexuesi nëse nuk ndalet, po ashtu në Kur'an nuk ka vendndalje haram, por ndalja dhe rifillimi varet prej lexuesit të Kur'anit se çka ka për qëllim në atë vendndalje, apo në atë rifillim të leximit. Ajo çka është sunet është se Muahmedi a.s. na ka mësuar për t'u ndalur në fund të ajetit.

Të ndalurit e leximit mundet të jetë në fund të surës, në fund të ajetit, në mes të surës, në mes të ajetit, ndërsa nuk lejohet në mes të fjalës.

Rifillimi gjithmonë bëhet me shkronjë e cila ka vokale, e jo me shkronjë me sukun (të pavokalizuar), po ashtu edhe ndalja nuk bëhet me vokale, por me sukun.

DALLIMI NË MES NDALJES (VAKFIT), SEKTES DHE PËRFUNDIMIT

Ndalim (vakf) i leximit quhet ndërprerja e përkohshme e frymëmarrjes dhe leximit me qëllim që të vahdohet prej aty, ose të përsëritet ndonjë fjalë para vendit të ndalimit.

Ndalimi bëhet në fund të ajetit si dhe në mes të ajetit, por nuk bëhet në mes të fjalës.

Sekte do të thotë heshtje dhe në terminologji quhet ndërprerja e zërit përkohësisht, me fjalë tjera jo ndalim i tërësishëm i frymëmarrjes, por mbajtje e frymëmarrjes së mbetur, e cila ka qenë e aktivizuar gjatë leximit, me qëllim të vazhdimit të leximit.

Sekteja bëhet në fund të fjalës.

Kat'ë (përfundimi i leximit) do të thotë ndërprerja e leximit deri në leximin e ardhshëm, deri në leximin e herës tjetër, pra ndërprerja e leximit e kalimit në një veprim tjetër, pra është ndalimi i të lexuarit, kur për fillimin e leximit të sërishëm kërkohet leximi i "ISTIADHES".

Në librin "NESHR" është transmetuar nga Abdullah bin Ebi Ebil Hudhjl se *"Nëse ndonjëri nga ju fillon të lexojë një ajet, mos ta ndërpresë në tërësi leximin pa e përfunduar ajetin në tërësi".* Mirëpo siç shihet kjo nuk ka të bëjë për ajetet në përgjithësi, pra nuk lejohet në mes të ajetit të ndërpritet leximi pa marrë parasysh në namaz apo jashtë namazit.

Ibn Ebi Hudhejli në "Neshrin" e tij thotë: "E kanë urryer "mekruh" të lexoj një pjesë të ajetit e të mos e lexoj pjesën tjetër". Dihet mirëfilli se Abdullah Ibn Ebi Hudhejli ka qenë tabiinë dhe thënia e ti "E kanë urryer" ka pasur për qëllim sahabët r.a.

MEDHHEBET E DIJETARËVE PËR VAKFIN (TË NDALURIT E LEXIMIT) DHE IBTIDANË (TË FILLUARIT E LEXIMIT)

Sa i përket të ndalurit dhe fillimit të leximit dijetarët kanë dhënë këto mendime:

NAFIË – Ai ka lejuar vakfin (ndaljen) varësisht prej llojit të ndaljes.

Ndalja e mirë, fillimi i mirë, ka të bëjë varësisht nga tërësia dhe domethënia e ajetit të Kur'anit.

IBN KETHIRI – E ka dhënë mendimin se ndalja duhet bërë vetëm në fund të ajetit.

IBN AMRI – ndalej në fund të ajetit dhe thoshte se për mua kjo është më e pëlqyeshme.

ASIM KESAIJU – E zgjidhnin kompletimin e domethënies në ajet.

XHEZERIJU – ishte i mendimit se i tërë Kur'ani është si një sure në vete, dhe nuk e shihte ndonjë ndalim të caktuar, për këtë arsye mund të lidhet në lexim (të bashkëngjitet) një sure me një sure tjetër.

TË NDALURIT SUNET

Ky lloj i të ndalurit është të ndalurit e Xhibrilit.
Në këtë lloj bëjnë pjesë 10 vende të të ndaluarit:

1. (El-Bekare, ...), 2. (El-Bekare, ...), 3. (Ali Imran, ...), 4. (Hud, ...),
5. (Jusuf, ...), 6. (Err-Rraëd, ...), 7. (En-Nahl, ...), 8. (Es-Sexhde, ...),
9. (En-Naziat, ...), 10. (El-Kadr, ...).

Në disa libra, të ndalurit sunet e parashohin edhe në 7 vende tjera:

1. ... **ان انذر النَّاس**
2. ... **لا يحزنك قولهم**
3. ... **انما يعلمه البشر**
4. ... **يا بني لا تشرك بِاللهِ**
5. ... **انهم اصحاب النار**
6. ... **من كل امر**
7. ... **فَسَبِّح بِحَمْدِ رَبِّكَ وَ اسْتَغْفِر**

Muhamedi a.s. gjithmonë është ndalur në fund të këtyre pjesëve të ajeteve, për këtë arsye edhe të ndalurit në këto vende quhet të ndalurit sunet.

TË NDALURIT E DOMOSDOSHËM

Në esencë të ndalurit është e lejuar deri sa mos të ndodhë diçka që obligon të ndaluarit, ose e pengon të ndaluarit.

Llojet e të ndalurit janë:

1. IHTIBARI – E USHTRIMIT të ndalurit për të pyetur nxënësin, pra për t'ia treguar nxënësit shkakun e të ndalurit, si p.sh. shkronja "" e rrumbullakët apo e zgjatur "" ose për të treguar shkrimin e Uthmanit r.a.
   Rregull: I lejuar.

2. IDTIRARIJU – I DETYRIMIT kur e detyrojnë rrethanat lexuesin, si p.sh. të teshurit, të kollurit, etj. etj.
   Lejohet në çdo fjalë.

3. INTIDHARIJU – ALTERNATIVËS shtë të ndalurit në fjalët për të cilat dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme të ndalurit në ato vende.

4. IHTIJARIJ – I ZGJEDHJES kur lexuesi ndalet në fjalë të cilën e zgjedhë vetë.
   Lejohet nëse në atë fjalë përfundon kuptimi i plotë i fjalisë.
   VAKFI IHTIJARIJ ndahet në 6 lloje:

NDALJA

Në Kur'an ekzistojnë 6 lloje të ndaljeve, e ato janë:

1. TË NDALURIT E PLOTË, APO TË OMOSDOSHËM

Quhet kështu për shkak se në atë fjalë përfundon kuptimi dhe ka shkëputje të plotë me tekstin në vijim. Të kësaj natyre janë të ndalurit kur përfundon tregimi apo shpjegimi i asaj çështjeje. Pjesa më e madhe e këtij lloji të ndalurit është në fund të ajeteve.

Shenja e këtij lloji të ndalimit është "mimi - ۜ ", mirëpo ky lloj mimi ndryshon prej mimit "mimi - م " të iklabit.
Shembull:

إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ ۘ وَالْمَوْتَى يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ ... *(En-Amë, 36)*

Të ndalurit në fjalën " **يَسْمَعُونَ** " është i domosdoshëm.

2. TË NDALURIT E MJAFTUESHËM

Quhet ndalja që bëhet në fjalën në të cilën fjalë lejohet të ndalurit, por edhe të vazhduarit e leximit, megjithëse përparësi ka të ndalurit.
Shembull:

